Banka e Shqipërisë

2008

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569;
Faks: 355-4-2223558
e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:
Sektori i Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit.
E-mail: public@bankofalbania.org

Tirazhi: 1000 kopje
Shtypur në shtypshkronjën ADELprint sh.p.k.

P Ë R M B A J T J A

HYRJE		7
1	PËRMBLEDHJE	8
2	ZHVILLIMET NË MJEDISIN E JASHTËM	19
3	ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2008	40
4	TREGJET	56
5	ANALIZA E TREGUESVE TË SHËNDETIT TË SISTEMIT FINANCIAR	65
6	ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE	109
SHËNIME		117

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

2 Zhvillimet në mjedisin e jashtëm
Tabelë 1. Ecuria e PBB-së dhe inflacionit gjatë viteve 2007-2008 dhe parashikimi për vitet 2009-2010. 18
Tabelë 2. Ekspozimet e sektorëve bankarë të Evropës Perëndimore në vendet e Evropës Qendrore e Lindore, në 30 shtator 2008. 23

3 Zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2008
Tabelë 3. Tregues kryesorë makroekonomikë. 41
Tabelë 4. Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit. 42
Tabelë 5. Tregu i punës sipas tremujorëve. 46
Tabelë 6. Ecuria e borxhit të brendshëm në vite. 52
Tabelë 7. Kredia për ekonominë dhe qeverinë nga sektori bankar. 52
Tabelë 8. Ecuria e financimit të deficitit buxhetor. 53

5 Analiza e treguesve të shëndetit të sistemit financiar
Tabelë 9. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %). 65
Tabelë 10. Treguesit e shëndetit financiar. 67
Tabelë 11. Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08). 68
Tabelë 12. Pesha e zërave të pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08). 68
Tabelë 13. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar. 69
Tabelë 14. Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2008. 76
Tabelë 15a. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar në lekë. 77
Tabelë 15b. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në euro. 77
Tabelë 16. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në usd. 78
Tabelë 17. Të dhënat e kredisë së re, për tremujorin e katërt të vitit 2008. 82
Tabelë 18. Pesha e tepricës së kredisë së individëve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të individëve në përqindje. 84
Tabelë 19. Pesha e kredisë sipas qarqeve kryesore të vendit në përqindje. 85
Tabelë 20. Rezultate të stress-test-it. 97
Tabelë 21. Skenarët e rrezikut. 103
Tabelë 22. Treguesit e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit sipas tremujorëve. 106

6 Zhvillimet në sistemin e pagesave
Tabelë 23. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS në vite. 109
Tabelë 24. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS sipas tremujorëve të vitit 2008. 110
Tabelë 25. Llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS. 110
Tabelë 26. Tregues të përqendrimit për sistemin AIPS. 110
Tabelë 27. Përdorimi i kredisë brenda ditës. 111
Tabelë 28. Tregues për transaksionet në sistemin AECH në vite. 111
Tabelë 29. Tregues për transaksionet në sistemin AECH, sipas tremujorëve të vitit 2008. 111
Tabelë 30. Pagesat e kleruara në sistemin AECH, sipas seksioneve. 112
Tabelë 31. Tregues të përqendrimit për sistemin AECH. 112
Tabelë 32. Përbërja e llogarive bankare. 112
Tabelë 33. Numri i terminaleve ATM dhe POS. 113
Tabelë 34. Përdorimi i kartave bankare. 113
Tabelë 35. Transaksionet me karta sipas llojit të transaksionit. 114
Tabelë 36. Përdorimi i home-banking. 114

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2 Zhvillimet në mjedisin e jashtëm

Grafik 1. Ecuria e normës së papunësisë në SHBA. 20
Grafik 2. Ecuria e deficitit fiskal dhe borxhit qeveritar bruto të SHBA-së për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010. 20
Grafik 3. Rritja reale vjetore e PBB-së në disa vende të Eurozonës për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010. 21
Grafik 4. Ecuria e inflacionit mesatar vjetor në disa vende të Eurozonës për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010. 21
Grafik 5. Ecuria e normës së papunësisë në disa vende të Eurozonës. 21
Grafik 6. Ecuria e disa normave të interesit në tregjet e parasë (janar 2007- shkurt 2009). 25
Grafik 7. Yield-et e letrave me vlerë qeveritare në Eurozonë dhe SHBA (janar 2007-shkurt 2009). 25
Grafik 8. Indeksi i spread-it global të obligacioneve të korporatave të Merrill Lynch. 26
Grafik 9. Ecuria e indekseve kryesore të bursave të aksioneve (janar 2007-janar 2009). 26
Grafik 10. Ecuria e kursit të këmbimit euro/dollarë (janar 2007 –janar 2009). 28
Grafik 11. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para kryesore. 28
Grafik 12. Humbjet e bankave si pasojë e zhvlerësimeve të aktiveve (në miliardë dollarë). 31
Grafik 13. Rritja e kapitalit nga bankat (në miliardë dollarë). 31
Grafik 14. Humbjet e bankave në Evropë si pasojë e zhvlerësimit të aktiveve (në miliardë dollarë). 31
Grafik 15. Rritja e kapitalit nga bankat në Evropë (në miliardë dollarë). 31

3 Zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2008

Grafik 16. Treguesi i tendencës ekonomike. 42
Grafik 17. Treguesi i besimit të industrisë. 43
Grafik 18. Treguesi i besimit të ndërtimit. 43
Grafik 19. Treguesi i besimit të shërbimeve. 43
Grafik 20. Treguesi i besimit të konsumatorit. 43
Grafik 21. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të industrisë. 44
Grafik 22. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të ndërtimit. 44
Grafik 23. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të shërbimeve. 45
Grafik 24. Treguesi i situatës financiare aktuale dhe të pritshme të konsumatorit. 45
Grafik 25. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – industria. 45
Grafik 26. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – ndërtimi. 45
Grafik 27. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – Shërbimet. 45
Grafik 28. Treguesit e blerjeve aktuale dhe të pritshme – konsumatorët. 45
Grafik 29. Paga mesatare në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve. 46
Grafik 30. Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror. 46
Grafik 31. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – industria. 47
Grafik 32. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – ndërtimi. 47
Grafik 33. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – shërbimet. 48
Grafik 34. Papunësia. 48
Grafik 35. Remitancat dhe norma e papunësisë në disa vende të botës. 48
Grafik 36. Deficiti i llogarisë korente. 49
Grafik 37. Treguesi i eksportit aktual dhe të pritshëm – industria. 49
Grafik 38. Llogaria financiare. 51
Grafik 39. Përbërësit e borxhit publik. 53

4 Tregjet

Grafik 40. Ecuria e normave të interesit për kreditë e akorduara në lekë dhe në euro. 56
Grafik 41. Ecuria e normave të interesit për depozitat e pranuara në lekë dhe euro. 57
Grafik 42. Spread-i normës së interesave të kredi–depozita sipas monedhave kryesore. 57
Grafik 43. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar. 58
Grafik 44. Ecuria e vëllimit të huadhënies në tregun ndërbankar (në milionë lekë). 58
Grafik 45. Ecuria e yield-it të letrave me vlerë të qeverisë. 61
Grafik 46. Ecuria e pjesëmarrjes së bankave dhe individëve sipas vëllimit në lekë në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë. 61
Grafik 47. Ecuria ditore e kursit të këmbimit euro/lek dhe usd/lek. 62
Grafik 48. Vëllimi total i tregtimeve valutore gjatë vitit 2008. 63
Grafik 49. Pesha e kredisë për prona të patundshme në përqindje kundrejt tepricës së kredisë. 63
Grafik 50. Indeksi i çmimeve të shtëpive për rrethin e Tiranës. 64

5 Analiza e treguesve të shëndetit të sistemit financiar
Grafik 51. Pesha e secilit grup bankar në totalin e aktiveve. 66
Grafik 52. Pesha e zërave të aktiveve dhe pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08). 69
Grafik 53. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë (në përqindje). 70
Grafik 54. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë për grupet bankare. 70
Grafik 55. Depozitat në valutë ndaj kredive në valutë. 70
Grafik 56. Ndryshimi në depozita në valutë ndaj kredive në valutë sipas tremujorëve (në pikë përqindje). 71
Grafik 57. Depozitat në valutë ndaj kredive në valutë sipas grupeve. 71
Grafik 58. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave, sipas madhësisë së aktivitetit. 72
Grafik 59. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe pasiveve. 72
Grafik 60. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave (në muaj). 73
Grafik 61. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë (në muaj). 73
Grafik 62. Kontributi në rritjen e aktiveve nga burimet në përqindje. 73
Grafik 63. Detyrimet ndaj jorezidentëve, ndaj totalit të detyrimeve. 74
Grafik 64. Detyrimet ndaj jorezidentëve, ndaj totalit të detyrimeve sipas grupeve të bankave. 74
Grafik 65. Detyrimet ndaj jorezidentëve, ndaj totalit të detyrimeve në valutë. 74
Grafik 66. Përqendrimi i detyrimeve ndaj jorezidentëve. 74
Grafik 67. Ecuria e aktiveve të jorezidentëve. 75
Grafik 68. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve. 75
Grafik 69. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit. 76
Grafik 70. Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit respektivisht për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë. 78
Grafik 71. Vëllimi total i pranimeve të reja në euro kundrejt normave mesatare të interesit respektivisht për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe usd. 78
Grafik 72. Shpërndarja e kontributit të zërave të aktivit në përqindje. 79
Grafik 73. Ecuria e zërave të aktivit. 79
Grafik 74. Ecuria e aktiveve me rrezik të sektorit bankar. 80
Grafik 75. Aktivet me rrezik ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave. 80
Grafik 76. Kredia e re (djathtas) dhe përdorimi i kredisë (majtas). 81
Grafik 77. Kredia e re sipas tremujorëve në vite. 81
Grafik 78. Shpërndarja e kredisë së re të bizneseve sipas mënyrës të përdorimit në përqindje, sipas tremujorëve '07-'08. 82
Grafik 79. Shpërndarja e kredisë së re të individëve sipas qëllimit të përdorimit në përqindje sipas tremujorëve '07-'08. 82
Grafik 80. Shpërndarja e kredisë, dhjetor 2008. 84
Grafik 81. Pesha e tepricës së kredisë së bizneseve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të bizneseve në përqindje. 84
Grafik 82. Shpërndarja e kredisë (në përqindje ndaj totalit) në dhjetor 2008. 85
Grafik 83. Pesha e kredisë afatshkurtër sipas rretheve. 85
Grafik 84. Pesha e kredisë afatmesme sipas rretheve. 85
Grafik 85. Pesha e kredisë afatgjatë sipas rretheve. 86
Grafik 86. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë për rrethet kryesore të vendit në përqindje (TIV-2008). 86
Grafik 87. Ecuria e treguesit kredi me probleme ndaj totalit të kredisë për sistemin. 86
Grafik 88. Ecuria e cilësisë së kredisë (bruto) për grupet sipas madhësisë së aktivitetit. 87
Grafik 89. Cilësia e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë në përqindje. 88
Grafik 90. Hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner për sistemin bankar në përqindje. 88
Grafik 91. Hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner për grupet sipas madhësisë së aktivitetit në përqindje. 89
Grafik 92. Raporti i mbulimit të kredive me probleme, me provigjone sipas tremujorëve në përqindje. 89
Grafik 93. Mbulimi i kredisë me kolateral. 89
Grafik 94. Kthimi nga kapitali dhe të ardhurat neto ndaj totalit të aktiveve për sektorin bankar. 91
Grafik 95. Kthimi nga kapitali dhe të ardhurat neto ndaj totalit të aktiveve për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 91
Grafik 96. Shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 92
Grafik 97. Të ardhurat neto nga interesat ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë për sektorin bankar e grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 93
Grafik 98. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit (madhësia e kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik). 94
Grafik 99. Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik. 94
Grafik 100. Treguesi i levës financiare. 95
Grafik 101. Treguesi i likuiditetit të sistemit bankar dhe grupet e bankave. 96
Grafik 102. Raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra për sistemin bankar dhe grupet e bankave. 96
Grafik 103. Probabiliteti i ndodhjes së një huaje me probleme e matur nga raporti i huave me probleme në skenarët optimist, normal dhe pesimist. 103
Grafik 104. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit në përqindje, në fund të vitit 2008. 104
Grafik 105. Rritja e nivelit të aktiveve sipas tremujorëve, në përqindje. 104
Grafik 106. Raporti i kapitalizimit të institucioneve financiare jobanka, në përqindje. 105
Grafik 107. Raporti i cilësisë së portofolit të kredive. 105

HYRJE

Ky është numri i dytë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një publikim i Bankës së Shqipërisë, i cili do të vijojë të përgatitet çdo vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve financiare ndërkombëtare, publike dhe private.

Me qëllim që raporti të lexohet nga grupe të ndryshme interesi dhe publiku në tërësi, është synuar që gjuha e përdorur dhe informacioni që paraqitet, të jenë sa më të përshtatshëm. Përmirësimi i cilësisë së raportit, veçanërisht në kuadër të të dhënave që përmban, do të jetë objektivi ynë për çdo publikim të ardhshëm.

Stabiliteti i sistemit financiar është vlerësuar në bazë të performancës dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e zhvilluara e ato të rajonit, dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë në rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, është vlerësuar situata e të ardhurave personale dhe efektet që ajo ka mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Për të vlerësuar rreziqet që rrjedhin si rezultat i veprimtarisë së sistemit financiar, janë analizuar zhvillimet në treguesit kryesorë të shëndetit financiar të tij, ku përfshihen kapitali, cilësia e aktiveve dhe performanca financiare. Madhësia e rreziqeve është vlerësuar nëpërmjet analizës "stress-test". Është realizuar gjithashtu, një vlerësim i përmbledhur i situatës së sektorit financiar jobankar.

Të dhënat dhe analiza përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë vitit 2008, por edhe të tremujorit të parë të vitit 2009. Pritjet për zhvillimet e ardhshme shtrihen përgjithësisht, deri në fund të vitit 2009.

1 PËRMBLEDHJE

Kriza financiare ndërkombëtare, u thellua ndjeshëm në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008. Disa banka dhe institucione të rëndësishme financiare në SHBA falimentuan, ndërsa disa të tjera arritën të shpëtojnë vetëm falë ndërhyrjes së autoriteteve publike për t'i ndihmuar me likuiditet. Reagimi i tregjeve financiare botërore, pas këtyre ngjarjeve ishte shumë i fortë, veçanërisht pas vendimit të autoriteteve amerikane për të lejuar falimentimin e "Lehman Brothers", duke konsideruar pozicionin e saj aktiv në tregjet botërore të instrumenteve të lidhura me kreditë për shtëpi dhe ato derivative. Tregjet financiare dhe institucionet e tyre u mbërthyen nga paniku dhe kriza u përhap me shpejtësi fillimisht në tregjet evropiane ku disa banka rrezikuan falimentimin, e më pas në të gjithë botën. Veprimet në tregjet ndërbankare të vendeve të zhvilluara u pakësuan ndjeshëm, duke u përqendruar kryesisht në segmentet më afatshkurtra, ndërkohë që kostoja e financimit të tyre u rrit në mënyrë të konsiderueshme. Letrat me vlerë të lidhura me kreditë hipotekare amerikane vazhduan të zhvlerësoheshin, duke thelluar humbjet në bilancet e bankave. Tregjet për produkte financiare të caktuara u zhdukën plotësisht. Besimi i investitorëve dhe i publikut tek bankat dhe institucionet financiare u trondit në shkallë botërore, gjë që solli dhe një rënie të përgjithshme të çmimeve të titujve të kapitalit të bankave, duke ngushtuar së tepërmi mundësitë e tyre të financimit. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, indekset e platformave më të mëdha të tregtimit të aksioneve, vetëm gjatë muajit tetor të vitit 2008, shënuan një rënie me 25 për qind. Për të adresuar me shpejtësi çështjen e humbjes së besimit të publikut në banka, autoritetet publike në SHBA dhe në vendet e Bashkimit Evropian, rritën vlerën e sigurimit të depozitave për një periudhë të përkohshme.

Kriza e sektorit financiar u shtri me shpejtësi edhe në sektorin real të ekonomisë. Rënia e sasisë dhe shtrenjtimi i financimeve nga mosfunksionimi i tregjeve, ndikuan në rënien e investimeve dhe të tregtisë, duke goditur kërkesën e brendshme e duke nxitur një ngadalësim të ndjeshëm të sektorëve realë të ekonomisë në nivel botëror. Norma e papunësisë shënoi rritje në të gjitha vendet e zhvilluara, në kushtet kur sipërmarrjet u detyruan të shkurtojnë kostot e prodhimit për t'iu përgjigjur rënies së kërkesës. Shumica e ekonomive të zhvilluara hynë në një fazë recesioni ekonomik në gjysmën e dytë të vitit 2008, ndërkohë që ngadalësimi i rritjes ekonomike përfshiu dhe vendet në zhvillim. Sipas FMN[1]-së, rritja vjetore e prodhimit të përgjithshëm botëror ra në 3.4 për qind në vitin 2008 nga 5.2 për qind në vitin 2007. Vëllimi i tregtisë botërore për mallra dhe shërbime u rrit vetëm me 4.1 për qind në 2008-ën, nga 7.2 për qind në 2007-ën. Në vendet e zhvilluara, rritja ekonomike zbriti në 1 për qind në vitin 2008, nga 2.7 për qind në vitin 2007. Ekonomitë në zhvillim, duke qenë më pak të integruara në tregjet financiare botërore dhe me ekspozim shumë të ulët në produktet financiare që ishin në qendër të krizës, fillimisht nuk u prekën nga tronditjet financiare që pushtuan vendet e zhvilluara. Thellimi i mëtejshëm i krizës në gjysmën e dytë të vitit dhe rritja e ndikimit të saj mbi sektorët realë të ekonomisë, bënë që përmes kanaleve financiare dhe tregtare, pasojat e krizës të përcillen edhe në vendet në zhvillim. Si rezultat, rritja ekonomike e këtyre vendeve u ngadalësua në 6.1 për qind në vitin 2008, kundrejt 8.3 për qind në vitin 2007.

Nën efektet e krizës financiare, edhe tregjet e këmbimit valutor dhe tregjet e energjisë e të lëndëve të para u karakterizuan nga një shkallë e lartë luhatshmërie. Në gjashtëmujorin e parë, dollari amerikan u zhvlerësua ndaj valutave kryesore, veçanërisht ndaj euros, duke reflektuar pritjet pesimiste të investitorëve mbi ekonominë amerikane. Çmimet e naftës dhe të lëndëve të para të prodhimit vazhduan prirjen rritëse të nisur që në vitin 2007, duke rritur në mënyrë shqetësuese presionet inflacioniste në mbarë botën. Situata shënoi një kthesë në drejtimin e kundërt në periudhën gusht-shtator 2008, ku dollari amerikan u vlerësua ndaj euros, si rezultat i rritjes së kërkesës së investitorëve për letrat me vlerë të borxhit të Qeverisë së SHBA, të perceptuara si letrat me vlerë me rrezik më të ulët në situatë krize. Rënia e kërkesës nga vendet e zhvilluara dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik botëror, ndikuan në rënien e kërkesës për lëndë të para të prodhimit dhe për produktet ushqimore, duke sjellë zbutjen e presioneve për rritje të çmimeve. Në vendet e zhvilluara, rritja mesatare vjetore e çmimeve të konsumit për vitin 2008 rezultoi 3.5 për qind, ndërsa në vendet në zhvillim, rritja mesatare vjetore e çmimeve të konsumit për vitin 2008 rezultoi në nivelin 9.4 për qind.

Në përgjigje të situatës së vështirë të krijuar gjatë vitit 2008, autoritetet publike në mjaft vende ndërtuan planet e tyre të shpëtimit. Këto plane përgjithësisht përfshinin ndihmën financiare për bankat, ruajtjen e stimujve për të vazhduar kreditimin nga sektori bankar për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, si edhe garantimin e kursimeve të publikut në banka. Thellimi dhe zgjerimi i krizës financiare në gjashtëmujorin e dytë të vitit, ktheu në domosdoshmëri harmonizimin e veprimeve të tilla në nivel global, si edhe fuqizimin e rolit të institucioneve financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Nëpërmjet disa takimeve në tremujorin e fundit të vitit 2008, vendet më të zhvilluara u zotuan të vepronin sipas disa parimeve të përgjithshme të cilat synonin angazhimin e këtyre vendeve dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare, për të forcuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe kuadrin rregullativ të tregjeve financiare, për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, për të mundësuar reformimin dhe forcimin e burimeve financiare të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe për të rritur rezistencën ndaj veprimeve që shkaktojnë mbylljen e ekonomive kombëtare ndaj tregjeve. Në nivel më konkret, autoritetet e këtyre vendeve u angazhuan në drejtim të: sigurimit të kushteve të përshtatshme të likuiditetit për institucionet financiare; lehtësimit të kushteve të shtrënguara të financimit të bankave; mbështetjes me kapital të institucioneve financiare në mënyrë që ato të ruanin financimin për ekonominë; rikapitalizimit eficient të bankave që kishin probleme; interpretimit me fleksibilitet të rregullave të kontabilitetit në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të tregjeve; dhe forcimit të procedurave të bashkëpunimit midis vendeve.

Vlerësohet se këto masa kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të vendosur një kufi në humbjen e besimit të publikut tek bankat dhe në ruajtjen e besimit të bankave tek njëra-tjetra. Në përgjithësi, këto masa i kanë dhënë tregjeve financiare "qetësinë" për të vijuar veprimet e tyre, ndonëse me vëllime dhe me

çmime ende larg atyre të situatave normale. Duke patur parasysh historikun e krizave të kaluara globale, pritet që rikthimi i besimit në tregjet financiare dhe normalizimi i huadhënies drejt niveleve të parakrizës, të zgjasë në kohë. Për më tepër, shtrirja e krizës në ekonominë reale tregon që shumica e vendeve mund të vazhdojnë të përjetojnë kontraktim ekonomik gjatë viteve në vijim dhe që rikthimi i ekonomisë botërore në një rritje të qëndrueshme nuk mund të ndodhë brenda një të ardhmeje të afërt. Në vlerësimet e tij periodike, ky skenar konfirmohet edhe nga FMN.

Në nivel global, sistemi financiar dhe bankat do të ndeshen me vështirësi edhe gjatë vitit 2009. Rezultati financiar pritet të jetë i dobët, ndërkohë që kërkesa për kapital do të jetë e qëndrueshme. Në fakt, këta dy tregues pritet të jenë të tillë në afat të mesëm, pavarësisht prej përmirësimit të pjesshëm të veprimtarisë bankare në afat të shkurtër. Faktorët që lidhen me rënien e veprimtarisë së kreditimit dhe situatën e vështirë të sektorit real të ekonomisë, qëndrueshmërinë e kostove të financimit në tregun ndërbankar, humbjen e vlerës së aktiveve, rritjen e fondeve rezervë si rezultat i përkeqësimit të cilësisë së aktiveve etj., do të ndikojnë në rënien e rezultatit financiar. Nga ana tjetër, bankat dhe institucionet e tjera financiare mund të përfitojnë si rezultat i krijimit të kushteve më të qëndrueshme të likuiditetit, nga mundësia e rritjes së të ardhurave prej veprimtarisë së tregtimit të produkteve të ndryshme financiare, ulja e kostove si rezultat i zvogëlimit të përmasave dhe sinergjive të krijuara nga bashkimet e ndryshme etj.. Megjithatë, situata e paqëndrueshme e të ardhurave si edhe përkeqësimi i cilësisë së aktiveve, do të ndikojnë negativisht në ruajtjen e niveleve të mjaftueshme të kapitalizimit të bankave dhe mund të mbështesin afrimin e tyre të mëtejshëm drejt skemave publike të kapitalizimit të veprimtarisë.

Në vendin tonë, ndikimi i krizës ndërkombëtare u rrit për shkak transformimit të saj në një krizë të ekonomisë reale me shtrirje globale. Fillimisht, kriza financiare ndërkombëtare nuk pati një ndikim të drejtpërdrejtë të rëndësishëm mbi sistemin tonë financiar. Arsyet lidhen me mungesën e ekspozimit të sektorit bankar dhe sistemit financiar në përgjithësi, në produkte dhe në institucione financiare të cilat ishin në qendër të krizës, si edhe për shkak të ekspozimit të ulët ndaj huamarrjes në tregjet e huaja. Megjithatë, në tremujorin e fundit të vitit 2008, për shkak të efektit psikologjik që shkaktoi ashpërsimi i krizës në tregjet ndërkombëtare, publiku reagoi duke tërhequr një pjesë të depozitave të sektorit bankar. Pasojat e këtij reagimi ishin rritja e nevojave për likuiditet si edhe rënia e ritmeve të kreditimit në sektorin bankar. Banka e Shqipërisë mori masa të menjëhershme për të normalizuar situatën e krijuar dhe rikthyer besimin e publikut tek bankat, duke injektuar likuiditet në treg në forma të ndryshme, si edhe duke rritur mundësitë e bankave për ta aksesuar atë[2]. Këto veprime dhanë efekt pozitiv drejt uljes së nivelit dhe luhatshmërisë së normave të interesit ndërbankar në fund të vitit. Me shndërrimin e krizës financiare në një krizë ekonomike me karakter global, ndikimi i saj u materializua në vendin tonë në formën e kufizimit të burimeve të financimit dhe në shtrenjtimin e fondeve të financimit, si për nevojat e sektorit publik ashtu edhe për sektorin privat, tkurrjen e të hyrave valutore në formën e dërgesave të emigrantëve dhe rënien e eksporteve, rritjen e presioneve për zhvlerësim mbi kursin e këmbimit

të monedhës kombëtare ndaj valutave kryesore dhe ndikimin negativ mbi pritshmëritë për mirëqenien financiare të agjentëve ekonomikë në të ardhmen. Ecuria e këtyre efekteve në të ardhmen afatshkurtër do të varet nga aftësia e aktorëve ekonomikë, publikë dhe privatë për t'iu përshtatur këtyre kushteve, nga aftësia e sistemit financiar për të ruajtur ritme të qëndrueshme rritjeje në procesin e ndërmjetësimit financiar, si edhe nga zhvillimet e faktorëve të jashtëm të rrezikut.

Gjatë vitit 2008, veprimtaria e sistemit financiar dhe sektorit bankar është rritur me ritme më të ulëta. Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar[3] ndaj Produktit të Brendshëm Bruto[4] (PBB-së) është rritur në 82 për qind në fund të vitit 2008, kundrejt 79.4 për qind në fund të vitit 2007. Në strukturën e aktiveve të sistemit financiar, bankat luajnë rolin kryesor. Në fund të vitit 2008, në vendin tonë operonin 16 banka dhe aktivet e tyre përfaqësonin rreth 95.4 për qind të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 78 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së). Gjatë vitit 2008 vijoi rritja e veprimtarisë së sektorit bankar, e cila e shprehur në totalin e aktiveve të sistemit arriti në 843.1 miliardë lekë ose 12.4 për qind më e lartë se një vit më parë. Ecuria e aktivitetit megjithatë ka ndjekur një dinamikë të ndryshme gjatë vitit. Për shkak të tërheqjeve të depozitave në tremujorin e katërt të vitit ndryshimi i totalit të aktiveve në tremujorin e fundit të vitit, në krahasim me tremujorin e tretë ishte -2.7 për qind. Veprimtaria e kreditimit e cila përbën rreth 48 për qind të aktivit në dhjetor 2008, megjithëse vijoi trendin rritës që prej vitit 2003, u ngadalësua veçanërisht në tremujorin e fundit të vitit. Portofoli i kredive arriti në vlerën 396.8[5] miliardë lekë, duke zënë rreth 37 për qind të PBB-së. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kjo tepricë evidenton një rritje me 104.3 miliardë lekë ose rreth 36 për qind. Cilësia e portofolit të kredisë, ka shënuar rënie. Aktivet dhe detyrimet në valutë të sektorit bankar, pavarësisht peshës së tyre vazhdimisht në rritje ndaj totalit të bilancit, kanë dëshmuar për një ekspozim të ekuilibruar në valutë siç pasqyrohet në madhësitë e tyre të krahasueshme. Edhe rezultati financiar i sektorit bankar gjatë vitit 2008, ishte pozitiv, por më i ulët se një vit me parë. Megjithë uljen e rezultatit financiar, paqëndrueshmërinë e depozitave dhe rënien e cilësisë së portofolit të kredisë, treguesit e likuiditetit dhe të kapitalizimit të veprimtarisë së sektorit bankar, vlerësohen në nivele të mira.

1.1 VLERËSIM MBI NDJESHMËRINË E SEKTORIT BANKAR NDAJ RREZIQEVE

Stabiliteti i sistemit financiar dhe posaçërisht i sektorit bankar, përcaktohet nga marrëdhëniet e veprimtarisë financiare me zhvillimet ekonomike të brendshme dhe të jashtme, dhe ndërveprimin e tyre me gjendjen e brendshme të vetë sistemit financiar. *Mbështetur mbi analizën e zhvillimeve gjatë vitit 2008 dhe të muajve të parë të vitit 2009, vlerësohet që niveli i përgjithshëm i rrezikut për sistemin financiar dhe sektorin bankar është rritur. Burimet kryesore të rrezikut, lidhen kryesisht me zhvillimet makroekonomike në vend dhe ecurinë e disa treguesve të veprimtarisë bankare që kërkojnë monitorim të kujdesshëm.*

Më konkretisht:

1. *Është rritur ndjeshmëria e sistemit financiar dhe sektorit bankar ndaj zhvillimeve të brendshme makroekonomike*. Rreziqet kryesore për qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe të sektorit bankar, lidhen me:

a. *Ngadalësimin e ndjeshëm të rritjes ekonomike*. Gjatë vitit 2008, rritja ekonomike e vendit ishte e qëndrueshme dhe në përputhje me parashikimet, e mbështetur prej rritjes së shpenzimeve publike dhe inercisë së vëllimeve të larta të financimit nga ana e sektorit bankar. Megjithatë, zhvillimet e tremujorit të fundit të atij viti si edhe të muajve të parë të vitit 2009, tregojnë që rritja ekonomike për vitin 2009, ndonëse pritet të jetë pozitive, do të jetë më e ulët. Arsyet e këtij ngadalësimi të rritjes ekonomike lidhen me rënien e kërkesës së brendshme, për shkak të rënies së të ardhurave të agjentëve të brendshëm ekonomikë që ndërveprojnë me tregjet ndërkombëtare, mungesës së hapësirës për një politikë fiskale ekspansioniste dhe uljes së ndjeshme të financimit nga ana e sektorit bankar në vend. Vlerësimet paraprake të FMN-së, tregojnë një rritje ekonomike midis 0 dhe 1 për qind. Për këtë arsye, mundësitë për zgjerim të veprimtarisë së sistemit financiar do të jenë më të kufizuara dhe rezultati i tij financiar do të jetë më i ulët gjatë vitit 2009.

b. *Vështirësi të situatës financiare të sektorit real të ekonomisë*. Pritjet për ngadalësimin e ekonomisë, po thellojnë vështirësitë financiare për sipërmarrjet e biznesit dhe për familjet. Sipërmarrjet e biznesit po përballen me burime më të rralla dhe më të shtrenjta financimi. Burimet e brendshme të zgjerimit të veprimtarisë, në formën e të ardhurave të siguruara nga veprimtaria kryesore, do të ndikohen negativisht prej rënies së investimeve dhe të shitjeve. Burimet e jashtme të financimit, në formën e huamarrjes prej sektorit bankar, gjithashtu po bien ndjeshëm. Vrojtimet e ndryshme për gjendjen e sektorit të biznesit, në përgjithësi konfirmojnë rritjen e vështirësive financiare në situatën aktuale dhe mungesën e optimizmit për zhvillimet afatshkurtra. Vështirësitë e sipërmarrjeve të biznesit, do të ndikojnë negativisht në aftësinë e tyre për të ofruar punë në mënyrë të qëndrueshme, duke shkaktuar rënie të të ardhurave të individëve dhe të familjeve. Përsëri, sistemi financiar dhe veçanërisht sektori bankar, do t'i ndjejë këto zhvillime të pafavorshme kryesisht në formën e cënimit të cilësisë së portofolit të kredisë dhe ngadalësimit të ritmit të rritjes së depozitave të publikut.

c. *Mungesën e hapësirës për një politikë fiskale ekspansioniste*. Rritja e deficitit buxhetor në vitin 2008 në krahasim me një vit me parë, përfaqësoi një politikë fiskale ekspansioniste e cila, mbështeti rritjen e ekonomisë së brendshme. Ajo u realizua në kushtet e një situate më të favorshme të financimit të deficitit, si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Ngadalësimi i pritshëm i rritjes ekonomike

dhe vështirësitë që po ndesh sektori real i ekonomisë, vendosin nën presion të ardhurat publike, duke rritur vështirësitë për realizimin e tyre sipas planit të buxhetit për vitin 2009. Nga ana tjetër, situata më e vështirë e likuiditetit në tregun e brendshëm financiar si edhe në tregun e huaj, po shoqërohet me rritjen e kostos së financimit të deficitit buxhetor, duke sjellë rritjen e ngarkesës fiskale në një periudhë afatmesme. Realizimi i shpenzimeve publike të parashikuara, në një situatë të ngadalësimit ekonomik është një objektiv i dëshirueshëm. Por në rastin tonë, nëse nuk gjenden burime alternative dhe të mjaftueshme të ardhurash, përshtatja e shpenzimeve publike sipas nivelit të realizimit faktik të të ardhurave dhe ruajtja e objektivit për deficitin buxhetor, do t'i shërbenin më mirë realizimit të financimit të tij me një kosto më të ulët dhe çlirimit të fondeve për përdorim në tregun e brendshëm dhe për sektorin privat.

d. *Rezistencën e deficitit të llogarisë korente të bilancit të pagesave*. Për shkak të paqëndrueshmërisë së eksporteve dhe rënies së dërgesave nga emigrantët, deficiti i llogarisë korente në bilancin tregtar shfaqet i përkeqësuar. Nëse kjo prirje forcohet, ajo mund të ndikojë në mënyrë të qëndrueshme strukturën e flukseve të valutës në tregun e brendshëm, duke ndikuar mbi kërkesën dhe ofertën për valutë dhe duke sjellë rritjen e luhatshmërisë mbi kursin e këmbimit të monedhës kombëtare. Lëvizja e lirë e kursit të këmbimit, ofron një instrument automatik të korrigjimit të këtyre disekuilibrave në kërkesën dhe ofertën për valutë në tregun e brendshëm. Në këtë kuadër, të gjithë agjentët ekonomikë, duhet të vlerësojnë ndjeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre ndaj lëvizjeve të mundshme të pafavorshme të kursit të këmbimit dhe të ndërmarrin veprimet mbrojtëse të nevojshme. Nga ana e tij, sektori bankar është i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit, veçanërisht në drejtim të ndikimit që përcillet për cilësinë e portofolit të kredisë në valutë. Për këtë arsye, zhvillimet e muajve të parë të vitit 2009 në kursin e këmbimit, duhet të nxisin të gjitha veprimet e nevojshme të sektorit bankar, për zbutjen e efekteve të padëshiruara në gjendjen financiare.

2. *Është zbutur ndjeshmëria e sistemit financiar dhe sektorit bankar ndaj zhvillimeve të tregjeve ndërkombëtare*. Në këtë kuadër, vlerësohet që:

e. *Politikat publike për mbrojtjen e grupeve bankare evropiane, kanë ulur pasigurinë për qëndrueshmërinë e tyre ligjore dhe financiare dhe për mundësinë e ndihmës që mund të japin për investimet e tyre në vendin tonë*. Në fakt, paketat e ndihmës financiare, të miratuara në Austri, Greqi, Itali, Francë dhe vende të tjera, si edhe injektimi i fuqishëm i likuiditetit nga ana e Bankës Qendrore Evropiane, kanë zbutur vështirësitë e bankave të mëdha evropiane për të siguruar likuiditet dhe për të rifinancuar detyrimet e tyre në treg. Ecuria pozitive e aksioneve të këtyre bankave në bursat e tregtimit, në përgjithësi gjatë muajve të parë të vitit 2009, e tregon këtë përmirësim të situatës.

Megjithatë, nevojitet që politikat stimuluese të autoriteteve publike të vazhdojnë, duke u shoqëruar nga veprimet e nevojshme për pastrimin e bilanceve të bankave nga investimet jocilësore, në mënyrë që sektori bankar në Evropë të përmirësojë në thelb gjendjen e tij financiare, dhe të rifitojë aftësinë e plotë për të realizuar në mënyrë të qëndrueshme funksionin e ndërmjetësimit financiar. Në terma praktikë, përmirësimi i situatës financiare të grupeve bankare evropiane, do të thotë që ato e kanë tani më të lehtë të përmbushin kërkesat e mundshme të filialeve të tyre, për kapital ose linja financimi, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në vijimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar të filialeve të këtyre grupeve bankare, në vendet ku operojnë. Në rastin e vendit tonë, sektori bankar pati mundësi të përfitojë nga një vëllim më i lartë i këtyre financimeve si edhe nga injektime të kapitalit, në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe në muajt e parë të vitit 2009. Përmirësimi i situatës financiare për sektorin bankar në Evropë, do të konsolidohej më tej në rast të rimëkëmbjes së rritjes ekonomike. Nga ky këndvështrim, garancitë për mbarëvajtjen e sektorit tonë bankar, do të forcoheshin.

f. *Megjithëse situata ekonomike dhe financiare në vendet e Evropës Juglindore dhe Qendrore paraqitet ende e paqëndrueshme, ndihmat financiare të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Komisionit Evropian, kanë ofruar një mbështetje të rëndësishme për zbutjen e pritshmërive negative.* Disa prej vendeve të këtij rajoni, në fund të vitit të kaluar u përballën me një situatë të komplikuar financiare, e cila u manifestua në afat të shkurtër me përkeqësim të deficitit të llogarisë korente, nënçmim të fortë të kursit të këmbimit, rritje të fuqishme të normave të interesit, rritje të mundësisë së dështimit në shlyerjen e borxhit etj., të cilat, në vijim sollën një tkurrje të fortë të ekonomisë dhe një përkeqësim të financave publike. Për këtë arsye, FMN dhe Komisioni Evropian ofruan për disa prej këtyre vendeve, një ndihmë financiare prej dhjetëra miliardësh euro. Në sajë të kësaj ndihme, presionet për nënçmimin e kursit të këmbimit u zbutën dhe normat e interesit ranë në nivele më të pranueshme për stimulimin e qarkullimit monetar. Megjithëse ritmet e përkeqësimit janë ngadalësuar, situata në disa prej këtyre vendeve mbetet ende e paqëndrueshme. Sidoqoftë, veprimet që zbusin pasigurinë e investitorëve për zhvillimet ekonomike në këto vende, përmirësojnë perceptimin edhe për vendin tonë, në kushtet e ngjashmërisë relative që ekziston, të paktën me vendet e rajonit.

g. *Janë shtuar shenjat që tregojnë për një ndalim të përkeqësimit të situatës ekonomike globale.* Nga ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe ato më të mëdha të vendeve në zhvillim, vijnë disa sinjale optimiste. Në sferën financiare, krahas përmirësimit të vlerës së aksioneve të institucioneve financiare në bursa në sajë edhe të përmirësimit të rezultatit të tyre financiar, vërehet rritje e indekseve të bursave në përgjithësi në krahasim me nivelin e fundit të vitit. Njëkohësisht, në SHBA dhe në disa vende të Bashkimit Evropian, treguesit që vlerësojnë

gjendjen financiare të bizneseve, shfaqin ngadalësim të përkeqësimit ose një përmirësim të lehtë, duke treguar që mundësitë e financimit të ekonomisë, gradualisht, po përmirësohen. Në drejtim të zhvillimeve ekonomike më të përgjithshme, vërehet se indekset e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve kanë shfaqur shenja përmirësimi, megjithëse ato do të jenë të paqëndrueshme për sa kohë që papunësia vijon të rritet. Nga ana tjetër, financat publike po përballen me një kosto të rëndë. Është ende e paqartë sa të qëndrueshme në kohë do të jenë këto zhvillime dhe sa shpejt ato do të përkthehen në një rigjallërim të zhvillimit ekonomik. Sidoqoftë, perceptimi për një përmirësim të klimës ekonomike botërore, do të ndikonte pozitivisht tek agjentët ekonomikë në tregun e brendshëm, jo vetëm ekonomikisht por edhe nëpërmjet krijimit të pritjeve më optimiste, duke mbështetur një rikthim të sjelljes normale në marrëdhëniet e tyre me sektorin bankar.

3. *Është rritur ndjeshmëria e sistemit financiar dhe sektorit bankar ndaj ecurisë së disa treguesve të veprimtarisë bankare*. Në këtë kuadër, vlerësohet që:

h. *Nevojitet një administrim i kujdesshëm i kërkesave për likuiditet të sektorit bankar*. Konkretisht, për të përballuar rënien e depozitave në tremujorin e fundit të vitit 2008, bankat tregtare pakësuan portofolin e mjeteve të tyre likuide, rritën huamarrjet nga grupet bankare zotëruese dhe atë nga Banka e Shqipërisë. Pesha e depozitave të publikut në financimin e veprimtarisë bankare, ndonëse mbetet mbizotëruese dhe në nivele të larta, pësoi rënie. Ky proces, duhet të monitorohet me kujdes, për të parë se sa i qëndrueshëm do të jetë në kohë si edhe për të shmangur zhvendosjet e ndjeshme drejt huamarrjes me shumicë, veçanërisht asaj në valutë. Në kushtet kur, burimet e financimit në valutë varen nga tregu i huaj, sektori bankar është gjithsesi më i mbrojtur për faktin që linjat e financimit në valutë merren nga grupet e huaja bankare zotëruese. Ky element, zbut ndjeshëm rrezikun e mungesës së rinovimit të tyre në momentin e maturimit. Megjithatë, në tregjet e huaja, aktualisht bankat po bëjnë përpjekje në drejtimin e kundërt, për të pakësuar procesin e huamarrjes në tregjet e shumicës dhe për të rritur depozitat e publikut, një burim financimi i konsideruar si shumë më i qëndrueshëm. Huamarrja e sektorit bankar nga Banka e Shqipërisë, ofron një burim të qëndrueshëm financimi në një situatë të veçantë, dhe ndihmon në kuadër të përmirësimit të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Ky zhvillim, është veçanërisht i rëndësishëm për bankat që nuk janë pjesë e grupeve të huaja bankare. Njëkohësisht, ai lejon bankat tregtare të hartojnë politika të cilat mbështesin më shumë veprimtarinë financiare në monedhën kombëtare. Në këtë këndvështrim, merr rëndësi edhe administrimi i portofolit të letrave me vlerë të cilat shërbejnë si kolateral për huamarrjet me shumicë. Për transaksione të tilla në lekë, bankat tregtare mbështeten nga zotërimet e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, si bono thesari dhe obligacione. Bankat duhet të krijojnë dhe të administrojnë një

portofol të posaçëm të këtyre letrave me vlerë, për t'i përdorur në rastin e nevojave të papritura për likuiditet. Ndërmarrja e veprimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar të letrave me vlerë, do të ishte gjithashtu një faktor mbështetës në këtë drejtim. Në përgjithësi, për t'u siguruar që bankat do të ndjekin politika me konservatore në drejtim të administrimit të rrezikut të likuiditetit, Banka e Shqipërisë po përgatit një rregullore të posaçme, e cila do t'iu kërkojë bankave të përmirësojnë kapacitetet e tyre në drejtim të parashikimit të nevojave për likuiditet, si edhe do të vendosë raporte më të drejta dhe më të ngushta midis burimeve të financimit dhe investimeve të bankave, në drejtim të llojit të valutës, ndryshimit të afatit të maturimit, krijimit të portofoleve të posaçme të kolateraleve etj..

i. *Cilësia e portofolit të kredisë, ka hyrë në një prirje rënëse*. Vështirësitë e sektorit real të ekonomisë, ngadalësimi i rritjes ekonomike dhe vetë tkurrja e fortë e kreditimit për shkak të situatës së paqëndrueshme të likuiditetit në muajt e fundit, kanë sjellë rritjen e vëllimit të kredive me probleme, pavarësisht nga lloji i valutës, mënyra ose sektori i përdorimit. Rritja e kredive me probleme, ka nxitur një proces të shtrëngimit të procedurave në kredidhënie, duke sjellë ulje të vëllimit të kreditimit dhe shkurtim të afatit të kredidhënies. Gjithashtu, ajo është shoqëruar me rritjen e fondeve rezervë të bankave për të përballuar humbjet e mundshme nga kreditë, gjë që ka ndikuar në rënien e rezultatit financiar të sektorit bankar. Sektori bankar duhet ta përballojë këtë situatë, duke synuar të mbajë sa më të qëndrueshme veprimtarinë e tij të ndërmjetësimit financiar, një funksion mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë dhe gjendjen e vetë sektorit. Për këtë arsye, është koha që sektori bankar t'i japë përparësi kreditimit në monedhën kombëtare kundrejt asaj në valutë, duke shfrytëzuar mundësitë më të mëdha që ofrojnë depozitat e publikut dhe huamarrja nga Banka e Shqipërisë. Për këtë, sektori bankar duhet të ndjekë politika më të përshtatshme të përcaktimit të çmimit të kredisë, për të nxitur rritjen e kërkesës për kredi në monedhën vendase.

j. *Sektori bankar është i ndjeshëm ndaj sjelljes së kursit të këmbimit, veçanërisht për ndikimin që kjo përcjell në cilësinë e portofolit të kredisë*. Kredia në valutë mbizotëron në totalin e portofolit të kredisë së sektorit bankar. Shkaqet e rritjes së saj në vite, lidhen me strukturën e bilancit të sektorit bankar, normat më të ulëta të interesit në krahasim me kredinë në lekë, si edhe me perceptimin se qëndrueshmëria e shkuar e kursit të këmbimit të lekut do të vazhdonte edhe në të ardhmen. Është e kuptueshme që nënçmimi i lekut në vlera të mëdha dhe për një kohë të shkurtër, për ata kredimarrës që nuk kanë të ardhura në valutë, rrit vlerën në lekë të kësteve të kredisë që paguhen në valutë, mund të shoqërohet me vonesa në shlyerjen e kredisë dhe shkakton kthimin e saj në kredi me probleme. Nga ky këndvështrim, publiku dhe vetë bankat, si lojtare të fuqishme në tregun e këmbimeve valutore, do të preferonin të kishin një kurs këmbimi të qëndrueshëm. Megjithatë, edhe në këtë rast, zgjidhja më e mirë do të ofrohej nga

zbatimi i politikave më të ekuilibruara të kreditimit të cilat synojnë rritjen e peshës së kredisë në lekë. Përsa i takon pozicionit valutor në bilanc, sektori bankar, si edhe më parë, preferon të ruajë një pozicion të hapur neto në vlera të ulëta, duke kufizuar ndjeshëm madhësinë e humbjeve të mundshme.

k. *Rezultati financiar i sektorit bankar edhe gjatë vitit 2009, do të vazhdojë rënien që nisi në vitin 2008.* Në fakt, kjo është pasojë e rënies së të ardhurave të veprimtarisë, për shkak të rënies së vëllimit të veprimtarive me normë fitimi më të lartë dhe rritjes së kostove të veprimtarisë, veçanërisht prej rritjes së fondeve rezervë për të përballuar humbjet e mundshme nga kreditë. Rënia e rezultatit financiar neto, do të thotë që sektori bankar do të ketë më pak burime të brendshme për të mbështetur veprimtarinë dhe për të rritur kapitalin. Në rastin e bankave që mund të provojnë humbje financiare, kjo do të përkthehej në një pakësim të fondeve të veta. Ndonëse rënia e rezultatit financiar nuk pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në vlerat e kapitalit, bankat duhet të monitorojnë me vëmendje treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë, dhe të rrisin kapitalin në rast nevoje.

4. *Ka mbetur i pandryshuar dhe në nivele të ulëta, rreziku i qëndrueshmërisë së infrastrukturës thelbësore të sistemit financiar dhe veçanërisht të sektorit bankar, siç janë sistemet e pagesave.* Në këtë kuadër, vlerësohet që:

l. *Sistemet e pagesave që administrohen nga Banka e Shqipërisë, kanë funksionuar në mënyrë optimale.* Kjo gjë dëshmohet nga rritja e qëndrueshme e numrit dhe e vëllimit të pagesave gjatë vitit 2008, që pritet të vazhdojë edhe në vitin 2009. Për funksionimin normal dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, si në vlera të mëdha ashtu edhe në vlera të vogla, Banka e Shqipërisë ka caktuar burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe teknologjike, si edhe ka punuar për përmirësimin e kuadrit rregullativ që përmirëson eficiencën dhe sigurinë e sistemeve të pagesave. Gjithashtu, do të vlerësohen rregullisht nevojat për përmirësim të procedurave dhe të infrastrukturës teknologjike, për të mbështetur funksionimin normal të këtyre sistemeve në të ardhmen, në kushtet e rritjes së vëllimit të transaksioneve.

Në përgjithësi, aftësia e sistemit financiar dhe veçanërisht e sektorit bankar për të vepruar në mënyrë të qëndrueshme dhe për t'u mbrojtur nga rreziqet e mësipërme, do të varet edhe nga shtrirja në kohë, madhësia dhe vlera sistemike që shfaq një zhvillim i caktuar, i pafavorshëm.

Mbështetur në treguesit financiarë të sektorit bankar, si edhe në vlerësimin e luhatshmërisë së tyre sipas analizave *stress-test,* qëndrueshmëria e sektorit bankar ndaj rreziqeve të përmendura më sipër, vlerësohet e mirë.

Hapësirë informuese 1. Parashikimet e FMN-së.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në dokumentin e tij "Parashikimi ekonomik botëror, kriza dhe rimëkëmbja" të prillit 2009, thekson se rritja e ekonomisë botërore për vitin 2009, pritet të jetë negative për 1.3 për qind. Ekonomitë e vendeve të zhvilluara do të tkurren me rreth 3.8 për qind (për herë të parë që prej Luftës së Dytë Botërore), ndërsa ekonomitë e vendeve në zhvillim do të rriten vetëm me 1.6 për qind. Nën ndikimin e masave për të lehtësuar financimin si edhe mbështetur nga politika stimuluese monetare dhe fiskale, ekonomia botërore parashikohet të nisë një rigjallërim gradual në vitin 2010, kur rritja ekonomike pritet rreth 2 për qind. Pavarësisht prej stimulit të konsiderueshëm fiskal (duke përfshirë edhe paketën shtesë prej 787 miliardë dollarësh të miratuar nga administrata "Obama"), ekonomia e SHBA pritet të tkurret me 2.8 për qind në vitin 2009 dhe të mos ketë një rritje të ndjeshme në vitin 2010. Norma e rritjes vjetore të çmimeve të konsumit, do të jetë përkohësisht negative gjatë vitit 2009. Financat publike do të përkeqësohen, duke u shoqëruar me rritjen galopante të deficitit buxhetor në 12.3 për qind të PBB-së për vitin 2009.

Për vendet e Eurozonës, pritjet e FMN-së janë edhe më të dobëta. Ekonomia e këtij rajoni do të tkurret me 4.2 për qind në vitin 2009 dhe do të rritet vetëm me 0.4 për qind, në vitin 2010. Situata ekonomike nuk do të jetë e favorshme edhe për vendet e rajonit tonë. Sipas dokumentit "Parashikimi i ndërmjetëm" i janarit 2009 të Komisionit Evropian, pritet që ekonomia e Italisë të tkurret me 2 për qind në vitin 2009 dhe të rifillojë rritjen në vitin 2010. Për Greqinë, parashikimet janë më optimiste, ndonëse rritja ekonomike pozitive për vitin 2009 do të jetë shumë e ulët. Të dyja këto vende, do të përjetojnë një rritje të normës së papunësisë pranë nivelit mesatar të Eurozonës në vitin 2009. Për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, pritjet e FMN-së janë për një tkurrje të ekonomisë me 3.7 për qind në vitin 2009 dhe një rritje të ekonomisë prej 0.8 për qind në vitin 2010. Në dokumentin "Parashikimi i Ndërmjetëm" i janarit 2009, Komisioni Evropian thekson se papunësia në vendet e Bashkimit Evropian do të rritet ndjeshëm gjatë kësaj periudhe (me shtimin e 3.2 milionë të papunëve), dhe norma e papunësisë do të ngjitet në 8.75 për qind në vitin 2009 (në Eurozonë 9.25 për qind), e do të rritet më tej në vitin 2010. Sipas Komisionit Evropian, financat publike do të goditen ndjeshëm gjatë vitit 2009. Në vendet e BE, parashikohet rritja e deficitit primar në 4.5 për qind të PBB-së (nga 2 për qind në 2008-ën). Parashikimet për financat publike janë negative edhe për vitin 2010. Presionet inflacioniste në vendet e Bashkimit Evropian pritet të jenë të dobëta gjatë vitit 2009, për shkak të dobësisë së kërkesës për energji dhe lëndë të para. Norma e rritjes vjetore të çmimeve të konsumit pritet të jetë 1 për qind për vitin 2009, dhe rreth 2 për qind në vitin 2010, si për vendet e Eurozonës ashtu edhe vendet e Bashkimit Evropian.

Tabelë 1. Ecuria e PBB-së dhe inflacionit gjatë viteve 2007-2008 dhe parashikimi për vitet 2009-2010.

	Rritja e PBB_së		*Parashikim*		Inflacioni mesatar vjetor		*Parashikim*	
	2007	2008	*2009*	*2010*	2007	2008	*2009*	*2010*
EKONOMIA GLOBALE	5.2	3.2	*-1.3*	*1.9*	3.9	5.9	*2.5*	*2.4*
Vendet e zhvilluara	2.7	0.9	*-3.8*	*0.0*	2.2	3.4	*-0.2*	*0.3*
ShBA	2.0	1.1	*-2.8*	*0.0*	2.9	3.8	*-0.9*	*-0.1*
Japonia	2.4	-0.6	*-6.2*	*0.5*	0.0	1.4	*-1.0*	*-0.6*
Eurozona	2.7	0.9	*-4.2*	*-0.4*	2.1	3.3	*0.4*	*0.6*
Mbretëria e Bashkuar	3.0	0.7	*-4.1*	*-0.4*	2.3	3.6	*1.5*	*0.8*
Vendet në zhvillim	8.3	6.1	*1.6*	*4.0*	6.4	9.3	*5.7*	*4.7*
Evropa Qendrore dhe Lindore	5.4	2.9	*-3.7*	*0.8*	6.1	8.0	*4.6*	*4.2*
Kina	13.0	9.0	*6.5*	*7.5*	4.8	5.9	*0.1*	*0.7*
India	9.3	7.3	*4.5*	*5.6*	6.4	8.3	*6.3*	*4.0*
Brazili	5.7	5.1	*-1.3*	*2.2*	3.6	5.7	*4.8*	*4.0*
Meksika	3.3	1.3	*-3.7*	*1.0*	4.0	5.1	*4.8*	3.4

*Burimi: *FMN (World Economic Outlook-janar Parashikimi Ekonomik Botëror – Kriza dhe Rimëkëmbja, Prill 2009), FMN databaza.*

2 ZHVILLIMET NË MJEDISIN E JASHTËM

2.1 ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË BOTË

Gjatë vitit 2008, ekonomia botërore u përfshi prej krizës financiare ndërkombëtare. Efektet e kësaj krize u shfaqën në formën e ngadalësimit të theksuar të rritjes ekonomike, rënies së vëllimit të tregtisë, rënies së çmimit të produkteve jofinanciare, rritjes së vështirësive për financim prej sipërmarrjeve dhe familjeve, rritjes së papunësisë dhe përkeqësimit të pritjeve për mirëqenien ekonomike në afat të shkurtër. Vendet e zhvilluara janë goditur më shumë prej efekteve të krizës, për shkak të nivelit të lartë të integrimit të tregjeve. Por aftësia e tyre për të ndërmarrë masa në drejtim të daljes nga kriza, është më e fuqishme në krahasim me vendet në zhvillim. Në përgjithësi, vendet në zhvillim kanë shërbyer si zbutës të efekteve të krizës në ecurinë e ekonomisë botërore, për shkak të shkallës më të ulët të integrimit në tregjet financiare ndërkombëtare, ritmeve më të larta të rritjes ekonomike, sjelljes së ndryshme në drejtim të kursimit-konsumit nga sektori publik dhe privat etj.. Megjithatë, vendet në zhvillim paraqiten më të brishta në drejtim të aftësisë për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të dalë nga kriza, për shkak të mungesës së hapësirave fiskale dhe monetare, dhe një zhvillimi ekonomik jo të ekuilibruar.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ecuria e treguesve të sektorit financiar dhe të atij real u përkeqësua gjatë vitit 2008, duke reflektuar thellimin e mëtejshëm të krizës financiare dhe efektet e përcjelljes së saj në sektorët realë të ekonomisë. Rritja ekonomike vjetore zbriti në 1.1 për qind në vitin 2008, kundrejt 2.2 për qind në vitin 2007. Pavarësisht stimujve të konsiderueshëm monetarë dhe fiskalë të ndërmarrë nga autoritetet publike, FMN pret që ekonomia amerikane të vazhdojë të tkurret gjatë vitit 2009 në nivelin 2.8 për qind dhe të fillojë të rikuperohet gradualisht vetëm gjatë vitit 2010. Në sferën e tregtisë së jashtme, deficiti tregtar i Shteteve të Bashkuara është reduktuar me 6 për qind në vitin 2008, si rrjedhojë e pakësimit të konsumit të brendshëm dhe të investimeve. Kjo pasojë e krizës globale, ndikon pozitivisht në përmirësimin afatmesëm të faktorëve të rrezikut që deri më parë buronin nga ekuilibrat e paqëndrueshëm të zhvillimeve makroekonomike, dhe sipas parashikimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, kjo prirje do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2009.

Niveli i lartë i integrimit midis sektorit financiar dhe sektorit të korporatave jofinanciare në SHBA, bëri që efekti i krizës që përfshiu sistemin financiar, të përcillet shpejt përmes kanaleve të financimit tek sektori i biznesit. Sigurimi i kapitalit të ri në tregjet e brendshme u bë shumë i vështirë dhe i kushtueshëm për sektorin e korporatave, duke çuar në një sërë falimentimesh dhe në një rënie të përgjithshme të aktivitetit të këtij sektori. Shumë biznese u gjendën të detyruara të ulin kostot e tyre nëpërmjet shkurtimit të fuqisë punëtore, me pasojë tkurrjen e tregut të punës dhe rritjen e numrit të të papunëve në vend. Sipas të dhënave të Zyrës së Statistikave të Punës të Qeverisë Amerikane, në fund të vitit 2008 norma e papunësisë në SHBA rezultoi 7.2 për qind krahasuar me 4.6 për qind në fund të vitit 2007. Për vitin 2009, situata

financiare e korporatave amerikane do të vazhdojë të mbetet mjaft e vështirë dhe norma e falimentimit në këtë sektor pritet të jetë e lartë. Nga ana tjetër, gjendja financiare e familjeve amerikane u përkeqësua më tej gjatë vitit 2008 për shkak të rënies së vazhdueshme të vlerës së aktiveve financiare dhe jofinanciare të zotëruara prej tyre[6], rritjes së papunësisë, tkurrjes së kredisë konsumatore nga bankat për shkak të shtrëngimit të kushteve të kredidhënies etj.. Të gjitha këto, të kombinuara dhe me një shkallë të lartë pasigurie për të ardhmen, kanë nxitur një rënie të ndjeshme të konsumit të sektorit privat, duke sjellë rënien e kërkesës për importe.

Për të shmangur një kontraktim edhe më të thellë të ekonomisë amerikane, Rezerva Federale dhe Qeveria e SHBA morën një sërë masash financiare dhe fiskale[7]. Në sferën monetare, Rezerva Federale ka ndjekur një politikë ekspansioniste duke nisur uljet e normës bazë të interesit që prej muajit tetor. Në sferën fiskale, veprimet e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara kanë synuar blerjen e aktiveve jocilësore nga bankat, rritjen e kapitalit të tyre dhe ruajtjen e flukseve të kreditimit në ekonomi. Si pasojë e masave të marra, deficiti buxhetor i SHBA është rritur në 6.1 për qind në vitin 2008, krahasuar me 2.9 për qind në vitin 2007. Rritja e huamarrjes së brendshme dhe të jashtme për financimin e këtij deficiti, shoqërohet me implikime të rëndësishme për stabilitetin financiar global, për shkak të madhësisë së portofolit të letrave me vlerë të borxhit të SHBA që zotërohet prej të huajve, dinamikës së ardhshme të vlerës që ato ofrojnë, si edhe ndikimit mbi segmentet e tjera të tregjeve financiare.

Grafik 1. Ecuria e normës së papunësisë në SHBA.



Burimi: Databaza e Zyrës e Statistikave të Punës (US Bureau of Labor Statistics).

Grafik 2. Ecuria e deficitit fiskal dhe borxhit qeveritar bruto të SHBA-së për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010.



Burimi:FMN – databaza (Parashikimi Ekonomik Botëror – Kriza dhe Rimëkëmbja, Prill 2009).

Për të njëjtat arsye, edhe në Bashkimin Evropian situata ekonomike u kushtëzua ndjeshëm prej përkeqësimit të situatës në sektorin financiar. Shpejtësia e shtrirjes së krizës financiare në ekonominë reale, u ndikua përgjithësisht nga karakteristikat makroekonomike të vendeve anëtare dhe shkalla e ndikimit të sektorit bankar e financiar. Në terma të përgjithshëm, aktiviteti ekonomik i vendeve të Bashkimit Evropian u ngadalësua ndjeshëm dhe shumë vende, në tremujorin e fundit të vitit 2008, hynë zyrtarisht në fazën e një rënieje ekonomike (recesion). Sipas Eurostat, rritja ekonomike e vendeve të Bashkimit Evropian dhe të Eurozonës në tremujorin e tretë rezultoi respektivisht 0.8 dhe 0.7 për qind, ndërsa në tremujorin e katërt rezultoi -1.1 për qind dhe -1.2 për qind[8]. Kontraktimin më të madh të ekonomisë gjatë vitit 2008, e përjetuan Britania e Madhe, Italia dhe Spanja, por dhe disa prej anëtarëve të rinj të Bashkimit Evropian si Hungaria dhe Letonia. Dobësimi i aktivitetit

ekonomik në Evropë pritet të thellohet më tej gjatë vitit 2009, kur pothuaj të gjitha vendet e Eurozonës parashikohet të përjetojnë rënie ekonomike. Sipas FMN-së, rritja ekonomike e Eurozonës do të jetë -2.8 për qind në 2009-ën dhe mund të fillojë të përmirësohet disi në 2010-ën, me 0.2 për qind. Kontraktimi ekonomik i rajonit të Evropës i dobësoi mjaft presionet inflacioniste në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 dhe në fund të vitit, norma e inflacionit arriti në 1.6 për qind (nga 4 për qind rreth gjashtë muaj më parë). Norma e inflacionit pritet të vazhdojë të bjerë gjatë vitit në vazhdim dhe disa vende të zhvilluara rrezikojnë të përjetojnë një periudhë me rritje negative të çmimeve të konsumit (deflacion).

Ngadalësimi i rritjes së PBB-së në vendet e Bashkimit Evropian, ka reflektuar rënien e kërkesës së brendshme si pasojë e rënies së konsumit të familjeve (e konstatuar që në fund të vitit 2007), e rënies së shpenzimeve për investime të firmave të biznesit (e konstatuar që në tremujorin e dytë të vitit 2008) dhe e rënies së eksporteve, si pasojë e dobësimit të kërkesës së jashtme. Ngërçi i përgjithshëm që pushtoi tregjet financiare në gjysmën e dytë të vitit, thelloi presionet negative mbi korporatat jofinanciare evropiane (veçanërisht në ato që kryenin aktivitet në SHBA), kryesisht në tremujorin e fundit të vitit. Tre faktorët kryesorë që çuan në dëmtimin e sektorit të korporatave jofinanciare evropiane dhe që vazhdojnë të përbëjnë një burim rreziku për vitin në vazhdim janë: *së pari*, rënia e vazhdueshme dhe e shpejtë e fitimeve të korporatave gjatë vitit 2008[9], gjë që çoi në rënie të çmimit të aksioneve dhe rritjen e vështirësive për të rritur kapitalin; *së dyti*, niveli i lartë të borxhit në këtë sektor, gjë që rriti ekspozimin ndaj zhvillimeve negative makroekonomike; dhe *së treti*, rritja e normave të huamarrjes e kombinuar dhe me pakësimin e ofertës së kredive nga ana e bankave, gjë që vështirësoi sigurimin e financimeve të reja, rriti ndjeshëm koston e biznesit dhe vuri në vështirësi serioze ekzistencën e tyre. Pasojë e kësaj situate ishte përkeqësimi i kushteve të tregut të punës dhe rritja e numrit të të papunëve. Sipas OECD, norma mesatare e papunësisë në vendet e Eurozonës për vitin 2008 rezultoi 7.4 për qind, por brenda vitit ka ardhur duke u rritur me ritme relativisht të shpejta dhe në muajin dhjetor 2008 arriti në nivelin 8.1 për qind. Për periudhat në vazhdim, situata në tregun e punës në rajonin e Eurozonës pritet të përkeqësohet

Grafik 3. Rritja reale vjetore e PBB-së në disa vende të Eurozonës për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010.



Burimi:FMN – databaza (Parashikimi Ekonomik Botëror – Kriza dhe Rimëkëmbja, Prill 2009).

Grafik 4. Ecuria e inflacionit mesatar vjetor në disa vende të Eurozonës për periudhën 2001-2008 dhe parashikimi për atë 2009-2010.



Burimi:FMN – databaza (Parashikimi Ekonomik Botëror – Kriza dhe Rimëkëmbja, Prill 2009).

Grafik 5. Ecuria e normës së papunësisë në disa vende të Eurozonës.



Burimi: OECD Economic Outlook database.

më tej dhe norma mesatare e papunësisë pritet të arrijë në nivelet 8.6 për qind në vitin 2009 dhe 9.0 për qind, në vitin 2010.

Shtrëngimi i kushteve të huadhënies, pakësimi i "efektit të pasurisë" për shkak të rënies së çmimeve të shtëpive dhe të mjeteve financiare, rritja e pasigurisë dhe humbja e vendeve të punës, si edhe pritjet pesimiste për të ardhmen, kanë sjellë një tkurrje të shpenzimeve për konsum të familjeve evropiane dhe rënie të huamarrjes. Në Raportin e Stabilitetit Financiar të BQE-së për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008, parashikohet që gjatë vitit në vazhdim treguesit e mësipërm do të përkeqësohen duke e ulur më tej nivelin e konsumit.

Përkeqësimi i situatës financiare të sektorit të biznesit dhe familjeve në Eurozonë përbën një burim rreziku për stabilitetin financiar të këtij rajoni, pasi lidhet drejtpërsëdrejti me aftësinë paguese të detyrimeve të tyre ndaj institucioneve financiare, si edhe ndikon mbi konsumin dhe investimet.

Përsa i takon vendeve të rajonit të Baltikut dhe atyre të Evropës Qendrore dhe Juglindore, që prej vitit 2000 kanë njohur përgjithësisht rritje ekonomike të qëndrueshme dhe stabilitet financiar, në sajë të reformave strukturore të nxitura nga procesi i integrimit, rritjes së flukseve të parasë në formën e investimeve direkte dhe të portofolit, rritjes së produktivitetit dhe forcimit të pozicionit konkurrues në tregtinë e jashtme, qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit, rritjes së të ardhurave dhe konsolidimit të gjendjes fiskale. Në sektorin financiar, këto vende kishin pësuar një transformim të rëndësishëm, i dëshmuar edhe prej rritjes së investimeve të institucioneve financiare të fuqishme, kryesisht të vendeve të Eurozonës. Si rezultat, në Suedi, Austri, Greqi dhe Itali, ekspozimi në vendet baltike dhe ato të Evropës Qendrore dhe Juglindore, në formën e kreditimit të sektorit bankar, është i konsiderueshëm[10]. Ky proces ishte nxitur falë përparësisë që këto vende ofronin prej rritjes më të lartë ekonomike, hapësirave për rritjen e ndërmjetësimit bankar veçanërisht në drejtim të kreditimit, afërsisë dhe integrimit të kënaqshëm me qendrat e zhvilluara financiare etj.. Në disa prej këtyre vendeve, rritja e depozitave ishte e pamjaftueshme për të përballuar ritmin e shpejtë të rritjes së kredisë, ndaj procesi i kreditimit u mbështet nga financimi prej burimeve të tjera, kryesisht huamarrjeve nga tregjet financiare. Lehtësia e financimit në tregjet ndërkombëtare, si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik, ka nxitur rritjen e kërkesës së përgjithshme përtej ritmit të rritjes së ekonomisë dhe ka sjellë përkeqësim të bilancit të pagesave dhe të atij fiskal, për disa prej këtyre vendeve. Për këtë arsye, kjo situatë i bënte ato veçanërisht të ndjeshme ndaj qëndrueshmërisë së tregjeve financiare ndërkombëtare.

Kriza financiare ndërkombëtare e ndryshoi këtë ekuilibër të brishtë. Shtrëngimi i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare, e bëri mjaft të vështirë huamarrjen nga bankat e huaja si edhe nga institucionet publike, për të rifinancuar borxhet e tyre në afat të shkurtër. Në të njëjtën kohë, rënia e çmimeve të lëndëve të para dhe të energjisë, ndikoi në pakësimin e flukseve hyrëse dhe prishjen e ekuilibrit të brishtë të pozicionit valutor, duke përkeqësuar edhe situatën fiskale. Investitorët e portofoleve, prej natyre afatshkurtër dhe spekulative, filluan të largohen prej mjeteve financiare të këtyre vendeve.

Presioni mbi kursin e këmbimit të monedhave vendase u rrit së tepërmi. Për këtë arsye, një numër në rritje i këtyre vendeve iu drejtuan strukturave të Bashkimit Evropian dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, duke kërkuar dhe duke siguruar ndihma të konsiderueshme financiare, për mbështetje buxhetore dhe të bilancit të pagesave.

Këto vende po përballen tashmë me rritjen e ndjeshme të çmimit që duhet të paguhet për të mbuluar rrezikun e moskthimit të borxhit të qeverive, ndërkohë që aksesi i sektorit privat në huamarrjen e brendshme dhe të jashtme është kufizuar ndjeshëm. Gjithashtu, sektori bankar dhe financiar po ndeshen me përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së aktiveve, përkeqësimin e rezultatit financiar dhe në përgjithësi, me rënien e aftësive të tij të ndërmjetësimit, përcaktuar nga mungesa e likuiditeteve dhe rënia e nivelit të kreditimit të ekonomisë.

Të gjithë faktorët e mësipërm pritet të ndikojnë zhvillimin e ekonomisë për periudhën afatmesme. Parashikimet për rritjen ekonomike në vitin 2009, të vendeve të rajonit të Baltikut dhe të atyre në Evropën Qendrore dhe Juglindore që janë anëtare të Bashkimit Evropian, tregojnë për një tkurrje të ekonomisë në masën 2.9 për qind. Vendet e tjera të këtij rajoni, pritet të kenë gjithashtu një rënie të ndjeshme të ritmit të rritjes ekonomike. Ato pritet të ndeshen me një mjedis mjaft konkurrues për të tërhequr flukset e nevojshme hyrëse të kapitalit. Oferta tepër e madhe e borxhit qeveritar të vendeve të zhvilluara që do të vërshojë në treg dy vitet e ardhshme, do të thithë para që ndryshe do të ishin përdorur në tregje, si ato të këtij rajoni. Pamjaftueshmëria e financimeve të huaja do të zgjasë fazën e përshtatjes së ekonomive të këtyre vendeve, duke vonuar rigjallërimin e qëndrueshëm ekonomik të tyre.

Hapësirë informuese 2. Ekspozimet e disa vendeve të Evropës Perëndimore ndaj bankave në Evropën Lindore.

Tabelë 2. Ekspozimet e sektorëve bankarë të Evropës Perëndimore në vendet e Evropës Qendrore e Lindore, në 30 shtator 2008.

	Austria	Gjermania	Italia	Franca	Belgjika	Holanda	Suedia
EKSPOZIMI TOTAL							
Në mld usd	277.6	219.9	219.6	155.1	136.7	122.2	106.5
Në % të PBB	74.8	6.6	10.4	6.0	30.1	15.7	23.4
EKSPOZIMI SIPAS VENDEVE (mld usd)							
Rumania	43.7	4.1	13.4	16.5	1.2	10.7	0.2
Hungaria	36.9	35.1	27.0	10.1	17.9	6.1	0.3
Ukraina	14.3	4.8	4.9	10.1	0.8	3.7	5.7
Letonia	0.5	5.0	1.3	0.3	0.0	0.0	23.0
Lituania	0.3	3.5	0.6	0.4	0.1	0.1	27.4
Estonia	0.3	1.0	0.4	0.1	0.1	0.0	29.9

Burimi: BIS, FMN, Reuters.

Ekspozimi i bankave greke në Evropën Juglindore.

Banka Kombëtare e Greqisë, Alpha, Piraeus dhe Eurobank, janë të pranishme në Bullgari, Rumani, Serbi, Shqipëri, Turqi, Poloni dhe Ukrainë. Ekspozimi i përgjithshëm i bankave greke në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore, vlerësohet rreth 55 mld euro ose rreth 22 për qind e PBB-së. Pjesa e tyre e dhënë për vendet e Evropës Juglindore, vlerësohet rreth 14 për qind e portofolit të përgjithshëm të kredive.

2.2 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE NË BOTË

Gjatë vitit 2008, tregjet financiare botërore u karakterizuan nga zhvillime negative që çuan në humbjen e përgjithshme të besimit të publikut dhe të investitorëve dhe dëmtuan rëndë funksionimin normal të tyre. Institucionet financiare, përjetuan rënie të vlerës së aktiveve dhe humbje të burimeve të tyre të financimit. Pas mbylljes së vitit financiar 2007, u konstatua se humbjet e bankave dhe institucioneve të tjera financiare nga asetet e lidhura me kreditë hipotekare jocilësore amerikane ishin shumë të mëdha dhe vazhdonin të rriteshin, ndërkohë që këto aktive zhvlerësoheshin vazhdimisht në tregje. Kjo gjeneroi një situatë paniku me pasojë shtrëngimin e kushteve të huadhënies dhe mungesë të theksuar likuiditeti gjatë gjithë vitit 2008. Në këto kushte, funksionimi i tregjeve financiare veçanërisht në Amerikë dhe në Evropë pati vështirësi serioze.

2.2.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET E PARASË

Kriza e besimit që pushtoi tregjet financiare gjatë vitit 2008, shkaktoi një mungesë të theksuar të likuiditetit në tregjet financiare, shteroi burimet e financimit të bankave dhe pati një ndikim të jashtëzakonshëm mbi bankat që mbështeteshin për financime në tregun e parasë (të shumicës). Rënia e shpejtë e vlerësimit për cilësinë e borxhit të tyre, humbjet nga rivlerësimi për mjetet financiare brenda bilancit, si dhe shfaqja e angazhimeve të mëdha jashtë bilancit, rritën perceptimin e rrezikut mes palëve dhe i bënë më të kujdesshme bankat dhe investitorët e tjerë për huadhëniet ndaj njëri-tjetrit. Si rezultat, institucionet financiare filluan të grumbullojnë dhe të ruajnë likuiditetin, duke dëmtuar rëndë funksionimin e tregut ndërbankar dhe duke shkaktuar rritjen e normave të interesit për huadhënien ndërbankare. Kolapsi i "Lehman Brothers" ashpërsoi efektet e humbjes së besimit që u shtrinë edhe në segmentet e tjera të tregut financiar, siç ishin ato të letrave me vlerë të borxhit të sektorit privat dhe të atij publik në afat të mesëm e të gjatë. Funksionimi i tregjeve që tregtonin instrumente të lidhura me produktet e kredive hipotekare dhe derivatet e tyre, pothuaj u bllokua plotësisht. Vështirësi serioze në tregjet e parasë, veçanërisht pas muajit shtator 2008, përjetoi edhe segmenti i letrave tregtare, të cilat përfaqësojnë angazhime të tregtueshme për shlyerje të huamarrjes së pakolateralizuar nga ana e kompanive dhe institucioneve financiare, si edhe të obligacioneve të emetuara nga bankat. Paqartësia në lidhje me ekspozimin e këtyre institucioneve ndaj efekteve të krizës si edhe shtrëngimi i kushteve të financimit, rriste rrezikun e investitorëve në këtë segment të tregut. Hezitimi i investitorëve, u shoqërua me rritjen e kërkesave financiare për pjesëmarrjen në investime (primet) si edhe me shterimin e likuiditetit. Rritja në koston e fondeve dhe mungesa e tyre, rriti vështirësitë edhe në tregjet e shkëmbimit të financimeve në monedha të ndryshme. Për shembull, bankat evropiane filluan të ndjejnë vështirësi të mëdha për të financuar pozicionet e tyre në dollarë amerikanë. Në këto kushte, mjaft nga institucionet financiare u përballën me vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të tyre afatshkurtra. Për të lehtësuar situatën, bankat qendrore në vendet më të zhvilluara, miratuan disa programe[11], të cilat përmbanin veprime konkrete për injektimin e likuiditetit në treg përmes

nënshkrimit të marrëveshjeve të riblerjes me afate të zgjatura, zgjerimit të llojeve dhe të afatit të maturimit të letrave me vlerë që shërbenin si kolateral, vënies në përdorim të disa programeve të posaçme të financimit për lloje të caktuara të letrave me vlerë të borxhit dhe ndjekjes së një politike të lirshme monetare. Për më tepër, ato kuptuan rëndësinë e veprimit në mënyrë të harmonizuar, të thellë dhe me shtrirje globale, për të injektuar likuiditet në afat të shkurtër dhe për të ofruar likuiditet me afat të mesëm për sistemin bankar.

Veprimet e bankave qendrore, shmangën përkeqësimin e mëtejshëm të situatës dhe lehtësuan gradualisht kushtet e financimit në tregjet ndërbankare, duke pakësuar luhatshmërinë e lëvizjeve të normave të interesit dhe duke shkaktuar rënien e tyre në nivele më të pranueshme (grafik 6).

Grafik 6. Ecuria e disa normave të interesit në tregjet e parasë (janar 2007- shkurt 2009).



Burimi: Të dhënat e BQE dhe British Bankers Association.

2.2.2 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET E KAPITALIT

Përkeqësimi i zhvillimeve në tregjet financiare në tremujorët e tretë dhe të katërt të vitit 2008 dhe reflektimi i krizës në ekonominë reale, nxitën orientimin e investimeve financiare drejt mjeteve me rrezik më të ulët. Kjo shkaktoi një lëvizje masive të kapitalit drejt tregjeve të letrave me vlerë të borxhit qeveritar, veçanërisht drejt atyre amerikane, të konsideruara si aktivet më të sigurta. Rritja e shpejtë e kërkesës për borxhin qeveritar, nën ndikimin dhe të uljeve të konsiderueshme të normës bazë të interesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Evropë, solli rritjen e vlerës së tyre dhe rënien e ndjeshme të normës së kthimit nga investimi (grafik 7). Nga ana tjetër, për shkak të këtij qëndrimi të investitorëve, diferenca midis normës së kthimit nga investimi në borxhin e sipërmarrjeve të biznesit me atë të borxhit qeveritar, një tregues i rrezikut të kreditit, përjetoi një rritje të dukshme gjatë gjithë vitit 2008, veçanërisht në segmentin e instrumenteve të borxhit me renditje të ulët të sigurisë.

Grafik 7. *Yield*-et e letrave me vlerë qeveritare në Eurozonë dhe SHBA (janar 2007-shkurt 2009).



Burimi: Faqja zyrtare e internetit e Bankës Qendrore Evropiane dhe faqja zyrtare e Rezervës Federale, Prill 2009.

Në tregjet evropiane, perceptimi i investitorëve për rritjen e rrezikut të kreditit u shfaq fillimisht tek borxhi i institucioneve financiare. Me thellimin dhe zgjerimin e krizës në tremujorin e fundit të vitit dhe parashikimet pesimiste për ecurinë e ekonomisë botërore, perceptimi për një rrezik të rritur të kreditit u shtri edhe në sektorin e korporatave jofinanciare, siç u dëshmua edhe nga rritja e çmimit të kontratave derivative të rrezikut të kreditit *(Credit Default Swap)*[12]. Rritja e vazhdueshme e tyre si në tregjet amerikane dhe ato evropiane, veçanërisht

Grafik 8. Indeksi i *spread*-it global të obligacioneve të korporatave të Merrill Lynch.



Burimi: FMN – Raporti i Stabilitetit Financiar Global, Prill 2008.

pas falimentimit të "Lehman Brothers", reflektoi shqetësimet në rritje të investitorëve lidhur me mundësinë e falimentimit të institucioneve emetuese të borxhit të siguruar nga kontratat e CDS-ve. Në Eurozonë, në fund të muajit nëntor 2008, rritja e çmimit të kontratave derivative të rrezikut të kreditit shënoi vlerën rekord të 10 viteve të fundit (grafik 5). Ngërçi më i madh u krijua në tregjet e produkteve financiare të strukturuara (derivate) si ABS[13] dhe CDO[14], dhe veçanërisht në segmentin e letrave me vlerë të mbështetura nga kreditë hipotekare. Në tregjet amerikane, rënia e vazhdueshme e çmimeve të shtëpive që shërbenin si kolateral për kreditë e paketuara në këto instrumente derivative dhe paqartësia lidhur me vlerësimin e rrezikut të tyre, sollën një rënie shumë të shpejtë të kërkesës për to dhe pakësim deri në zhdukje të emetimeve të tyre, veçanërisht në transhet me rrezik më të lartë.

Veprimet e qeverive dhe të bankave qendrore[15], në SHBA, në Bashkimin Evropian dhe në vende të tjera të botës, synuan të ndryshojnë perceptimin e nivelit të rrezikut në tregun financiar dhe të rikthejnë besimin e investitorëve. Në SHBA, plani i qeverisë lejonte Thesarin Amerikan të blinte aktivet problematike të institucioneve financiare. Si në SHBA ashtu edhe në Eurozonë, programet e injektimit të likuiditetit të bankave qendrore lejuan mundësinë e përdorimit si kolateral të letrave me vlerë që ishin garantuar prej flukseve të aktiveve të ndryshme financiare me rrezik më të ulët. Këto masa ndikuan në ndryshimin e perceptimit të rrezikut për gjendjen e institucioneve financiare dhe të bankave, duke sjellë një rënie të çmimit të CDS-ve. Megjithatë, çmimi i CDS-ve për grupet e mëdha bankare mbeti relativisht i lartë, duke reflektuar pasigurinë që mbizotëronte në tregje lidhur me mënyrën e zbatimit të këtyre programeve si edhe ndikimin e tyre në situatën financiare të këtyre institucioneve.

Grafik 9. Ecuria e indekseve kryesore të bursave të aksioneve (janar 2007-janar 2009).



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Edhe tregjet kryesore të aksioneve të sipërmarrjeve financiare dhe jofinanciare, hynë në një periudhë të thellë korrektimi në vitin 2008. Rënia e ndjeshme e të ardhurave të institucioneve financiare, shtrëngimi i kushteve të financimit dhe largimi i investitorëve në kushtet e rritjes së perceptimit të rrezikut për dështim, sollën rënie të theksuar të indekseve kryesore në të gjithë botën, veçanërisht në SHBA dhe në Eurozonë. Edhe pse aksionet e institucioneve financiare pësuan rënien më të madhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008, pritjet pesimiste të investitorëve lidhur me ecurinë e ekonomisë globale dhe përkeqësimin e situatës së bizneseve, bënë që prirja rënëse e çmimit të aksioneve si në tregjet amerikane dhe në ato evropiane të përfshinte dhe sektorët e tjerë jofinanciarë.

Përshkallëzimi i krizës financiare në gjashtëmujorin e dytë, ku mjaft institucione financiare dhe kompani biznesi shpallën falimentimin, rëndoi më tej situatën në tregjet e aksioneve. Në fund të vitit 2008, çmimet e aksioneve kishin rënë në nivele shumë më të ulëta nga sa priteshin në gjashtëmujorin e parë. Normat çmim/fitim të aksioneve të kompanive, që përgjithësisht shërbejnë si tregues për të vlerësuar ecurinë e aksioneve në 12 muajt e ardhshëm, dëshmuan që çmimet e aksioneve në tregjet kryesore kishin arritur rënien më të madhe[16] të regjistruar që në vitet '80. Mungesa e financimeve dhe rëndësia e tyre për ekzistencën e sektorit të biznesit, detyroi autoritetet publike të bënin pjesë të paketave të ndihmës financiare edhe lehtësimin e kushteve të kreditimit. Në përgjithësi, këto veprime të autoriteteve publike stabilizuan ecurinë e indekseve në bursat kryesore botërore, por luhatshmëria e lëvizjeve të tyre mbetet e konsiderueshme, në kushtet kur pasiguria e investitorëve për gjendjen financiare të kompanive është ende e pranishme. Kjo nuk pritet të ndryshojë në afat të shkurtër, për sa kohë rigjallërimi i ekonomisë botërore do të jetë i ngadaltë.

2.2.3 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE TË VENDEVE NË ZHVILLIM

Tregjet financiare të vendeve në zhvillim, të cilat u shfaqën relativisht rezistente gjatë fazës së parë të krizës financiare, u përballën me disa sfida të rëndësishme gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008. Fillimisht, qëndrueshmëria e presionit inflacionist në këto vende dhe më pas, rënia e çmimeve të lëndëve të para dhe të energjisë të cilat përfaqësojnë burime të rëndësishme të eksporteve të tyre, vendosën në vështirësi financat e tyre publike. Rënia e ndjeshme e kërkesës botërore për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara dhe thellimi i mëtejshëm i krizës financiare në formën e shtrëngimit të kushteve të financimit, rritën pasigurinë e investitorëve të huaj dhe u shoqëruan me rënien e investimeve. Si rezultat, në periudhën maj-nëntor 2008, indekset kryesore të bursave të aksioneve të vendeve në zhvillim ranë në mënyrë të ndjeshme. Sipas FMN, në periudhën tetor – nëntor 2008, tregjet e aksioneve në këto vende, humbën rreth 1/3 e vlerës së tyre në terma të monedhës vendase dhe rreth 40 për qind të vlerës së tyre të shprehur në dollarë. Diferenca e normës së kthimit nga investimet në borxhin e qeverive të këtyre vendeve me atë të letrave me vlerë të borxhit të Qeverisë së SHBA, e vlerësuar nga Indeksi Botëror i Obligacioneve të Vendeve në Zhvillim, u zgjerua me më shumë se 4 pikë përqindje. Prirja e investitorëve për të zvogëluar portofolet e letrave me vlerë të vendeve në zhvillim, rriti luhatshmërinë në tregjet e kursit të këmbimit duke detyruar autoritetet publike të shisnin rezervat e tyre valutore për të mbështetur monedhën vendase, siç ishte rasti i disa vendeve në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore, i Rusisë, i Brazilit, i Meksikës, i Koresë së Jugut. Ecuria e tregjeve financiare të vendeve në zhvillim gjatë vitit 2008, konfirmoi faktin që këto janë mjaft të ndjeshme ndaj zhvillimeve në tregjet reale dhe financiare të vendeve të zhvilluara dhe se kjo ndërvarësi është realisht më e madhe nga sa ishte perceptuar në fillim të krizës financiare.

Edhe në ekonomitë më të mëdha të vendeve në zhvillim, autoritetet publike kanë ndërmarrë disa masa me karakter financiar dhe reformues, për të nxitur kërkesën e brendshme dhe për të mbështetur rritjen ekonomike. Ndër to, përmendim Kinën, Brazilin, Rusinë dhe Indinë. Në Kinë, këto masa u shpallën në muajin nëntor dhe përfshinin kryesisht projekte për ruajtjen e mirëqenies publike, për investime në infrastrukturë, për mbrojtjen e mjedisit dhe për rinovimin e teknologjisë, në një vlerë të përgjithshme prej 585 miliardë dollarësh. Autoritetet publike në këto vende, besojnë se masa të tilla do të rikthejnë ritmet e qëndrueshme të rritjes ekonomike në vitin 2010.

2.2.4 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET E KËMBIMIT VALUTOR DHE TË LËNDËVE TË PARA

Niveli i lartë i pasigurisë për zhvillimet financiare dhe ekonomike që ka karakterizuar vitin 2008, është reflektuar dukshëm në ecurinë e tregjeve të këmbimit valutor dhe në tregjet e lëndëve të para. Përshkallëzimi në rritje i krizës financiare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkeqësoi pritjet mbi ecurinë e ekonomisë amerikane dhe fillimisht pakësoi kërkesën për aktive financiare në dollarë amerikanë, veçanërisht atë private. Kjo prirje, pakësoi më tej kërkesën për dollarë amerikanë dhe thelloi zhvlerësimin e monedhës amerikane ndaj monedhave kryesore, veçanërisht ndaj euros. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2008, vlera e euros u rrit nga 1.47 dollarë në muajin janar, në 1.57 dollarë në muajin korrik. Situata lëvizi në drejtim të kundërt gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, kur përhapja e krizës në Evropë dhe shtrirja e saj e mëtejshme në rang botëror, shkaktuan një zhvendosje të kursimeve financiare nga e gjithë bota drejt letrave me vlerë të Qeverisë së SHBA-së, të cilat u konsideruan si letrat me vlerë me rrezik më të ulët. Kjo solli rritje të konsiderueshme të kërkesës për dollarë e për pasojë, vlerësimin e ndjeshëm të tij kundrejt monedhave të tjera (grafik 10). Situata e vështirë e tregjeve financiare, e ka shtuar pasigurinë normale që ekziston në tregjet e këmbimit valutor. Megjithatë, për të ardhmen e parashikueshme, tregjet mendohet se do të favorizojnë investimet në mjetet e atyre vendeve që do të dalin nga kjo krizë me tregues makroekonomikë sa më të qëndrueshëm.

Grafik 10. Ecuria e kursit të këmbimit euro/dollarë (janar 2007 - janar 2009).



Burimi: Faqja e internetit të BQE.

Grafik 11. Ecuria e indekseve të çmimeve të lëndëve të para kryesore.



Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Çmimet e lëndëve të para dhe të energjisë u rritën gjatë gjysmës së parë të vitit 2008, në vijim të një prirjeje të nisur që në vitin 2000, si rezultat i zhvillimit të fuqishëm ekonomik botëror në kushtet e likuiditetit të bollshëm dhe të normave të ulëta të interesit. Në

mesin e vitit 2008, çmimi i naftës arriti në 145 dollarë për fuçi, pothuaj pesë herë më i lartë se niveli i fillimit të vitit 2000. Kjo rritje u diktua prej rritjes së kërkesës së përgjithshme për energji, veçanërisht nga vendet e mëdha në zhvillim si Kina, India etj., dhe pasigurisë për mjaftueshmërinë e ofertës së naftës në të ardhmen. Çmimet e produkteve ushqimore gjithashtu, vazhduan të rriten në mënyrë shqetësuese deri në mes të vitit 2008. Gjatë periudhës 2000 – mes i vitit 2008, çmimet e produkteve ushqimore në terma globalë, u rritën me rreth 150 për qind[17] (grafik 11). Kjo gjë erdhi pjesërisht si pasojë e rritjes së të ardhurave për frymë dhe e rritjes së konsumit ushqimor në vendet në zhvillim si edhe pjesërisht, për shkak të pakësimit të ofertës. Kjo tendencë krijoi një situatë tepër të vështirë për vendet me të ardhura më të ulëta për frymë, të cilat gjatë periudhës 2007- gjysma e parë e vitit 2008, përjetuan një situatë mjaft të vështirë ushqimore. Çmimet e metaleve dhe lëndëve të tjera të para të prodhimit, gjithashtu njohën një rritje të konsiderueshme deri në mesin e vitit 2008, duke vijuar prirjen e nisur që prej vitit 2007. Përtej faktorëve specifikë të secilës kategori të lëndëve të para dhe lëvizjeve të ekuilibrit të kërkesës dhe ofertës në tregjet e ndryshme, një pjesë e rritjes së përgjithshme të çmimit të tyre gjatë dy viteve të fundit, shpjegohet edhe me fillimin e krizës në tregjet financiare. Humbjet e mëdha nga zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe pasiguria që pushtoi tregjet financiare, nxitën riorientimin e fondeve të investitorëve drejt tregjeve të mallrave, duke sjellë rritjen e çmimeve të këtyre të fundit.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, rënia e konsiderueshme e kërkesës nga vendet e zhvilluara dhe ngadalësimi i përgjithshëm i ekonomisë botërore, ndryshuan krejtësisht ecurinë e çmimeve në tregjet e lëndëve të para. Pavarësisht masave të OPEK-ut për të pakësuar prodhimin dhe prezencës së tensioneve gjeopolitike në rajonet prodhuese të naftës (dhe nënprodukteve të saj), në muajin nëntor 2008, çmimet e naftës ranë me rreth 60 për qind prej nivelit më të lartë të mesit të vitit 2008. Për shkak të ngadalësimit të përgjithshëm të kërkesës botërore, edhe çmimet e metaleve dhe të produkteve ushqimore shënuan rënie të ndjeshme gjatë gjysmës së dytë të vitit 2008, duke dëmtuar veçanërisht ecurinë ekonomike të vendeve eksportuese të tyre. Për vitin 2009, parashikohet që ecuria e dobët e aktivitetit ekonomik global dhe rënia e mëtejshme e kërkesës nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, do të vazhdojnë të mbajnë çmimet e naftës dhe të lëndëve të tjera të para, në nivele shumë më të ulëta se ato të gjysmës së parë të vitit 2008. Megjithatë rigjallërimi i ekonomisë botërore në një periudhë afatmesme, do të shoqërohet me rritjen e kërkesës dhe të çmimit të tregut për këto produkte. Një element pozitiv i kësaj perspektive, është nxitja që ajo ofron për zhvillimin e burimeve alternative të energjisë, të cilat duhet të ekuilibrojnë kërkesën dhe ofertën për produktet e energjisë në afat të gjatë.

2.3 SEKTORI BANKAR

Viti 2008, ishte i jashtëzakonshëm për sa i takon ngjarjeve të tij ekonomike e financiare, dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë bankare. Situata e likuiditetit të bollshëm dhe me çmim të lirë që vazhdonte prej disa vitesh në kushtet e

përmirësimit të kontrollit mbi normën e inflacionit, rritja e vlerës së aktiveve financiare dhe jofinanciare dhe rritja e konkurrencës në kushtet e rënies së normave të fitimit, ofruan stimuj të gabuar në industrinë bankare për njohjen dhe për vlerësimin e rrezikut të drejtimeve kryesore të veprimtarisë dhe të instrumenteve financiare të caktuara, duke favorizuar zgjerimin e shpejtë të vëllimeve të tregtimit me rrezik të lartë kundrejt përfitueshmërisë afatgjatë të investimeve. Për shkak të rënies së normave të fitimit dhe në kërkim të pandalshëm të rritjes së të ardhurave, bankat në vendet e zhvilluara, veçanërisht në SHBA, thelluan më tej procesin e risive të disa produkteve financiare, kryesisht të atyre që lidheshin me tregtueshmërinë e portofolit të kredive nëpërmjet rifinancimit të tyre me letra me vlerë të emetuara për investitorë, që kërkonin tipare të caktuara të rrezikut dhe të kthimit nga investimi. Rritja e kompleksitetit të këtyre veprimeve financiare, u shoqërua me paqartësi në vlerësimin e nivelit të rrezikut të produktit bazë, në këtë rast të kredisë, nga strukturat drejtuese të vetë institucioneve financiare, nga aksionerët e tyre, nga investitorët dhe nga mbikëqyrësit. Në të njëjtën kohë, gjithnjë e më shumë, financimi po kryhej në tregjet financiare (të shumicës) dhe bankat po i largoheshin financimit nëpërmjet depozitave të individëve dhe të familjeve, duke rritur kështu shkallën e paqëndrueshmërisë së burimeve të financimit. Shkalla e lartë e integrimit të tregjeve financiare, veçanërisht mes vendeve të zhvilluara, lejoi përhapjen e shpejtë të këtij modeli. Autoritetet publike, për shkak të fokusit të tyre në nivel kombëtar dhe në zhvillimet individuale të institucioneve të ndryshme; për shkak të mungesës së rregullimit ose të pamjaftueshmërisë së tij për institucione financiare që vepronin si banka e për produkte të caktuara financiare; dhe për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve e të përqasjeve të ndryshme në nivel kombëtar, nuk ishin në gjendje të konceptonin dhe të vepronin në kohë për të parandaluar këtë prirje. Rritja e normave të interesit për shkak të presioneve inflacioniste në mes të vitit 2006 në SHBA, i dha shkëndijën procesit të përkeqësimit të portofolit të kredive hipotekare, i cili deri në atë moment ishte karakterizuar prej dobësimit të standardeve të kredidhënies nga ana e bankave dhe institucioneve financiare, dhe mbingarkesës me borxh të familjeve[18]. Prej korrikut të vitit 2007 e në vazhdim, thellimi i humbjeve dhe paaftësia e bankave për të rifinancuar pozicionet e tyre në tregjet financiare për shkak të hezitimit të investitorëve, sollën humbjen e likuiditetit në këto tregje. Mungesa e rifinancimit, nxiti shtrëngimin e kredidhënies dhe rënien e kërkesës për aktive jofinanciare si për shembull, për shtëpi, për automjete etj.. Portofoli i kredive u përkeqësua më tej, ndërkohë që familjet dhe individët humbën "efektin e pasurisë" që deri atëherë ndjenin prej rritjes së vlerës së shtëpive. Këto zhvillime e futën procesin në një spirale përkeqësimi, e cila u përshpejtua edhe prej zhvlerësimit të mjeteve financiare në bilancin e bankave në kushtet e zbatimit të parimit kontabël për vlerësimin e tyre me vlerë tregu. Kështu, mjaft grupe të mëdha bankare (GBMK) pësuan humbje të konsiderueshme në bilanc për shkak të zhvlerësimit të vazhdueshëm të aktiveve të tyre në tregjet financiare. Përkeqësimi i kushteve në tregjet e parasë dhe të kapitalit, uli aftësinë e tyre për të siguruar kapital të ri për të përballuar humbjet dhe për të mbështetur më tej veprimtarinë. Në këto kushte, ato iu drejtuan për financim Fondeve të Pasurisë së Shteteve të ndryshme ose qeverive të tyre. Problemi i likuiditetit, u shndërrua në këtë mënyrë në problem të aftësisë së tyre për të mbijetuar financiarisht dhe ligjërisht.

Vlerësohet që humbjet më të mëdha[19] dhe njëkohësisht, rritjen më të madhe të kapitalit që nga muaji korrik i vitit 2007 deri në nëntor të vitit 2008, e patën bankat e Amerikës së Veriut, të ndjekura nga bankat e Evropës dhe më pak bankat e Azisë (grafikë 12 dhe 13).

Grafik 12. Humbjet e bankave si pasojë e zhvlerësimeve të aktiveve (në miliardë dollarë).

(T2 2007-nëntor 2008)



Burimi: Banka Qendrore Evropiane - Raporti i Stabilitetit Financiar, 6-mujori i dytë 2008.

Grafik 13. Rritja e kapitalit nga bankat (në miliardë dollarë).

(T2 2007-nëntor 2008)



Burimi: Banka Qendrore Evropiane - Raporti i Stabilitetit Financiar, 6-mujori i dytë 2008.

Si rezultat i humbjeve financiare, norma e kthimit mbi kapitalin e GMBK evropiane (grupe të mëdha bankare dhe komplekse) erdhi vazhdimisht në rënie. Niveli mesatar i ROE-s për GMBK-të e Zonës së Euros ra nga 12.6 për qind në 2007-ën, në -1.2 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2008. Totali i humbjeve në Evropë gjatë kësaj periudhe arriti rreth 262 miliardë dollarë nga të cilat 52 për qind i përkisnin bankave të Britanisë së Madhe dhe Zvicrës të marra së bashku (grafikë 14 dhe 15).

Grafik 14. Humbjet e bankave në Evropë si pasojë e zhvlerësimit të aktiveve (në miliardë dollarë).

(T2 2007-nëntor 2008)



Burimi: Banka Qendrore Evropiane - Raporti i Stabilitetit Financiar, 6-mujori i dytë 2008.

Grafik 15. Rritja e kapitalit nga bankat në Evropë (në miliardë dollarë).

(T2 2007- nëntor 2008)



Burimi: Banka Qendrore Evropiane - Raporti i Stabilitetit Financiar, 6-mujori i dytë 2008.

Procesi i falimentimeve të rëndësishme që kishin lidhje me situatën e krizës, filloi në muajin korrik 2008 në SHBA, kur autoritetet vendosën të mbyllin bankën

"IndyMac". Në mungesë të efektit të pritur pas krijimit të disa lehtësive për financim, në muajin shtator autoritetet amerikane vendosën nën administrim dy institucionet financiare kryesore në financimin e tregut të shtëpive, "Fannie Mae" dhe "Freddie Mac". Situata rrezikoi të dilte jashtë kontrollit të autoriteteve kur një nga bankat më të mëdha të investimeve "Lehman Brothers", kërkoi ndihmë për të mbuluar humbjet e jashtëzakonshme financiare, si rezultat i ekspozimit në produkte jocilësore dhe i pamundësisë për të rifinancuar detyrimet e saj. Pas negociatave të pasuksesshme me autoritetet amerikane dhe me banka të tjera për të gjetur një blerës të ri, "Lehman Brothers" me borxhe në vlerën 613 miliardë dollarë, shpalli falimentimin. Megjithatë, në muajin shtator, autoritetet amerikane nxitën realizimin e marrëveshjes për shitjen e bankës tjetër të investimeve "Merril Lynch" tek "Bank of America" për rreth 50 miliardë dollarë; nxitën ndryshimin e pronësisë së disa bankave të tjera problematike, si edhe financuan nevojat emergjente të kompanisë së sigurimeve "AIG". Në fund të muajit shtator, Rezerva Federale e SHBA miratoi kërkesën e dy bankave të mbetura të investimit, për të ndryshuar statusin e tyre në mënyrë që të kalonin nën mbikëqyrjen e saj dhe të përfitonin nga programet e financimit që ajo ofronte për institucionet financiare që mbikëqyrte. Gjithashtu, u realizua mbyllja e bankës "Washington Mutual" pasi veprimet e saj bankare iu kaluan bankës tjetër "JP Morgan Chase".

Edhe në Evropë, disa banka dhe institucione financiare të mirënjohura të vendeve të Eurozonës, si "Dexia", "Fortis" dhe "Hypo Real Estate" patën nevojë për një injektim të menjëhershëm të kapitalit, i realizuar prej qeverive të Francës, të Belgjikës, të Luksemburgut, të Holandës dhe të Gjermanisë. Në Britaninë e Madhe, autoritetet lehtësuan konsolidimin në sektorin financiar jobankar të specializuar në financimin e tregut të shtëpive, nxitën bashkimin midis bankave "Lloyds TSB" dhe "HBOS", si edhe ndërhynë për të zgjidhur vështirësitë e bankës "Bradford and Bingley", duke kaluar në pronësi publike një pjesë të aktivitetit të saj dhe më pas, duke realizuar mbylljen përfundimtare të saj.

Me zhvillimin e këtyre ngjarjeve, bankave iu desh të përballonin rënien e vlerës së kursimeve dhe shkurtimin e afateve të tyre të maturimit, në kushtet e tronditjes së besimit të publikut në sektorin bankar.

Masat e marra nga autoritetet publike në vendet e zhvilluara[20], në mënyrë gjithnjë e më të harmonizuar, për të ndihmuar me likuiditet dhe për të rikapitalizuar sektorin bankar, për të garantuar borxhet e tyre në tregjet financiare dhe për të rritur vlerën e garantimit të depozitave, pakësuan rrezikun sistemik dhe ndihmuan në stabilizimin e situatës në fund të vitit 2008. Këto masa kishin rëndësi edhe për vendet në zhvillim, pasi ato minimizuan rrezikun e dështimit të grupeve bankare të vendeve të zhvilluara, të cilat kanë shtrirë investimet e tyre në sektorin bankar të vendeve në zhvillim.

Në sajë të masave të autoriteteve publike, konstatohet një përmirësim i rëndësishëm i kushteve të likuiditetit, veçanërisht në tregun ndërbankar të vendeve të zhvilluara, si edhe një përmirësim i segmentit afatshkurtër të tregut të letrave me vlerë të borxhit privat. Megjithatë, ruajtja e aktiveve me probleme në bilancin e bankave dhe pasiguria për shpejtësinë e rigjallërimit ekonomik,

do të vazhdojnë të ushtrojnë presion në rezultatin financiar të bankave për periudhën afatmesme.

Hapësirë informuese 3. Masat e marra nga autoritetet publike ndërkombëtare në vjeshtën e vitit 2008.

Në sferën monetare, me veprime të njëpasnjëshme, bankat qendrore të vendeve më të zhvilluara thelluan procesin e liberalizimit të injektimit të likuiditeteve në tregjet respektive. Për këtë qëllim, u ndryshuan instrumentet përkatëse, u zgjerua spektri i institucioneve financiare pjesëmarrëse si edhe llojet e kolateralit, si edhe u zgjat afati i financimit. Në këtë kuadër, për t'i ardhur në ndihmë plotësimit të nevojave të tregjeve financiare botërore për likuiditet në dollarë, në fund të muajit shtator, Rezerva Federale e SHBA rriti në 620 miliardë dollarë vlerën e përgjithshme të marrëveshjeve me Bankën e Japonisë, Bankën e Kanadasë, Bankën e Rezervës së Australisë, Bankën e Anglisë, Bankën Qendrore Evropiane (BQE), Bankën e Suedisë, Bankën e Danimarkës, Bankën e Norvegjisë dhe me Bankën Kombëtare të Zvicrës, për shkëmbimin e përkohshëm të dollarit kundrejt monedhave vendase. Në fund të muajit tetor, marrëveshje të tilla u realizuan me Bankën e Rezervës së Zelandës së Re për vlerën 15 miliardë dollarë, dhe me Bankën Qendrore të Brazilit, Bankën e Meksikës, Bankën e Koresë dhe me Autoritetin Monetar të Singaporit për vlerën e përgjithshme 30 miliardë dollarë. Bankat qendrore synuan gjithashtu që t'i jepnin ekonomisë një stimul financiar më afatgjatë nëpërmjet një politike monetare të lirshme, në kushtet kur pritjet për një ngadalësim të theksuar të zhvillimit ekonomik zbusnin presionet inflacioniste. Kështu, Rezerva Federale e SHBA uli normën e interesit të politikës monetare me 1 për qind gjatë muajit tetor. Gjysma e kësaj uljeje u realizua në datën 8 tetor, si pjesë e një veprimi të harmonizuar me gjashtë banka të tjera qendrore, duke përfshirë BQE. Në muajin dhjetor, Rezerva Federale e SHBA uli përsëri normën e interesit të politikës monetare, duke përcaktuar zonën e lëvizjes së saj midis 0 për qind dhe 0.25 për qind. Në Eurozonë, BQE ndryshoi formën e instrumentit kryesor të financimit, duke hequr kufizimet për financim për bankat, me normën e interesit të politikës monetare si edhe e uli tre herë këtë të fundit. Në datën 8 tetor BQE uli me 0.5 për qind normën e interesit të politikës monetare, në nivelin 3.75 për qind. Dy ulje të tjera, u kryen përkatësisht në datat 12 nëntor dhe 10 dhjetor, me një vlerë të përgjithshme prej 1.25 për qind. Në fund të vitit 2008, norma e interesit të politikës monetare të BQE ishte në nivelin 2.5 për qind. Gjatë periudhës, ulje të normës së interesit u realizuan edhe nga banka të tjera qendrore si Banka e Anglisë, Banka e Kanadasë, Banka e Suedisë, Banka Kombëtare e Zvicrës etj..

Në sferën fiskale, veprimet e qeverive të vendeve të zhvilluara ekonomike kanë qenë të jashtëzakonshme. Në fillim të muajit tetor, Kongresi i SHBA ktheu në ligj Aktin e Stabilizimit Emergjent Ekonomik, i cili parashikonte krijimin e një fondi prej rreth 700 miliardë dollarësh, për blerjen e aktiveve jocilësore nga bankat dhe për rritjen e nivelit të kapitalit të tyre. Si rezultat, deri në fund të muajit dhjetor, Qeveria e SHBA zgjeroi blerjen e aksioneve të preferuara në kapitalin e dhjetëra bankave për një vlerë të përgjithshme shtesë prej rreth 112 miliardë dollarësh. Gjithashtu, Qeveria dhe Rezerva Federale e SHBA, pranuan ndryshimin e statusit të disa institucioneve financiare të rëndësishme, duke përfshirë shoqëri sigurimi dhe të tjera, me qëllim që ato të plotësonin kushtet për të përfituar prej fondit të kapitalizimit. Përdorimi i këtij fondi nga ana e institucioneve që mbledhin depozita nga publiku ose që zotërojnë banka, shoqërohej me disa kushte të cilat ndryshonin thelbësisht mënyrën e vendimmarrjes së tyre.

Në Evropë, përcaktimi i masave të tilla kërkoi më tepër kohë në kushtet e nevojës për harmonizim të veprimeve në kuadër të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Në datën 12 tetor u realizua takimi i kryeministrave të vendeve të Eurozonës dhe drejtuesve të BQE. Në deklaratën zyrtare të këtij takimi, përfaqësuesit më të lartë të vendeve të Eurozonës mbështetën masat e marra deri në atë kohë, në drejtim të mbështetjes së institucioneve financiare me rëndësi sistemike dhe të parandalimit të falimentimit të tyre, të sigurimit të transparencës maksimale për njohjen e plotë të ekspozimeve problematike në banka, si edhe të përmirësimit të skemave ekzistuese të sigurimit të depozitave të publikut. Për këtë të fundit, Bashkimi Evropian vendosi të rrisë nivelin minimal të garantimit të depozitave në 50 mijë euro.

Në të njëjtën kohë, këto autoritete shprehën angazhimin e tyre për të vepruar së bashku në mënyrë të vendosur dhe të plotë, për të rivendosur besimin në funksionimin normal të sistemit financiar, duke synuar vendosjen e kushteve të përshtatshme të financimit për ekonominë. Në mënyrë më të detajuar, ato theksuan se do të veprojnë në drejtim të: a) sigurimit të kushteve të përshtatshme të likuiditetit për institucionet financiare; b) lehtësimit të kushteve të shtrënguara të financimit të bankave; c) mbështetjes me kapital të institucioneve financiare në mënyrë që ato të ruanin financimin për ekonominë; d) rikapitalizimit eficient të bankave që kishin probleme; e) interpretimit me fleksibilitet të rregullave të kontabilitetit në kushtet e situatës së jashtëzakonshme të tregjeve; dhe f) forcimit të procedurave të bashkëpunimit midis vendeve evropiane.

Në vijim të këtyre direktivave dhe parimeve, në datën 26 nëntor, Komisioni Evropian shpalli Planin e Rigjallërimit Ekonomik Evropian, i cili synonte: a) vendosjen e masave për rritjen e kërkesës së brendshme, ruajtjen e niveleve të punësimit dhe rivendosjen e besimit në sistemin financiar në afat të shkurtër; dhe b) realizimin e investimeve eficiente për të ruajtur rritjen ekonomike dhe një mirëqenie të qëndrueshme në afat të gjatë. Ky plan, ofronte një stimul fiskal me një vlerë të përgjithshme prej 200 miliardë eurosh ose 1.5 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të Bashkimit Evropian, i cili duhet të ofrohej në kohën e duhur, të ishte i fokusuar dhe njëkohësisht i përkohshëm. Në mënyrë individuale, përpara finalizimit të këtij plani, disa vende si Britania e Madhe, Gjermania, Suedia, Portugalia, Holanda, Franca, Italia, Greqia (28 miliardë euro), Finlanda, Spanja, Austria (100 miliardë euro) dhe Sllovenia, kishin përgatitur planet e tyre kombëtare për mbështetjen e sektorit financiar dhe për lehtësimin e kushteve të kreditimit, në përputhje me parashikimet e rregullave të Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore. Paketat e këtyre vendeve kishin ngjashmëri dhe pothuaj të gjitha parashikonin disa veprime të përkohshme të cilat përfshinin: përcaktimin e një fondi për kapitalizimin e bankave, dhënien e garancive për borxhin e ri të krijuar nga bankat vendase si edhe vendosjen e disa kushteve në mënyrën e drejtimit dhe orientimin e veprimtarisë së bankave që do të përdornin këtë fond. Lehtësimi i kushteve të kreditimit parashikonte krijimin e programeve të caktuara për mbështetjen e financimit (në shuma më të mëdha, me norma interesi më të ulëta, me garanci etj.) të sipërmarrjeve në sektorë të rëndësishëm, veçanërisht të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që deri para vjeshtës së vitit 2008 kishin pasur një gjendje të mirë financiare.

Harmonizimi i veprimeve u mundësua edhe në nivel botëror. Për këtë qëllim, masat për përballimin e krizës financiare u diskutuan në takimin e Grupit të 20 vendeve (ekonomive) më të mëdha të botës (që përfaqësojnë 80 për qind të ekonomisë botërore), i cili u zhvillua në 15 nëntor 2008. Në takim, përfaqësuesit më të lartë të këtyre vendeve, në praninë edhe të përfaqësuesve më të lartë të Bashkimit Evropian, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të FMN, të Bankës Botërore dhe të Forumit të Stabilitetit Financiar, arritën një marrëveshje mbi disa parime bazë të cilat synonin reformën e tregjeve financiare për të siguruar që një krizë botërore e ngjashme të mos përsëritet në të ardhmen. Parimet shprehnin angazhimin e këtyre vendeve dhe të institucioneve ndërkombëtare, për të forcuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe kuadrin rregullativ të tregjeve financiare. Njëkohësisht, këto parime synonin forcimin

e bashkëpunimit ndërkombëtar, reformimin dhe forcimin e burimeve financiare të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe rritjen e rezistencës ndaj veprimeve që shkaktojnë mbylljen e ekonomive kombëtare ndaj tregjeve.

Hapësirë informuese 4: Rezultatet financiare për vitin 2008 të grupeve të huaja, të pranishme në sektorin tonë bankar.
(Burimi: Raportet vjetore të publikuara në faqet e internetit të bankave përkatëse.)

1. RAIFFEISEN INTERNATIONAL (AUSTRI)
Raiffeisen International Bank-Holding AG, pjesë e Grupit RZB, e mbylli vitin 2008 me një fitim neto prej 982 milionë eurosh, në rritje me 16.7 për qind krahasuar me një vit më parë. Provigjonet u rritën me 119 për qind kundrejt vitit të kaluar, duke arritur në 780 milionë euro. Rritja e tyre ishte mjaft më e lartë sesa rritja e vëllimit të biznesit dhe motivi kryesor për këtë ishte rënia e cilësisë së kredimarrësve si dhe renditjet më të ulëta të brendshme e të jashtme që erdhën si pasojë e kësaj.

Fitimi i konsoliduar për tremujorin e katërt të vitit 2008 është 120.5 milionë euro, në rënie me 44 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë.

Fitimi para taksave arriti në 1 429 milionë euro (+16 për qind). Megjithatë, për shkak të provigjoneve të larta, kjo rritje ishte më e ulët sesa ajo e të ardhurave bruto të veprimtarisë. Arsyeja kryesore ishte ngadalësimi i konsiderueshëm i aktivitetit ekonomik në Evropën Qendrore e Lindore, i cili e shfaqi ndikimin e vet negativ mbi fitimet vetëm në tremujorin e katërt të vitit 2008.

Raporti shpenzime/të ardhura arriti në 54 për qind, duke paraqitur një rënie me 3.6 pikë përqindje, gjë që reflekton rritje të eficiencës. Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik arriti në 8.1 për qind (-2.4 pikë përqindje).

Kthimi neto nga kapitali aksioner arriti në 16.6 për qind, në rënie me 3.6 pikë përqindje. Fitimet për aksion janë 6.39 euro (+10.2 për qind), ndërsa dividenti i propozuar 0.93 euro për aksion.

Totali i aktiveve u rrit me 17.4 për qind, duke arritur në rreth 85.4 miliardë euro në fund të vitit 2008. Depozitat e klientëve arritën në 44.2 miliardë euro, me një rritje prej 9.3 për qind kundrejt fundit të vitit të mëparshëm, ndërsa kreditë arritën në 57.9 miliardë euro, me një rritje prej 18.5 për qind. Numri i klientëve arriti në 14.7 milionë, duke u rritur me rreth 1 milion. Kontributin më të madh në rezultatet e grupit, e kanë dhënë ish-Republikat Sovjetike (që sollën 40 për qind të fitimit bruto të grupit), të ndjekura nga Evropa Juglindore (33 për qind) dhe nga Evropa Qendrore (27 për qind).

Në fund të vitit 2008, banka Raiffeisen në Shqipëri përbëntë 2.38 për qind të totalit të aktiveve të Raiffeisen International.

2. INTESA SANPAOLO (ITALI)
Fitimi neto i konsoliduar në fund të vitit 2008, arriti në 3.9 mld euro (duke përjashtuar zërat e jashtëzakonshëm) ose 10.6 për qind më pak kundrejt fundit të vitit të kaluar.

Raporti shpenzime/të ardhura arriti në 54.7 për qind, duke paraqitur një rritje me rreth 6 pikë përqindje, pra një rënie të eficiencës, krahasuar me fundin e vitit 2007.

Kthimi neto nga kapitali aksioner arriti në 5.2 për qind ose 14 pikë përqindje më poshtë sesa një vit më parë, duke shënuar edhe në këtë rast rënie të eficiencës në veprimtarinë e grupit. Të ardhurat neto nga interesi shënuan një rritje me 12.2 për qind, duke arritur në 11 630 milionë euro në fund të vitit 2008. Fitimi për aksion ishte 0.2 euro ose 0.6 për qind më pak sesa vitin e kaluar. Për të forcuar kapitalizimin e grupit (raporti i kapitalit bazë me aktivet e ponderuara me rrezik arriti në 7.1 për qind), Bordi i Menaxhimit vendosi që për vitin 2008 aksionerëve të mos u paguhen dividentë.

Provigjonet neto arritën në 2 061 milionë euro (ishin 811 milionë euro në fund të vitit 2007 dhe 970 milionë euro në fund të tremujorit të tretë të vitit 2008). Ekspozimi neto i grupit ndaj produkteve të strukturuara të kreditit që mbështeteshin mbi kreditë amerikane subprime ishte 29 milionë euro, në fund të dhjetorit 2008.

Totali i aktiveve në fund të vitit 2008, ishte 636.1 miliardë euro ose 5.1 për qind më shumë sesa një vit më parë. Kreditë për klientët u rritën me 12 për qind, duke arritur në 395.19 miliardë euro në fund të vitit 2008. Ndërsa depozitat e klientëve u rritën me 10 për qind, duke arritur në 430.9 miliardë euro. Raporti i kredive me probleme ndaj atyre totale ka qëndruar i pandryshuar në 1 për qind.

Bordi i Mbikëqyrjes miratoi vendimin e Bordit të Menaxhimit për emetimin e një borxhi prej 4 miliardë eurosh, i cili do të nënshkruhet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës dhe që është pjesë e paketës së ndihmës të ideuar nga Qeveria Italiane, me qëllim forcimin e kapitalit të bankave dhe zgjerimin e kredidhënies.

Operacionet bankare që kryhen në Itali sjellin 74 për qind të të ardhurave të grupit. Ekspozimi në Evropën Qendrore dhe Lindore është i kufizuar dhe i diversifikuar, ku kreditë për klientët përbëjnë vetëm 7 për qind të totalit të kredive të grupit dhe ka një ekuilibër të mirë mes kredive e depozitave të klientëve.

Në fund të vitit 2008, Intesa Sanpaolo Bank Albania përbënte rreth 0.1 për qind të totalit të aktiveve të grupit Intesa Sanpaolo.

3. PIRAEUS BANK (GREQI)

Fitimi neto i grupit Piraeus Bank, në fund të vitit 2008, arriti në 315 milionë euro (kundrejt një shifre prej 503 milionë eurosh të një viti më parë). Motivi kryesor i kësaj rënieje të konsiderueshme janë rezervat shtesë për humbjet nga kreditë (provigjonet) prej 215 milionë eurosh (të cilat iu shtuan 173 milionëve të planifikuar fillimisht). Në këtë mënyrë, në fund të vitit 2008 grupi regjistroi provigjone totale prej 388 milionë eurosh ose 272 milionë euro më shumë sesa një vit më parë. Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 26 për qind kundrejt fundit të vitit 2007, duke arritur në 1.16 miliardë euro. Ndërsa komisionet bankare neto u rritën me 30 për qind, duke kapur shifrën 200 milionë euro: këta dy zëra përbëjnë 82 për qind të të ardhurave totale neto. Marzhi neto nga interesat qëndroi në nivelin 3 për qind.

Raporti kredi/depozita u përmirësua, duke zbritur në 112 për qind (nga 121 për qind në fund të vitit 2007), pas dy operacioneve të shndërrimit të kredive në letra me vlerë (securitization) prej 2.5 miliardë eurosh dhe pas pjesëmarrjes në planin e mbështetjes të qeverisë, e cila injektoi në bankë 750 milionë euro.

Aktivet totale të grupit gjatë vitit të kaluar u rritën me 8.5 miliardë euro, duke arritur në 55 miliardë euro. Kreditë me probleme përbënin 1.9 për qind të totalit të kredive dhe kishin një raport mbulimi me provigjone prej 96 për qind. Treguesi i kthimit nga kapitali aksioner ishte 11 për qind (nga 24 për qind në vitin 2007), ndërsa kthimi nga aktivet ishte 0.7 për qind (nga 1.4 për qind një vit më parë).

Kredidhënia u rrit me 27 për qind në Greqi dhe me 42 për qind në filialet jashtë vendit. Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik ishte 8 për qind në fund të dhjetorit dhe do të rritet në 8.9 për qind pas injektimit të kapitalit, në kuadër të skemës së mbështetjes nga qeveria. Piraeus do të emetojë aksione preferenciale për shtetin, në këmbim të një rritjeje të kapitalit prej 370 milionë eurosh.

Në fund të vitit 2008, Tirana Bank, filiali shqiptar i zotëruar nga Piraeus, përbënte 1.20 për qind të totalit të aktiveve të grupit Piraeus.

4. BANKA ALFA - GREQI

Në fund të vitit 2008, Banka Alfa raportoi një fitim neto prej 512 milionë eurosh ose 33.5 për qind më pak sesa një vit më parë.

Gjatë vitit 2008, Banka Alfa e kreditoi ekonominë greke me 5.2 miliardë euro, ndërsa ekonomitë e vendeve të Evropës Juglindore me 3.6 miliardë euro. Me gjithë kushtet e vështirësuara, kreditë e reja në tremujorin e katërt të vitit arritën në 1.4 miliardë euro. Depozitat e reja gjatë vitit 2008 ishin 7.9 miliardë euro, duke e çuar totalin e depozitave në shifrën 42.5 miliardë euro. Totali i aktiveve arriti në 65.3 miliardë euro ose 19.4 për qind më shumë sesa një vit më parë.

Të ardhurat neto nga interesi u rritën me 12 për qind dhe arritën në 1.8 miliardë euro, duke përcaktuar një marzh të qëndrueshëm nga interesi prej 3 për qind (3.1 për qind në vitin 2007). Raporti shpenzime/të ardhura ishte në nivelin 50.2 për qind. Banka Alfa do të marrë pjesë në planin e qeverisë për mbështetjen e bankave, duke përdorur 4.6 miliardë euro në formë likuiditeti dhe 940 milionë euro në trajtë aksionesh preferenciale. Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik ishte 8.3 për qind.

Në fund të vitit 2008, dega e bankës Alfa në Shqipëri (degë), përbënte 0.9 për qind të totalit të aktiveve të grupit Alpha dhe 8.5 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar shqiptar.

5. SOCIETE GENERALE (FRANCË)

Grupi Societe Generale raportoi një fitim neto prej rreth 2 miliardë eurosh për vitin 2008, që përbën mbi dyfishin e fitimit neto të një viti më parë. Të ardhurat e përgjithshme nga aktiviteti bankar pësuan një rënie me 3.9 për qind në vitin 2008 kundrejt vitit 2007, duke qenë rreth 21.9 miliardë euro. Rritja e shpenzimeve operative (+6.2 për qind kundrejt vitit 2007) pasqyron investimet e vazhdueshme që lidhen me rritjen organike të grupit në biznese e rajone me potencial zhvillimi si dhe përmirësimet në infrastrukturën e kontrollit të rrezikut. Si rezultat, raporti shpenzime/të ardhura i grupit ishte 71.0 për qind në vitin 2008.

Në fund të vitit 2008, rrjeti ndërkombëtar i Societe Generale kishte një raport kredi/depozita prej 102 për qind. Gjatë vitit 2008, depozitat e kësaj pjese të grupit u rritën me 6.6 për qind, kurse kreditë me 25.7 për qind. Fitimi neto i rrjetit ndërkombëtar për vitin 2008 ishte 608 milionë euro.

Kthimi nga kapitali aksioner për vitin 2008 ishte 6.4 për qind, në rritje me 2.8 pikë përqindje kundrejt vitit paraardhës.

Totali i aktiveve në fund të vitit 2008 ishte 1,130 miliardë euro ose 5.4 për qind në rritje kundrejt fundit të vitit të kaluar.

Në fund të vitit 2008, Banka Popullore përbënte 0.03 për qind të totalit të aktiveve të grupit Societe Generale.

6. BANKA KOMBËTARE E GREQISË - GREQI

Banka Kombëtare e Greqisë - Greqi raportoi një fitim neto prej 1.5 miliardë eurosh për vitin 2008, në rënie me 5 për qind kundrejt vitit të kaluar. Provigjonet e larta dhe ngadalësimi në rritjen e kredidhënies ndikuan negativisht mbi fitimin e bankës.

Treguesi i kthimit nga kapitali aksioner ishte në nivelin 26.2 për qind, në rritje me 0.1 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007. Raporti shpenzime/të ardhura reflektoi rritje të eficiencës, duke rënë me 4.4 pikë përqindje, në nivelin 46.6 për qind. Të ardhurat neto nga degët në Evropën Juglindore u rritën me 28 për qind, në nivelin 202 milionë euro, duke kontribuar me 13 për qind në fitimin e përgjithshëm të Grupit.

Raporti i kredive me probleme ishte 3.3 për qind ose 0.1 pikë për qind më i ulët se në fundin e një viti më parë. Si rezultat i një mjedisi të vështirësuar për shkak të krizës financiare ndërkombëtare, grupi i rriti provigjonet me 57 për qind (që arritën kështu në 520 milionë euro për gjithë vitin 2008, nga të cilat 228 milionë euro i takonin vetëm tremujorit të katërt).

Kredidhënia totale e grupit për vitin 2008, arriti shifrën 66.1 miliardë euro (kundrejt 56.3 miliardë eurosh për vitin 2007) me një rritje vjetore 18 për qind, duke konfirmuar kontributin e grupit për rritjen ekonomike të Greqisë e të vendeve të rajonit, ku ai është i pranishëm.

Në fund të vitit 2008, BKG kishte një total aktivesh prej 101 miliardë eurosh (+12 për qind). Kreditë përbënin 95 për qind të depozitave (+5 pikë përqindje).

Kapitali bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik ishte 10.4 për qind (+1.2 pikë përqindje).

Në fund të vitit 2008, dega e BKG në Shqipëri përbënte 0.44 për qind të totalit të aktiveve të grupit të BKG.

7. CREDIT AGRICOLE (FRANCË)

Grupi Credit Agricole raportoi një fitim neto për vitin 2008 prej 1 miliard eurosh, ndërkohë që tremujori i katërt i vitit shënoi një humbje prej 309 milionë eurosh. Të ardhurat neto nga aktiviteti bankar ishin rreth 16 miliardë euro, në rënie me 4.8 për qind kundrejt një viti më parë. Shpenzimet operative zbritën me 0.7 për qind, duke arritur në 12.6 miliardë euro. Shpenzimet e lidhura me rrezikun patën një rritje të konsiderueshme prej 66.8 për qind dhe arritën në 3.2 miliardë euro. Rritja reflekton përkeqësimin e kushteve financiare ndërkombëtare. Këto shpenzime ishin veçanërisht të larta në rrjetin ndërkombëtar të degëve (880 milionë euro), sidomos tek Emporiki, e cila i rriti në mënyrë të ndjeshme provigjonet.

Në fund të vitit 2008, raporti i kapitalit bazë me aktivet e ponderuara me rrezik ishte 9.1 për qind, ndërsa kapitali i grupit 83 miliardë euro. Aktivet e ponderuara me rrezik ishin 338.5 miliardë euro, një rënie me 6.6 miliardë euro krahasuar me një vit më parë, në sajë të adoptimit të Bazel II.

Kreditë me probleme përbënin 3.1 për qind të totalit, nga të cilat 69.7 për qind ishin të mbuluara me provigjone.

Në fund të vitit 2008, Banka Emporiki në Shqipëri përbënte 0.01 për qind të totalit të aktiveve të grupit Credit Agricole.

8. BANKA EMPORIKI - GREQI

Banka Emporiki është pjesë e grupit bankar francez Credit Agricole. Vetë Banka Emporiki raportoi një humbje neto prej 491.8 milionë eurosh për vitin 2008, kundrejt një fitimi prej 73.4 milionë eurosh të vitit 2007.

Gjatë vitit 2008, Banka Emporiki ruajti një nivel të lartë të aktivitetit, në kontekstin e një ngadalësimi progresiv të ekonomisë: portofoli i kredisë u rrit në të gjitha segmentet, mesatarisht me 21 për qind, duke arritur në 24 miliardë euro në 31 dhjetor 2008. Depozitat e bankës u rritën me 1.2 për qind kundrejt vitit 2007, duke arritur në rreth 17.8 miliardë euro.

Të ardhurat e përgjithshme nga aktiviteti bankar (757 milionë euro, në rënie me 20 për qind kundrejt vitit 2007) u ndikuan negativisht nga marzhet e zvogëluara në tregun grek dhe nga rritja e kostos së likuiditetit, si pasojë e krizës financiare botërore. Nga mesi i vitit 2008, u futën politika të reja të çmimit të kredive, duke lejuar rritjen e spread-eve për t'iu përshtatur më mirë kushteve të tanishme të tregut.

Të ardhurat neto nga interesi ishin 648.7 milionë euro, në rënie me 13.6 për qind, për shkak të konkurrencës së intensifikuar te kreditë e depozitat, si dhe rritjes së kostove të financimit. Shpenzimet e përgjithshme, duke përjashtuar provigjonet, u rritën me 0.9 për qind, duke arritur në 666.3 milionë euro, si rezultat i një politike mjaft të shtrënguar për kontrollin e shpenzimeve. Provigjonet e kredive arritën në 474 milionë euro.

Rezultatet e vitit 2008 u ndikuan në mënyrë të konsiderueshme nga përkeqësimi i mjedisit të përgjithshëm. Duke supozuar mungesë të një përkeqësimi të mëtejshëm në kushtet e tregut, banka pret një përmirësim të qëndrueshëm në zhvillimet e ardhshme, bazuar mbi pozicionet ekzistuese.

Në fund të vitit 2008, Banka Emporiki në Shqipëri përbënte 0.7 për qind të totalit të aktiveve të Emporiki Bank.

3 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2008

Viti 2008 ishte pozitiv për rritjen ekonomike të vendit, e cila vlerësohet të ketë kaluar nivelin vjetor prej 6 për qind. Rritja ekonomike u mbështet nga një stimul fiskal dhe monetar i konsiderueshëm, në kuadër të shpenzimeve të buxhetit si edhe të kreditimit të sektorit bankar. Megjithatë, efektet e krizës financiare ndërkombëtare u shfaqën në tremujorin e fundit të vitit, siç u tregua nga zhvillimet në bilancin e pagesave, ngadalësimi i rritjes së kreditimit si edhe rënia e optimizmit në pritjet e bizneseve dhe të individëve për zhvillimet në afat të shkurtër.

Ecuria e pafavorshme e disa treguesve në fund të vitit 2008, do të thellohet në vitin 2009. Për këtë arsye, gjatë vitit 2009 ekonomia shqiptare do të ndjejë pasojat e krizës ndërkombëtare, kryesisht në formën e ngadalësimit të ndjeshëm të rritjes ekonomike dhe rënies së të ardhurave. Për shkak të rënies së ndjeshme të rritjes ekonomike, situata fiskale do të përballet me realizim më të ulët të të ardhurave, duke sjellë vështirësi në financimin e shpenzimeve të planifikuara. Në këto kushte, është e nevojshme të rishikohet niveli i shpenzimeve publike, për t'i përshtatur ato në varësi të realizimit të të ardhurave. Në këtë mënyrë do të krijoheshin kushte më të mira për të ruajtur nivelin e pritshëm të deficitit buxhetor, në vlerën 4.2 për qind të PBB-së. Ruajtja e këtij niveli të deficitit buxhetor, merr rëndësi të veçantë në kushtet kur veprimtaria e ndërmjetësimit të sektorit bankar dhe sistemit financiar në tërësi, për sektorin publik dhe veçanërisht për sektorin privat, do të vazhdojë të jetë në vëllime më të ulëta dhe kosto më të lartë, për shkak të paqëndrueshmërisë së faktorëve që lidhen me kërkesën dhe ofertën. Gjithashtu, tregjet e huaja do të vazhdojnë të karakterizohen nga hezitimi i investitorëve për të financuar borxhin e vendeve në zhvillim, gjë që nënkupton ruajtjen e një kërkese më të lartë të kthimit nga investimi për të kompensuar nivelin më të lartë të rrezikut. Në këto kushte, përfitimin më të madh do ta kenë ato vende që tregojnë vullnetin për të ruajtur disiplinën fiskale dhe monetare. Në vendin tonë, edhe sektori i sipërmarrjeve të biznesit dhe individët, do të përjetojnë rritje të vështirësive për financim. Kjo do të nxisë një proces ristrukturimi, i cili do të jetë i mundimshëm dhe do të ndikojë negativisht në ecurinë e punësimit. Këto pritshmëri reflektohen dhe në pritjet e bizneseve për zhvillimet e ardhshme në ecurinë e ekonomisë dhe në kërkesën e brendshme.

Në lidhje me zhvillimet në bilancin tregtar, gjatë vitit 2008 dhe në fillim të këtij viti, është konstatuar një thellim i deficitit të llogarisë korente, në kushtet e rënies më të madhe të eksporteve në krahasim me importet dhe rënies së dërgesave të emigrantëve. Ndryshimi i ekuilibrit të flukseve në valutë, krijoi kushte për rritjen e presionit mbi nivelin e kursit të këmbimit të monedhës kombëtare në tremujorin e fundit të vitit 2008, gjë e cila u shfaq veçanërisht në tremujorin e parë të vitit 2009. Zhvlerësimi i kursit të këmbimit të lekut, u kujtoi agjentëve ekonomikë faktin që ecuria e kursit të këmbimit të lekut përcaktohet lirisht në treg, dhe që kjo përbën një burim rreziku që duhet të kuptohet dhe të administrohet në mënyrë efektive. Për këtë arsye, veprimet e tyre financiare dhe të bilancit, duhet të synojnë krijimin e instrumenteve mbrojtëse nga mundësia e ecurisë së pafavorshme të kursit të këmbimit,

pavarësisht kahut të lëvizjes. Ecuria e kursit të këmbimit, ka rritur burimet e rrezikut mbi ecurinë e pritshme të nivelit të çmimeve, por megjithatë presioni inflacionist në fund të vitit 2008 dhe në fillim të vitit 2009 ka qenë i ulët. Për këtë arsye, pas një rritjeje të normës bazë të interesit në mes të vitit 2008, Banka e Shqipërisë e ka ulur atë në muajin janar 2009, në nivelin 5.75 për qind. Normat e interesit të tregut ndërbankar, kanë reflektuar vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë, si edhe kushtet e likuiditetit. Banka e Shqipërisë, që prej tremujorit të fundit të vitit 2008, ka vijuar të injektojë likuiditet në tregun ndërbankar, kryesisht nëpërmjet operacioneve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor dhe tremujor.

Tabelë 3. Tregues kryesorë makroekonomikë.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Rritja reale e PBB-së (në %)[21]	7.9	4.2	5.8	5.7	5.7	5.5	6.0	6.0*
PBB (me çmime korente, në milionë lekë[22])	583,369	622,711	694,098	750,785	814,797	891,000	980,060	1,064,000*
PBB (me çmime korente, në milionë usd)[23]	4,065.3	4,444.8	5,694.0	7,303.4	8,164.3	9,082.6	10,841.4	12,681.8*
PBB (në usd për frymë)	1,323	1,437	1,831	2,336	2,597	2,882	3,387.9	3,963.1*
Numri i të punësuarve (në mijë)[24]	1065	921	928	917	932	934	935	970
Përqindja e papunësisë	14.6	15.8	15.0	14.6	14.2	13.8	13.4	12.6
Përqindja e inflacionit (v/v)	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	2.9	3.4
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-7.9	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1	-3.5	-5.7
Borxhi publik (në % të PBB-së)	66.8	65.3	61.7	56.6	56.7	55.9	52.2	55.9
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së)[25]	25.8	23.5	20.6	18	17.5	17.2	14.4	18.3
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-6.1	-10.0	-7.9	-5.6	-7.7	-7.2	-11.2	-15.2
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	143.5	140.1	121.9	102.8	99.8	98.1	90.4	83.9
Kursi mesatar i këmbimit, lek/euro	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6	122.8

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe vlerësime të Ministrisë së Financave dhe FMN-së.

3.1 ECURIA E EKONOMISË DHE E BIZNESEVE

Gjatë vitit 2008 u mundësua një rritje e qëndrueshme e pasurisë së ekonomisë, si pasojë e një rritjeje të lartë në sektorët e ndërtimit, industrisë dhe shërbimeve. Indeksi i shifrës së afarizmit për prodhimin dhe shërbimet, i cili jepet në tabelën 4, në fund të tremujorit të katërt të vitit arriti në 147.0 për qind, me një normë vjetore rritjeje prej 22 për qind ndaj të njëjtës periudhë të vitit 2007. Kontributin kryesor e dhanë sektori i prodhimit të energjisë, i shërbimeve dhe i ndërtimit, ku indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit në tremujorin e katërt të vitit 2008 u rrit përkatësisht me 29, 26 dhe 21 për qind, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2007. Ecuria e aktivitetit për çdo sektor, megjithatë ka pësuar ndryshime gjatë vitit. Sektori i ndërtimit ka regjistruar rritjen më të lartë në terma vjetorë gjatë tremujorit të tretë me 51 për qind. Investimet në projekte të infrastrukturës rrugore dhe rritja e ritmit të dhënies së lejeve të ndërtimit, gjykohet të kenë nxitur rritjen e aktivitetit të ndërtimit. Vëllimi i ndërtimit gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008 ka regjistruar një rritje mesatare vjetore prej rreth 87 për qind, duke shënuar normën më të lartë vjetore në tremujorin e dytë të vitit. Për sektorin e industrisë nxjerrëse, ndryshimi vjetor i indeksit të vëllimit në tremujorin e katërt ka rënë me 17 për qind, duke mbartur pasojat e zhvillimeve të pafavorshme në tregjet e lëndëve të para.

Mesatarisht shifra e afarizmit në vëllim për degët "industri", "transport dhe komunikacion" dhe "hoteleri" paraqet një ngadalësim të ritmit të rritjes në krahasim me një vit më parë. Gjithashtu, vihet re një prirje pozitive e qëndrueshme e sektorit të tregtisë.

Tabelë 4. Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit.

Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit	T IV-06	T I-07	T II-07	T III-07	T IV-07	T I-08	T II-08	T III-08	T IV-08
Prodhim dhe shërbime	112.6	94.7	105.6	112.9	120.7	111.6	118.9	136.2	147.0
Prodhimi*	118.5	92.1	113.2	108.1	134.7	114.1	137.0	146.0	160.8
Industria	106.5	108.7	126.2	112.6	112.7	112.5	130.2	133.3	131.7
Industria nxjerrëse	99.7	116.2	172.5	144.5	125.3	116.5	177.3	147.3	109.5
Industria përpunuese	112.7	108.3	127	117.4	117.7	110.3	132.0	138.9	137.2
Energji elektrike, Gaz, Ujë	89.2	105.5	107.2	87.2	92.5	115.1	109.0	110.7	119.1
Ndërtimi	135.8	69	95.2	101.7	164.9	115.8	146.0	162.8	199.7
Shërbime	109.3	96.3	101.2	115.6	112.7	110.1	109.1	130.8	139.4
Tregti	108.6	94.6	100.8	115.5	112.7	109.9	108.5	129.2	141.5
Transport, Komunikacion	112.5	103.7	102.1	115.5	112.7	111.0	110.7	138.8	129.0
Hotele	131.2	78.7	117.2	141.6	129.7	103.1	114.1	142.9	108.6

**Prodhimi përfshin sektorët e industrisë dhe ndërtimit.*
Burimi: INSTAT.

Aktiviteti ekonomik i matur nëpërmjet treguesit të tendencës ekonomike (TTE[26]) i cili realizohet nga vrojtimi i sektorëve të ndryshëm të biznesit dhe të individëve, mbështet analizën e mësipërme. Gjatë vitit 2008 TTE (grafik 16) tregon për një rritje gjatë tremujorit të dytë dhe atij të tretë ndërsa në tremujorin e fundit të vitit shënon një rënie prej 10 pikësh përqindje, duke mbetur megjithatë mbi nivelin mesatar të 5 viteve të fundit. Vlera e këtij treguesi pasqyron vlerësimin në rënie të bizneseve të sektorit të industrisë dhe të shërbimeve për nivelin e prodhimit, punësimit, kërkesës dhe situatës së tyre financiare, si dhe vlerësimin në rënie të kërkesës konsumatore, ndërkohë që bizneset e ndërtimit në të njëjtën periudhë tregojnë për një përmirësim të aktivitetit të tyre.

Grafik 16. Treguesi i tendencës ekonomike.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikët 17-20 janë paraqitur treguesit e besimit të bizneseve që operojnë në sektorët e industrisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit, si edhe treguesi i besimit të konsumatorit. Krahas gjendjes aktuale, këta tregues përfshijnë edhe vlerësime mbi gjendjen e ardhshme të kërkesës, të prodhimit, të punësimit, të situatës financiare etj.. Me përjashtim të sektorit të ndërtimit, i cili në tremujorin e katërt të vitit 2008, shfaq një ecuri të përmirësuar, të gjithë treguesit e tjerë janë përkeqësuar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 dhe veçanërisht, në tremujorin e fundit të tij.

Me rëndësi në vlerësimin e ndikimit të ecurisë së bizneseve mbi stabilitetin financiar është vlerësimi i gjendjes financiare të firmave, e cila është drejtpërsëdrejti e lidhur me aftësinë e tyre për të shlyer borxhin. Gjithashtu, i rëndësishëm është edhe treguesi i kërkesës së pritshme për tremujorin e parë

të vitit 2009, i cili jep informacion mbi potencialin e rritjes së veprimtarisë së këtyre sektorëve dhe aftësinë e tyre për të kapërcyer një situatë relativisht më të vështirë. Ecuria e treguesit të gjendjes financiare për secilin nga sektorët si dhe situata financiare për individët, jepet në grafikët 21 - 24.

Grafik 17. Treguesi i besimit të industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Treguesi i besimit të ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 19. Treguesi i besimit të shërbimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Treguesi i besimit të konsumatorit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjendja financiare e firmave në sektorët e industrisë dhe shërbimeve ka një rënie të konsiderueshme sidomos gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, duke nënkuptuar se rreziku i kredisë në lidhje me këta sektorë mund të jetë rritur. Po ashtu, vrojtimi në sektorin e ndërtimit tregon se gjendja financiare e firmave të ndërtimit është përkeqësuar gjatë gjashtëmujorit të dytë, ndonëse ajo mbetet mbi mesataren e tre viteve të fundit. Situata financiare e individëve, e shprehur nga treguesi i situatës financiare aktuale dhe të pritshme, gjithashtu dëshmon për një rënie të kursimeve dhe një rrezik më të madh të përkeqësimit të cilësisë së kredisë për individët.

Në veçanti, sektorët e industrisë (grafik 21) dhe të shërbimeve (grafik 23), paraqesin pritshmëri negative për tremujorin e parë të vitit 2009, ndërkohë që gjendja në sektorin e ndërtimit (grafik 22) paraqitet më optimiste. Gjithashtu, dhe blerjet totale nga individët pritet të jenë më të ulta gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 siç tregohet në grafikun 24.

Në grafikët 25-28, jepet pirja e kërkesës aktuale dhe të pritshme për sektorët e industrisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit. Për konsumatorët, treguesi jep pirjet e tyre për blerjet e ardhshme. Secili prej treguesve, paraqet një ecuri në rënie. Një ecuri e tillë e pritjeve reflekton faktin që të anketuarit janë kushtëzuar nga situata aktuale. Në të njëjtën kohë, pritjet për një ecuri jo të mirë të kërkesës dhe të blerjeve, paraprijnë frenimin e prodhimit dhe shpenzimeve, duke ndikuar negativisht në zhvillimin e ekonomisë.

Të gjithë treguesit, shfaqin një përkeqësim të përgjithshëm të situatës financiare të sipërmarrjeve të biznesit dhe të familjeve, i cili pritet të vazhdojë të paktën në afat të shkurtër. Ky përkeqësim, reflekton rënie të kërkesës për mallra, rënie të investimeve për shkak të mundësive më të vogla për financim, si edhe nxit nevojën për një përshtatje të modelit të kursim-shpenzimit në drejtim të rritjes së kursimeve. Nëse ky proces do të jetë i fortë, ekziston rreziku që ai të nxisë një spirale vetëforcuese, ku rrezikohet hyrja në një cikël të vazhdueshëm të rënies së investimeve dhe rënies së kërkesës për mallra, me pasoja negative në situatën financiare të sipërmarrjeve dhe në nivelin e punësimit. Rënia e nivelit të punësimit, ndikon negativisht në të ardhurat e disponueshme dhe në shpenzimet konsumatore, duke thelluar rënien e kërkesës së përgjithshme. Në përgjithësi, ndikimi i këtyre faktorëve në rritjen ekonomike do të jetë negativ. Për të zbutur këtë proces, është e rëndësishme të shfrytëzohen hapësirat private dhe publike, për të mbështetur flukset e financimit për sipërmarrjet e biznesit.

Grafik 21. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Treguesi i gjendjes financiare të sektorit të shërbimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Treguesi i situatës financiare aktuale dhe të pritshme të konsumatorit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – ndërtimi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 27. Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme – shërbimet.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 28. Treguesit e blerjeve aktuale dhe të pritshme – konsumatorët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 PUNËZËNIA DHE MIRËQENIA E EKONOMIVE FAMILJARE

Për shkak të vështirësive të sipërmarrjeve të biznesit, zhvillimet e ekonomisë reale gjatë vitit 2009 do të kufizojnë rritjen e të ardhurave të familjeve, nëpërmjet uljes së treguesve të punësimit në sektorin privat. Treguesi i besimit të konsumatorit për tremujorin e fundit të vitit 2008, shfaqi rënie nën mesataren e tij historike. Pritjet e konsumatorëve për vitin 2009, tregojnë kushte më të vështira të punëzënies, duke qenë konsistente me pritjet e bizneseve.

Gjatë vitit 2008 punëzënia është rritur duke shënuar 12.7 për qind, në fund të tremujorit të katërt të vitit. Megjithë rritjen natyrale të forcave të punës në vend, sektori bujqësor e ka kompensuar këtë rritje me punësimin e 27 mijë personave shtesë, duke qenë sektori me kontributin kryesor në rritjen e punëzënies gjatë vitit. Në vlerësimin e këtij treguesi, duhet marrë në konsideratë edhe përmirësimi i mënyrës së llogaritjes së tij. Gjatë vitit, sektori privat jobujqësor ka kontribuar në punësimin e 8 mijë personave.

Tabelë 5. Tregu i punës sipas tremujorëve.

Tregu i punës (në mijë)	T IV-06	T I-07	T II-07	T III-07	T IV-07	T I-08	T II-08	T III-08	T IV-08
Forcat e punës	1,085	1,080	1,078	1,078	1,082	1,080	1,079	1,110	1,116
-Të punësuar	935	933	933	936	939	939	939	970	974
a) në sektorin shtetëror	169	168	167	167	167	167	167	167	167
b)në sektorin privat jobujqësor	224	223	224	227	230	231	231	235	239
c)në sektorin privat bujqësor	542	542	542	542	542	542	542	569	569
-Të papunë	149	148	145	142	143	141	140	140	141
Shkalla e papunësisë së regjistruar	13.9	13.6	13.5	13.18	13.2	13.04	12.97	12.62	12.68

Burimi: INSTAT.

Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2008, ritmi i rritjes vjetore të pagave, si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat është ngadalësuar. Në terma nominalë, niveli i pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror[27] u rrit mesatarisht me 7.5 për qind, ndërsa paga mesatare e regjistruar në biznese gjatë nëntë muajve të parë të vitit vlerësohet të jetë rritur në terma nominalë vjetorë me rreth 15.1 për qind[28]. Në terma realë, rritja vjetore e pagës

Grafik 29. Paga mesatare në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve.



Burimi. INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë, korrik-shtator 2008 dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 30. Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror.



Burimi. INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë, korrik-shtator 2008 dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

mesatare të ndërmarrjeve ekonomike për këtë periudhë vlerësohet në rreth 11.0 për qind.

Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, paga mesatare vjetore nominale, për sektorin e prodhimit, është rritur mesatarisht me 19.8 për qind në degën e ndërtimit dhe me 11.8 për qind në degën e industrisë. Në sektorin e shërbimeve, rritja vjetore e pagës mesatare ka rezultuar e lartë për tregtinë me pakicë dhe atë me shumicë, me përkatësisht 25.5 për qind dhe 12.9 për qind.

Analiza e ecurisë së të ardhurave, duhet mbështetur edhe me të dhënat mbi punësimin, për të kuptuar më mirë dinamikën e ecurisë së të ardhurave përgjatë kohës. Për këtë qëllim janë analizuar rezultatet e vrojtimeve të bizneseve dhe të individëve lidhur me punëzënien (grafikët 31-34). Rezultatet e vrojtimit për individët, tregojnë se niveli i papunësisë për tremujorin e fundit të vitit 2008 është rritur ndjeshëm. Këtë gjë e konfirmon edhe rezultati i vrojtimit për të njëjtën periudhë të sektorëve të industrisë dhe të shërbimeve, të cilët kanë ulur punëzënien. Përjashtim bën sektori i ndërtimit, i cili shfaq një rritje të punëzënies në tremujorin e katërt të vitit 2008. Pritjet e sektorëve të shërbimeve dhe të ndërtimit për punëzënien në vitin 2009 mbeten megjithatë optimiste, duke reflektuar ndikimin e sjelljeve sezonale dhe investimet e qëndrueshme publike në infrastrukturën rrugore. Nga ana tjetër, sektori i industrisë pret ulje të kapaciteteve të tij të punësimit, ndonëse në mënyrë më të zbutur në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2008.

Grafik 31. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga analiza e mësipërme rezulton se me forcimin e mundshëm të efekteve të krizës ndërkombëtare në ekonominë e vendit aftësia e sektorit të ekonomive familjare për të gjeneruar të ardhura nëpërmjet punëzënies mund të bjerë. Me rënien e nivelit të të ardhurave, rreziku që i kanoset sistemit financiar nëpërmjet cilësisë së kredidhënies për këtë sektor do të rritet. Një tjetër kanal përcjellës do të ishte rënia korresponduese në kursime, e cila do të vështirësonte gjenerimin e burimeve të sistemit bankar në formën e depozitave. Për më tepër, duke qenë se një gjë e tillë rrit pasigurinë e familjeve, në të ardhmen pritet një korrektim i konsumit dhe për pasojë, vështirësi të mëtejshme në shitjet për bizneset. Pas një periudhe kohe relativisht të gjatë të rritjes së shpejtë të kërkesës, një korrektim i tillë mund të sjellë përparësinë e pakësimit të kërkesës për importe dhe korrektimin e deficitit tregtar, duke lehtësuar kështu presionin mbi kursin e këmbimit. Nga ana tjetër, një rënie drastike në deficitin tregtar

Grafik 32. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – ndërtimi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 33. Treguesit e punësimit aktual dhe të pritshëm – shërbimet.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Papunësia.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 35. Remitancat dhe norma e papunësisë në disa vende të botës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

do të vinte në dyshim qëndrueshmërinë e tij, duke rritur më tej pasigurinë për të ardhmen.

Një tjetër burim i rëndësishëm i të ardhurave të individëve dhe familjeve, janë dërgesat e emigrantëve, të cilat në vitin 2007 u vlerësuan në masën 12-13 për qind të PBB-së. Si rezultat i efekteve të krizës në vendet e zhvilluara të Evropës gjatë vitit 2008, fluksi i këtyre dërgesave është pakësuar në mënyrë të ndjeshme (grafik 35). Nga grafiku, vërehet një përputhje në kohë midis rritjes së normës së papunësisë në vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në Greqi dhe në Italì, dhe rënies së dërgesave nga emigrantët. Duke qenë se ky fenomen varet nga zhvillimet e jashtme, gjatë vitit 2009 vëllimi i dërgesave pritet të jetë i paqëndrueshëm përsa kohë treguesit e punësimit dhe të të ardhurave në vendet e zhvilluara të jenë në rënie. Nga ana tjetër, në vijim të pasojave të krizës financiare dhe ndryshimit gradual të modelit të biznesit, bankat evropiane do t'i kushtojnë rëndësi më të madhe mbledhjes së depozitave nga individët dhe familjet, si një burim më i qëndrueshëm financimi në krahasim me huamarrjet në tregjet e parasë. Për këtë arsye, stimujt e emigrantëve për të rritur sasinë e kursimeve të tyre në bankat e vendeve ku punojnë do të jenë më të mëdha, duke sjellë eventualisht pakësimin e vlerës së kursimeve të tyre që mund të dërgohet jashtë vendit. Në këtë mënyrë, mund të gjendemi përballë një ndryshimi strukturor të modelit që përcakton tiparet e dërgesave të emigrantëve që lidhen me vëllimin dhe kohën. Ky rrezik, duhet të bëhet pjesë e skenarëve të agjentëve ekonomikë publikë dhe privatë, për të vlerësuar efektet e mundshme në bilancet e tyre financiare dhe vendimet e ardhshme. Më konkretisht, paqëndrueshmëria e dërgesave të emigrantëve do të ndikojë negativisht në vlerën e të ardhurave të disponueshme të familjeve shqiptare, duke goditur konsumin dhe kursimin. Në mënyrë më të drejtpërdrejtë, flukset në valutë të agjentëve ekonomikë do të bëhen më të rralla, duke sjellë një pakësim relativ të ofertës së valutës në tregun e brendshëm. Në këtë rast, ruajtja e niveleve të qëndrueshme të kursit të këmbimit, do të kërkonte një rënie të kërkesës për valutë, kryesisht në formën e pakësimit të importeve. Nga ana tjetër, rënia e kursimeve në valutë për familjet që kanë kredi në valutë, mund të sjellë vështirësi në aftësinë e tyre për të shlyer kredinë. I njëjti fenomen (rënia e kursimeve

në valutë) mund të përforcojë prirjen e sektorit bankar për të rritur kreditimin në monedhën kombëtare.

3.3 ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË

Gjatë vitit 2008, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë u karakterizuan nga thellimi i deficitit tregtar, nga rënia e transfertave korente, nga rritja e detyrimeve financiare ndaj jorezidentëve dhe nga rritja e rezervës valutore të vendit. Në përgjithësi, mund të thuhet që gjatë vitit 2008, ndjeshmëria e stabilitetit financiar të vendit ndaj zhvillimeve të sektorit të jashtëm është rritur.

Në fund të vitit 2008, deficiti i llogarisë korente arriti në 14.9 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), nga 10.4 për qind në fund të vitit 2007 duke u rritur me 55 për qind në krahasim me vlerën e tij në fund të vitit 2007. Deficiti i llogarisë korente është thelluar gjatë tremujorit të katërt të vitit, duke u ndikuar prej rënies së eksporteve dhe të dërgesave nga emigrantët. Rënia në transfertat korente neto vlerësohet rreth 213 milionë euro. Diferenca midis importeve dhe eksporteve, pra deficiti tregtar, në vitin 2008 arriti në 27.9 për qind të PBB-së, krahasuar me 26.6 për qind në vitin 2007. Faktori kryesor në përkeqësimin e tij ka qenë rritja e deficitit të tregtisë së mallrave me 301 milionë euro.

Grafik 36. Deficiti i llogarisë korente.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pakësimi i flukseve hyrëse të valutës së huaj, ka rritur presionin mbi kursin e këmbimit, në tremujorin e fundit të vitit 2008 dhe në tremujorin e parë të këtij viti, duke u shoqëruar edhe me uljen relative të sasisë së importeve. Vlerësohet që në muajin janar 2009, importet u pakësuan me 11.6 për qind kundrejt vlerës së tyre në dhjetor 2008, duke përfaqësuar uljen më të madhe mujore gjatë dy viteve të fundit. Brenda strukturës së importeve, rënia më e madhe është konstatuar në importet e mallrave kapitalë, si makineri dhe pajisje, me rreth 41 për qind, dhe në importet e mallrave industrialë. Nëse kjo ecuri bëhet e qëndrueshme për pjesën tjetër të vitit, ajo mund të rezultojë në një tkurrje të aktivitetit prodhues në vend, në vijim të rënies së kërkesës për eksporte dhe ngushtimit të tregjeve të shitjes, si edhe vështirësive në kushtet e financimit. Duket sikur sektori i biznesit pret të njëjtën gjë, pasi vrojtimi i bizneseve të sektorit të industrisë në tremujorin e katërt të vitit 2008, shënon rënie të eksporteve të pritshme, për herë të parë që prej vitit 2002 (grafik 37).

Grafik 37. Treguesi i eksportit aktual dhe të pritshëm – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Llogaria financiare gjatë vitit 2008 pësoi ndryshime të rëndësishme si në vëllim ashtu dhe në përbërje. Flukset neto në llogarinë financiare prej 1.48 miliardë euro gjatë vitit 2008, kanë qenë 1.9 herë më të larta se gjatë vitit 2007 duke financuar plotësisht deficitin e llogarisë korente dhe duke siguruar një rritje të mjeteve të rezervës për 192 milionë euro. Panorama e rreziqeve si rezultat i këtyre ndryshimeve gjithashtu ka ndryshuar.

- Së pari, rritja e investimeve të huaja direkte prej 682 milionë eurosh kryesisht në formën e investimeve në sektorin financiar dhe hyrjes së kapitalit për shkak të privatizimeve, vlerësohet të ketë kontribuar pozitivisht në rritjen e kapitalizimit të bankave dhe krijimin e një stimuli financiar shtesë në sektorin prodhues, për mbështetjen e ecurisë së tij në një mjedis ekonomik më të vështirë;
- Së dyti, rritja e huamarrjes publike dhe private prej 456 milionë eurosh, prej të cilave 74 për qind për sektorin publik, ka siguruar një burim financimi në sajë të të cilit është lehtësuar situata e likuiditetit të tregut të brendshëm. Megjithatë, për shkak të termave të huamarrjes, kostoja e shërbimit të borxhit për huanë publike do të jetë e konsiderueshme në afat të mesëm. Krahas pritjeve për të rifinancuar këtë borxh në terma më të leverdisshëm nëpërmjet huamarrjes në tregun ndërkombëtar, sektori publik duhet të identifikojë dhe të përgatisë mënyra alternative rezervë të rifinancimit ose të pagesës. Huamarrja private, kryesisht nga sektori financiar, është rritur ndjeshëm ndaj një viti më parë, në 119 milionë euro nga 10 milionë euro. Në kushtet e një shtrëngese të likuiditetit në valutë të huaj për bizneset financiare dhe jofinanciare, rreziku i përmendur më sipër mbetet i vlefshëm edhe në këtë rast. Por ky rrezik zbutet ndjeshëm prej faktit që këto huadhënie, në përgjithësi kryhen brenda të njëjtit grup biznesi;
- Si rezultat i rritjes së nevojës për likuiditet në valutë të huaj mjetet valutore të investuara jashtë ekonomisë shqiptare kanë regjistruar një rënie neto prej 94 milionë eurosh. Kjo rënie vihet re kryesisht në investimet e sistemit bankar në institucione financiare jorezidente (225 milionë euro). Rënia e investimeve në valutë të sektorit bankar në institucione financiare jorezidente, ka qenë e nevojshme për të përballuar rënien e depozitave të sektorit bankar, kryesisht në tremujorin e fundit të vitit 2008. Në sajë të pozicionit valutor të ekuilibruar të sektorit bankar dhe kuadrit të përshtatshëm rregullativ të Bankës së Shqipërisë, kërkesa e menjëhershme e bizneseve dhe individëve për valutë të huaj është përballuar pa dhënë pasoja mbi kursin e këmbimit. Tërheqja e depozitave në valutë prej publikut, ka ndryshuar formën e mbajtjes së tyre nga publiku dhe ka rritur mundësinë e përdorimit të tyre për konsum. Nga ana tjetër, për shkak të tërheqjeve të depozitave, sektorit të biznesit i është pakësuar mundësia për të përfituar financim të përqendruar nga sektori bankar në projekte të mundshme eficiente. Në këtë mënyrë, tërheqja e depozitave, ndonëse fillimisht ka lënë të pandryshuar tepricën e valutës në ekonomi, është shoqëruar me shkëputje të mekanizmit të qarkullimit të valutës dhe ulje të eficiencës së përdorimit të saj, duke dëmtuar kryesisht mundësitë investuese të sektorit të biznesit. Përqendrimi i valutës në duart e publikut si para

fizike, në kushtet e nevojave të qëndrueshme të sektorit të biznesit, shtrëngimit të termave të financimit nga ana e sektorit bankar dhe mundësisë për të përfituar një normë kthimi më të lartë për zotëruesit e valutës, mund të rrezikojë rigjallërimin e ndërmjetësimit financiar joformal, ku procesi i huamarrjes ndodh jashtë sistemit financiar. Shmangia e një dukurie të tillë kërkon vëmendjen e autoriteteve publike, që edhe nëpërmjet masave administrative të mos lejojnë zhvillimin e këtij fenomeni, me pasoja sociale dhe ekonomike.

Grafik 38. Llogaria financiare.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.4 ZHVILLIMET FISKALE GJATË VITIT 2008

Në fund të vitit 2008, të ardhurat në buxhet u realizuan në masën 97.3 për qind të vlerës së planifikuar, ndërsa shpenzimet u realizuan në masën 98.7 për qind të vlerës së planifikuar, duke përmbushur objektivat e buxhetit për vitin 2008. Në fund të vitit, ritmi i realizimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit, në krahasim me vlerat e realizuara një vit më parë, ishte përkatësisht rreth 15 për qind dhe rreth 23 për qind më i lartë. Ritmi i lartë i realizimit të shpenzimeve gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2008, ka ndikuar në krijimin e një balance buxhetore negative prej rreth 60 miliardë lekësh ose afërsisht 5.6 për qind e PBB-së. Politika fiskale e ndjekur në vitin 2008, është në përputhje me programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2008 - 2010.

Të ardhurat buxhetore kanë paraqitur një ecuri të mirë gjatë vitit 2008, duke u mbështetur në një realizim të suksesshëm të planit të të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), nga tatimi mbi fitimin si edhe nga të ardhurat jotatimore. Për sa i takon shpenzimeve, kontribuesit kryesorë në rritjen e tyre mbeten shpenzimet për paga dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore. Pavarësisht përmirësimit relativ, edhe gjatë vitit të kaluar u vu re një shpërndarje jo e njëtrajtshme në kohë e shpenzimeve dhe një përqendrim i tyre në muajt e fundit të vitit, veçanërisht në muajin dhjetor. Kjo situatë kontribuon jopozitivisht në ekuilibrat e vendosur në tregun financiar dhe posaçërisht në tregun ndërbankar, ku ecuria e huamarrjes dhe e shpenzimeve publike në kuadër të realizimit të treguesve të buxhetit nga ana e qeverisë, kanë një ndikim të konsiderueshëm. Një shpërndarje e tillë e shpenzimeve, ushtron presion mbi normat e interesit të likuiditetit në tregun ndërbankar si edhe mund të krijojë vështirësi në projektet e zhvillimit të sektorit të biznesit.

Rritja e deficitit buxhetor në vitin e kaluar në një masë më të madhe se në vitin 2007, është përkthyer në një rritje të nivelit të borxhit publik (të brendshëm dhe të jashtëm) rreth vlerës 56 për qind të PBB-së. Ndonëse kjo vlerë është përsëri nën nivelin maksimal të synuar nga marrëveshja e Maastrihtit prej 60 për qind e PBB-së, rreth saj duhet bërë një analizë e plotë, e cila duhet të

vlerësojë aftësinë e autoriteteve publike për të përballuar koston e borxhit si edhe prirjen e ecurisë së tij përgjatë kohës. Për këtë qëllim, duhen analizuar pritjet për rritjen ekonomike, struktura e borxhit dhe mënyra e financimit të tij me burime të brendshme dhe të huaja, niveli i pritshëm i realizimit të të ardhurave të qeverisë, situata e tregjeve të huaja dhe perceptimi i tyre për rrezikun e vendit, aftësia e autoriteteve publike për të gjeneruar burime të mjaftueshme në valutë etj.. Në këtë kuadër, të gjitha veprimet që synojnë zgjatjen e afatit të maturimit të borxhit, i shërbejnë administrimit më të mirë të tij. Në fakt, në zbatim të politikës përkatëse, Ministria e Financave ka vijuar me rritjen e kohëzgjatjes mesatare të borxhit publik gjatë vitit 2008. Kështu, në krahasim me një vit më parë, Ministria e Financave, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2008 pakësoi masën e borxhit në bono thesari me afat maturimi deri në 1 vit, me rreth 30 miliardë lekë, duke rritur me rreth 46 miliardë lekë stokun e borxhit në obligacione me maturime nga 2 deri në 5 vjet.

Tabelë 6. Ecuria e borxhit të brendshëm në vite.

Në milionë lekë	2005	2006	2007	2008
Stoku i borxhit të brendshëm	327,353	348,936	369,536	400,456
Bono thesari	275,917	261,242	232,211	224,224
Obligacione dyvjeçare	32,210	53,120	66,460	65,730
Obligacione trevjeçare	6,000	16,050	25,250	21,100
Obligacione pesëvjeçare	-	6,360	24,110	45,910
Obligacione shtatëvjeçare	-	-	6,000	12,000
Obligacione rivlerësimi të valutës me Bankën e Shqipërisë	11,500	12,164	15,505	23,540
Obligacione rikapitalizimi BKT	1,726	-	-	-
Kredi me bankën qendrore	-	-	-	3000
Sistemi bankar	-	-	-	-
Rikapitalizimi i bankave	-	-	-	-
Garanci tregut të brendshëm	-	-	-	4952
Borxhi i brendshëm në % ndaj PBB	40.18	39.16	37.59	37.64

Burimi: Ministria e Financave.

Zgjerimi i deficitit buxhetor dhe mënyra e financimit të tij gjatë vitit 2008, kanë ndikuar në orientimin e flukseve financiare në ekonomi. Në përgjithësi, nevojat më të mëdha për huamarrje të qeverisë, ndikojnë në kufizimin e ofertës së kredisë për sektorin privat. Për vitin 2008, kjo dukuri është zbutur për shkak të përdorimit në një masë më të madhe të burimeve të huaja për financimin e deficitit.

Tabelë 7. Kredia për ekonominë dhe qeverinë nga sektori bankar.

Në miliardë lekë.	Dhjetor 2006	Mars 2007	Qershor 2007	Shtator 2007	Dhjetor 2007	Mars 2008	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008
Mjetet e brendshme	497.8	519.2	539.7	568.4	618.9	638.6	683.7	712.8	725.7
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	241.0	240.7	239.7	242.5	256.8	255.7	265.5	265.7	258
Pretendimet ndaj korporatave jofinanciare publike	0.17	0.66	2.3	1.5	3.9	4.4	4.5	7.2	12.9
Pretendimet ndaj sektorit privat*	192.	214.2	233.8	255.1	285.4	307	338.6	365.2	378

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit të kaluar, burimet e huaja kanë financuar rreth 60 për qind të deficitit buxhetor, kundrejt 40 për qind të burimeve të brendshme. Në vitin

2007, financimi me burime të huaja ishte në masën 15 për qind, ndërsa financimi i brendshëm ishte në masën 85 për qind. Huamarrja e huaj gjatë vitit 2008, ishte rreth 6.7 herë më e lartë se në vitin 2007. Huamarrja e brendshme ishte në masën 85 për qind të nivelit të një viti më parë. Pakësimi i huamarrjes së brendshme gjatë vitit të kaluar, është ndikuar gjithashtu edhe prej rënies së kërkesës së sektorit bankar për instrumente të borxhit të qeverisë në tremujorin e fundit të vitit 2008, gjatë të cilit sektori bankar u përball me një tërheqje të depozitave dhe nevojën për një administrim më të mirë të likuiditetit.

Tabelë 8. Ecuria e financimit të deficitit buxhetor.

Në milionë lekë	T1 2007	T2 2007	T3 2007	T4 2007	Viti 2007	T1 2008	T2 2008	T3 2008	T4 2008	Viti 2008
Balanca buxhetore	6,401	3,749	-478	-43,791	-34,119	10,496	-12,826	-6,122	-51,736	-60,188
Financimi	-6,401	-3,749	478	43,791	34,119	-10,496	12,826	6,122	51,736	60,188
I brendshëm	-6,416	-4,029	1,175	40,449	28,829	-10,589	11,789	-11,456	34,783	24,527
I huaj	15	280	1,653	3,341	5,289	93	1,037	17,578	16,954	35,662

Burimi: Ministria e Financave.

Financimi me burime të huaja, në rastin e vendit tonë dhe në kushte normale të zhvillimeve të tregut ndërkombëtar, ofron mundësinë për vendosjen e një ekuilibri më të mirë në strukturën e borxhit dhe duhet të synojë përmirësimin e kostos së tij në afat të mesëm. Nëse përdoret me maturi, financimi me burime të huaja, lejon përfitimin e financimeve në vlera dhe në kohë më të përshtatshme, në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e fleksibilitetit të vendimmarrjes dhe në përmirësimin e efektivitetit të shpenzimeve. Gjithashtu, emetimi i instrumenteve të borxhit të qeverisë në valutë të huaj dhe blerja e tyre nga investitorë institucionalë jorezidentë, shoqërohen me elemente, të cilat nxisin disiplinën fiskale.

Grafik 39. Përbërësit e borxhit publik.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithatë, prirja e rritjes së financimit të huaj me terma jokoncensionarë, duhet të ndiqet me vëmendje për të vlerësuar rrezikun e rifinancimit në terma të pafavorshëm dhe në përgjithësi, aftësinë për të përballuar koston e borxhit. Për këtë, duhet të mbahen në konsideratë disa faktorë, si:

- nevojitet ruajtja në kohë e një qëndrueshmërie makroekonomike dhe e një disipline të fortë fiskale dhe monetare, në kushtet e një monitorimi më të afërt nga ana e tregjeve financiare. Nuk janë të rralla rastet nga praktika e vendeve të ndryshme, kur për shkak të dyshimit të tregjeve në lidhje me aftësinë e këtyre vendeve për të ruajtur disiplinën financiare, aftësia për të rifinancuar borxhin në terma më të volitshëm, është kufizuar ndjeshëm. Për këtë, nevojitet vullneti për të realizuar me kujdes dhe në mënyrë të qëndrueshme të ardhurat

dhe shpenzimet publike, si edhe për t'i rishikuar ato në rast nevoje, në mënyrë që përgjatë kohës të ndiqet një prirje rënëse e deficitit buxhetor dhe e borxhit të përgjithshëm publik. Përveç të tjerash, kjo do të përmirësonte mjedisin e përgjithshëm financiar, duke i lejuar sektorit bankar të realizojë në mënyrë më eficiente veprimtarinë e tij të ndërmjetësimit, duke mbetur i mirëkapitalizuar dhe likuid;

- nevojitet përcaktimi dhe zbatimi me disiplinë i kritereve të marrjes së borxhit të huaj, në atë mënyrë që të përballohet kostoja e rifinancimit ose e shlyerjes së tij në momentin e maturimit. Për këtë qëllim, krahas kujdesit që duhet të tregohet për termat e huamarrjes, duhet që vlera e saj të përcaktohet në raport me mundësitë reale që ka ekonomia për të gjeneruar fonde të qëndrueshme në valutë gjatë së njëjtës periudhë për shembull, prej ecurisë së eksporteve ose prej hyrjes së investimeve të huaja të drejtpërdrejta. Për këtë, merr rëndësi njohja e ekuilibrave të flukseve në valutë që lëvizin në ekonominë tonë, në mënyrë që të identifikohet mënyra e ndikimit të marrjes, të përdorimit dhe të shlyerjes së borxhit të huaj mbi ecurinë e llogarive të bilancit tregtar dhe mbi kursin e këmbimit. Në këtë kuadër, duhet kujtuar që kriza e fundit financiare ndërkombëtare tregoi sa e gabuar mund të jetë të mbështetesh plotësisht në një situatë të qëndrueshme të likuiditetit në tregjet ndërkombëtare, për rifinancimin më të favorshëm të borxhit. Që prej gjysmës së dytë të vitit 2008, vijon një rënie e dukshme e interesit të investitorëve të huaj për të blerë borxhin e vendeve në zhvillim. Kjo situatë nuk pritet të ndryshojë për sa kohë që edhe faktorët që e përcaktojnë atë do të zgjasin. Për këtë arsye, është e nevojshme që mundësia e rifinancimit të borxhit të huaj në terma më të favorshëm në një periudhë afatmesme, të konsiderohet me kujdesin e nevojshëm për të parashikuar mundësi alternative në rast se kjo provohet e vështirë në praktikë;

- efektiviteti i financimit të huaj, do të përcaktohet edhe nga përdorimi i tij në tregun e brendshëm. Në këtë kuadër, duhet gjetur një ekuilibër më i mirë midis shpenzimeve kapitale dhe atyre korente të buxhetit, duke synuar orientimin e tyre drejt projekteve që zgjerojnë kapacitetet prodhuese të ekonomisë, përmirësojnë produktivitetin e saj, aftësinë konkurruese dhe mundësitë e punësimit. Në këtë mënyrë, i shërbehet më mirë zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë në afat të mesëm dhe të gjatë, duke mundësuar rritjen reale të të ardhurave të agjentëve të ndryshëm ekonomikë, veçanërisht në sektorin privat. Në këtë kuadër, duhet patur parasysh që shpenzimet korente, për nga natyra e tyre priren të drejtohen për rritjen e konsumit, e cila në afat të shkurtër mund të mbështesë rritjen e importeve, rritjen e presionit mbi kursin e këmbimit dhe rritjen në përgjithësi të presioneve inflacioniste në ekonomi. Gjithashtu, këto shpenzime janë të ngurta dhe të pakthyeshme në kohë, duke u kthyer në një barrë për buxhetin fiskal, por duke nxitur edhe rritjen e kostove për sektorin privat.

Për pjesën e mbetur të vitit 2009, vlerësohet që rënia e ritmit të rritjes

ekonomike do të jetë më e dukshme. Kjo do të rrisë më tej vështirësitë në realizimin e objektivave për mbledhjen e të ardhurave publike. Fondet rezervë që janë planifikuar në buxhet dhe që janë ende të papërdorura, duhet të shërbejnë si mbështetës të fundit të realizimit të shpenzimeve publike, dhe posaçërisht të investimeve publike. Megjithatë, vlerësohet e rëndësishme që realizimi i shpenzimeve publike të përgjithshme, të kushtëzohet prej ecurisë së të ardhurave të realizuara, duke patur si synim kryesor objektivin për të ruajtur nivelin e deficitit buxhetor prej 4.2 për qind të PBB-së. Këtu duhet të mbahet në konsideratë edhe mundësia që financimi i deficitit me burime të brendshme, të jetë i kufizuar për shkak të ngushtimit të mundësive për financim nga sektori bankar. Për vitin 2010, me përfundimin e disa veprave të rëndësishme të infrastrukturës publike, ekzistojnë mundësi më të mëdha që me një planifikim konservator të objektivave për të ardhurat dhe veçanërisht për shpenzimet publike, të sigurohet një ulje e mëtejshme e deficitit buxhetor. Rivendosja e prirjes rënëse të deficitit buxhetor, është e rëndësishme për të ulur madhësinë dhe koston e financimit të tij, duke përmirësuar situatën e likuiditetit në tregun financiar dhe duke çliruar më shumë burime financiare që mund të përdoren drejtpërdrejt nga sipërmarrjet private të biznesit. Ulja e deficitit buxhetor, jep garanci më të mëdha për sigurimin e financimit nga investitorët dhe, në kuadër të shërbimit të borxhit të jashtëm, krijon mundësi më të mira për një rifinancim me kushte më të favorshme përgjatë kohës.

3.5 ZHVILLIMET NË INFLACION DHE NË POLITIKËN MONETARE

Gjatë vitit 2008, presionet inflacioniste të cilat ishin të forta në gjashtëmujorin e parë, u zbutën ndjeshëm në gjashtëmujorin e dytë. Ecuria e nivelit të çmimeve të konsumit u ndikua kryesisht nga rënia e çmimit të lëndëve të para të prodhimit dhe të energjisë në tregjet ndërkombëtare, si edhe nga një ngadalësim i veprimtarisë ekonomike në tremujorin e fundit të vitit. Rritja vjetore e indeksit të çmimeve të konsumit, arriti nivelin më të lartë në muajin korrik me 3.7 për qind, për të nisur më pas një prirje rënëse e cila shënoi nivelin 2.2 për qind në fund të vitit.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë e ruajti të pandryshuar nivelin e normës bazë të interesit prej 6.25 për qind, duke e gjykuar këtë nivel të përshtatshëm për të ruajtur stimujt e publikut për të besuar dhe për të investuar në monedhën kombëtare. Si gjithmonë, objektivi kryesor është të orientohen pritjet e agjentëve ekonomikë për rritjen vjetore të çmimeve të mallrave të konsumit, rreth nivelit 3 për qind.

Rënia e presioneve inflacioniste u thellua në fillim të vitit 2009, kur treguesit e ndryshëm dëshmonin një tkurrje të fortë të ekonomisë evropiane dhe rënien e ritmit të rritjes ekonomike në vend. Në këto kushte, duke patur parasysh edhe situatën e likuiditetit në tregun ndërbankar, në fund të muajit janar të këtij viti, Banka e Shqipërisë uli normën bazë të interesit me 0.5 pikë përqindje, në nivelin 5.75 për qind.

4 TREGJET

4.1 TREGU FINANCIAR

Në vendin tonë, tregu financiar mbizotërohet nga tregu ndërbankar, nga tregu i letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe nga tregu i këmbimeve valutore. Segmenti i këtij tregu që lidhet me veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, dhe të fondeve private të pensioneve, ndonëse ka njohur rritje mbetet me peshë shumë të ulët në vëllimin e përgjithshëm të veprimtarisë së tregut financiar. Në përgjithësi, veprimtaria në tregun financiar ka qenë e qëndrueshme gjatë vitit 2008, madje disa segmente të tij kanë njohur rritje të vëllimit. Kjo ecuri është ndikuar kryesisht nga rritja e veprimtarisë në tregun parësor (primar) të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe rritja e kërkesës për likuiditet nga ana e sektorit bankar, për shkak të rënies së depozitave në tremujorin e fundit të vitit. Për të plotësuar kërkesat e rritura për likuiditet, Banka e Shqipërisë ka kryer operacionet e nevojshme të tregut të hapur.

Ecuria e normave të interesit në tregun financiar, për produktet si depozitat, kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit të qeverisë, u kushtëzua nga situata e përgjithshme e likuiditetit, duke reflektuar një rritje relative.

Normat e interesave për depozitat kanë treguar prirje rritëse, si për monedhën vendase dhe për euron e dollarin amerikan. Pavarësisht uljes së interesave për valutat kryesore në tregjet ndërkombëtare, bankat kanë preferuar të ruajnë nivele relativisht të larta për tërheqjen e fondeve në valutë në tregun e brendshëm. Diferenca midis normave të interesit të depozitave në monedhën kombëtare dhe atyre në monedhë të huaj, ka mbetur pozitive dhe në nivele të qëndrueshme, duke reflektuar nivelin e normave bazë të interesit dhe preferencat e sektorit bankar për monedhat respektive.

Ndryshe nga ecuria e interesave për depozitat, ato për kreditë kanë shfaqur prirje të lehtë rënëse gjatë vitit 2008. Kjo ka ndikuar në ngushtimin e diferencës midis këtyre dy treguesve dhe në uljen relative të kostos së ndërmjetësimit të sektorit bankar. Megjithatë, situata e paqëndrueshme e likuiditetit të sektorit bankar dhe nevoja për të bërë një përzgjedhje më të kujdesshme të huamarrësve, kanë sjellë uljen e sasisë së fondeve të disponueshme për kreditim dhe rritjen e normës së interesit; një dukuri e shfaqur më shumë në pjesën e parë të vitit 2009. Prirja e këtij viti për të preferuar më shumë kreditimin në monedhën kombëtare, vlerësohet si një zhvillim pozitiv i cili duhet të thellohet nga sektori bankar nëpërmjet krijimit të stimujve tërheqës për huamarrësit, kryesisht në lidhje me çmimin e kredisë. Në afat të mesëm, kjo do t'i shërbejë vendosjes së një ekuilibri më të mirë përsa i takon përbërjes së portofolit të kredisë sipas monedhave.

Grafik 40. Ecuria e normave të interesit për kreditë e akorduara në lekë dhe në euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i këmbimeve valutore, në përgjithësi është karakterizuar nga vëllime të qëndrueshme të tregtimit. Në këtë treg, vëllimet janë mbizotëruar nga sektori bankar, në marrëdhënie me institucione të tjera financiare jobanka dhe klientë. Gjatë vitit të kaluar, është konstatuar një rritje e vëllimit të transaksioneve të këmbimit, nga ana e sipërmarrjeve të mëdha të biznesit, publike dhe private. Çmimet e valutave kryesore ndaj monedhës kombëtare, kanë reflektuar situatën e brendshme të kërkesës dhe të ofertës për valutë, si edhe zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Në pjesën më të madhe të vitit, kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave ka qenë i qëndrueshëm. Megjithatë, presioni mbi kursin e këmbimit ka filluar të rritet në fund të vitit, duke reflektuar pakësim të ofertës së valutës si edhe elemente psikologjike për shkak të ndjenjës së pasigurisë që përcillnin zhvillimet e krizës financiare ndërkombëtare.

Grafik 41. Ecuria e normave të interesit për depozitat e pranuara në lekë dhe euro.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. *Spread*-i normës së interesave të kredi - depozita sipas monedhave kryesore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e tregut të sigurimeve gjatë vitit 2008, sikurse dhe një vit më parë, përbëhet nga dhjetë shoqëri sigurimesh nga të cilat shtatë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jojetës, dy në sigurimet e jetës dhe një në sigurimin e jetës dhe të jojetës bashkë. Viti 2008, për tregun e sigurimeve u karakterizua nga zhvillime pozitive kombinuar me ndikimin që ka sjellë hyrja e investitorëve të huaj në këtë treg, duke krijuar hapësira të nevojshme për konkurrencë. Kjo u materializua me shtimin e aktiveve, investimeve, pagesës së dëmeve, si dhe shtimin e të ardhurave nga primet e shkruara bruto ku dominojnë kryesisht primet e shkruara për sigurimin e detyruar. Megjithatë, referuar të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për 9-mujorin e parë të vitit 2008, raporti dëme ndaj primeve vazhdon të mbetet në nivele të ulta 29.1 për qind për tregun e sigurimeve të jojetës dhe 8.9 për qind për tregun e sigurimeve të jetës.

Gjatë vitit 2008, tregu i pensioneve private suplementare u karakterizua nga e njëjta shkallë zhvillimi si një vit më parë, në të cilën vazhduan të ushtronin veprimtarinë e tyre tre institute private të pensioneve. Niveli i kontributeve për këtë treg për vitin 2008 ka shënuar rritje në masën 65 për qind krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, ky segment i tregut financiar mbetet ende në nivele të ulta zhvillimi.

4.1.1 TREGU NDËRBANKAR

Gjatë vitit 2008, vëllimi i huadhënies në monedhën kombëtare në tregun ndërbankar, ka shënuar rritje në krahasim me një vit më parë. Deri në muajin

shtator, vëllimi mesatar ditor i huadhënies u rrit në 2.3 miliardë lekë, nga 1.8 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit paraardhës. Pavarësisht rritjes së vëllimit të tregtimit, tipare të tregut ndërbankar mbeten përqendrimi relativisht i lartë i fondeve që jepen hua dhe prania e kufizimeve për tregtim midis bankave, si rezultat i politikave të brendshme.

Grafik 43. Ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Luhatshmëria e normave të interesit për huatë në tregun ndërbankar, ka qenë më e theksuar se një vit më parë, duke reflektuar ndryshimet e situatës së likuiditetit në treg. Deri në muajin shtator, normat e interesit janë luhatur poshtë nivelit të normës bazë të interesit, duke shfaqur një rritje të natyrshme gjatë kohës së llogaritjes dhe të plotësimit të nivelit të rezervës së detyruar nga ana e bankave. Krijimi i një mungese strukturore të likuiditetit në këtë periudhë dhe injektimi i sasisë që mungonte nga Banka e Shqipërisë, ndikoi në afrimin e normave të interesit në tregun ndërbankar pranë normës bazë të interesit dhe nxiti aktivitetin në tregun ndërbankar, duke krijuar kushte më të mira për transmetimin e politikës monetare. Diferenca e normës së interesit njëditor me atë të normës së interesit bazë në këtë periudhë, llogaritet mesatarisht rreth 70 pikë bazë, nga rreth 90 pikë bazë në vitin e kaluar. Në tremujorin e fundit të vitit, mungesa e likuiditetit në treg u shoqërua me rritje të normës së interesit për huadhëniet në tregun ndërbankar. Kështu, në muajt shtator-nëntor, në momentet e plotësimit të rezervës së detyruar (shtator), norma e interesit për transaksionet njëditore u rrit në rreth 7.7 për qind ose rreth 135 pikë bazë mbi normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes. Në këtë mënyrë, norma mesatare e interesit për transaksionet njëditore u ngjit në 7.16 për qind ose rreth 90 pikë bazë mbi normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes. Vëllimi mesatar i huadhënies për periudhën shtator-nëntor ishte rreth 1.6 miliardë lekë, duke shënuar rënie për shkak të ruajtjes së likuiditetit në kushtet e rënies së depozitave. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë nisi të injektojë likuiditet në tregun ndërbankar nëpërmjet operacioneve të saj të tregut të hapur. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë[29] dha efekt në uljen e kostos së sigurimit të likuiditetit në tregun ndërbankar. Gjatë muajit dhjetor, norma e interesit për huadhënien njëditore zbriti pranë nivelit mesatar vjetor prej rreth 5.85 për qind.

Grafik 44. Ecuria e vëllimit të huadhënies në tregun ndërbankar (në milionë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.2 OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR GJATË VITIT 2008

Lëkundja e besimit të publikut në kushtet e zhvillimeve të krizës financiare ndërkombëtare, u shoqërua me tërheqjen e depozitave nga bankat tregtare

në tremujorin e fundit të vitit, duke ndikuar negativisht në situatën e likuiditetit të sektorit bankar. Për të lehtësuar situatën e likuiditetit në sektorin bankar dhe për të mbajtur nën kontroll normat e interesit në treg, Banka e Shqipërisë filloi injektimin e likuiditetit në tregun ndërbankar, nëpërmjet operacioneve të saj të tregut të hapur (shiko hapësirë informuese 5). Instrumenti kryesor i përdorur ishte marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me afat maturimi njëjavor. Për të ofruar likuiditet me afat më të gjatë, u përdor edhe marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me afat maturimi njëmujor dhe tremujor. Bankave tregtare iu bë e qartë se injektimi i likuiditetit do të vijonte deri në normalizimin e plotë të situatës.

Përpara tremujorit të fundit të vitit, huaja e bankës qendrore për bankat tregtare sigurohej me letra me vlerë të borxhit afatshkurtër të qeverisë (bono thesari), të cilat zotëroheshin prej tyre. Për të rritur mundësitë e bankave tregtare që të përfitonin sasi më të mëdha të likuiditetit sipas nevojave të tyre, nevojitej zgjerimi i llojeve të pranueshme të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë. Për këtë, Banka e Shqipërisë kreu një ndryshim rregullativ, i cili lejonte përdorimin e letrave me vlerë të borxhit afatgjatë (obligacione) me afat të mbetur maturimi deri në 12 muaj, krahas bonove të thesarit. Deri atëherë, letrat me vlerë të borxhit afatgjatë të qeverisë mund të përdoreshin vetëm si garanci për instrumentet e tjera të Bankës së Shqipërisë, konkretisht për "kredinë njëditore" dhe "kredinë brenda ditës".

Një tjetër ndryshim rregullativ që synonte të rriste fleksibilitetin e bankave tregtare për administrimin e nevojave të paparashikuara të likuiditetit ishte rritja e normës së përdorimit të rezervës së detyruar nga 20 për qind në 40 për qind të vlerës. Në këtë mënyrë, bankat tregtare mund të përdornin deri në 40 për qind të fondit të vendosur pranë Bankës së Shqipërisë, me kusht që në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës, mesatarja mujore të ishte e njëjtë me vlerën e përcaktuar të rezervës së detyruar.

Krahas shtimit të sasisë së likuiditetit, ishte e nevojshme gjithashtu që të kontrollohej luhatshmëria në nivelin e normave të interesit në tregun ndërbankar. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë miratoi kalimin e përkohshëm në një korridor asimetrik të normave kufi të interesit, duke ulur diferencën midis normës së interesit të kredisë njëditore dhe normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes nga 175 pikë bazë (1.75 pikë përqindje) në 75 pikë bazë (0.75 pikë përqindje). Kështu, u realizua ngushtimi i zonës së mundshme të luhatjes së normës së interesit të huadhënieve në tregun ndërbankar.

Hapësirë informuese 5. Instrumentet e tregut të hapur (të politikës monetare).

Operacionet e tregut të hapur, të cilat konsistojnë në operacionin kryesor, operacione rregulluese dhe operacione strukturore, janë operacionet bazë për administrimin e likuiditetit nga banka qendrore. Dinamika e ngjarjeve të vitit 2008 kërkoi përdorimin e të gjitha instrumenteve të tregut të hapur:

- *Operacioni kryesor i tregut përfaqësohet nga marrëveshja e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor, që kryhet çdo javë. Gjatë vitit të kaluar,*

sipas pozicionimeve të saj për tërheqje ose injektim të likuiditetit me synimin për të administruar situatën e likuiditetit në treg, Banka e Shqipërisë tërhoqi likuiditet nëpërmjet marrëveshjes së riblerjes me maturim njëjavor mesatarisht 3.6 miliardë lekë në javë; dhe injektoi nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 5.8 miliardë lekë në javë.

- *Operacionet rregulluese të tregut. Në ndryshim nga operacioni kryesor i tregut, operacionet rregulluese të tregut përdoren me frekuencë të papërcaktuar, në situata të veçanta kur është e nevojshme zbutja e luhatjeve të normave të interesit, të shkaktuara nga lëvizje të papritura dhe/ose afatgjata të likuiditetit të sistemit. Në tremujorin e parë të vitit, marrëveshjet e riblerjes me maturim një dhe tremujor u përdorën në funksion të pakësimit të shpejtë të tepricës së likuiditetit për të minimizuar presionet për rënien e normave të interesit. Për të normalizuar shqetësimin për mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga faktori psikologjik gjatë tremujorit të fundit, Banka e Shqipërisë, krahas përdorimit të instrumentit kryesor, injektoi likuiditet nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëmujor dhe tremujor. Shuma mesatare e injektuar ishte respektivisht 3.2 miliardë lekë në tre ankande njëmujore dhe në dy ankande tremujore. Ankandet njëmujore patën një raport mesatar kërkesë/ofertë prej 95 për qind, ndërsa i njëjti raport për ankandet tremujore ishte më i lartë, 148 për qind.*

- *Operacionet strukturore të tregut. Operacionet strukturore përdoren në rast të nevojës për rregullime afatgjata të strukturës së likuiditetit dhe realizohen nëpërmjet blerjes ose shitjes me të drejta të plota të letrave me vlerë të borxhit afatshkurtër të qeverisë (bonove të thesarit). Në fillim të vitit 2008, në funksion të orientimit të operacioneve në drejtim të krijimit të një mungese strukturore të likuiditetit në sistemin bankar, Banka e Shqipërisë uli portofolin e saj të bonove të thesarit me 2 miliardë lekë, nëpërmjet një ankandi të vetëm. Në tremujorin e fundit të vitit, ndërhyrjet me karakter strukturor patën kahun e kundërt, duke synuar injektimin e likuiditetit. Nëpërmjet ankandit për blerjen me të drejta të plota të bonove të thesarit nga bankat tregtare, Banka e Shqipërisë rriti likuiditetin e tyre të përhershëm me 2.2 miliardë lekë.*

- *Lehtësitë e përhershme. Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore – janë instrumente në dispozicion të bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin në bazë ditore. Teorikisht, në kushtet e një pranie të rregullt të bankës qendrore në treg (nëpërmjet instrumentit kryesor të saj), të një tregu ndërbankar të zhvilluar dhe të mundësisë për përdorimin e rezervës së detyruar në bazë ditore, përdorimi i lehtësive të përhershme nga bankat e nivelit të dytë, duhet të jetë minimal. Megjithatë, zhvillimi relativisht i ulët i tregut ndërbankar ka bërë që edhe gjatë vitit 2008, lehtësia e depozitës njëditore të përdorej gjerësisht nga bankat që dispononinlikuiditet të tepërt dhe që zgjidhnin ta depozitonin atë në Bankën e Shqipërisë. Gjatë vitit 2008, vlera mesatare ditore e shumës së depozituar në Bankën e Shqipërisë ishte rreth 3.6 miliardë lekë, në krahasim me 1.6 miliardë lekë në ditë në vitin 2007. Theksojmë që në vitin 2007, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme gjatë gjysmës së parë të vitit në drejtim të tërheqjes së likuiditetit nëpërmjet instrumentit të saj kryesor duke pakësuar mundësitë e bankave tregtare për të përdorur lehtësinë e depozitës njëditore. Ndërsa, gjatë vitit 2008, është ndërhyrë për rreth dhjetë muaj në drejtim të injektimit të likuiditetit, ndaj mundësitë e përdorimit të depozitës njëditore nga bankat tregtare kanë qenë më të mëdha. Nga ana tjetër, injektimi i likuiditetit nëpërmjet instrumentit kryesor ka ulur nevojën për përdorimin e kredisë njëditore. Gjatë gjithë vitit, kredia njëditore u përdor në 21 ditë pune, me një mesatare përdorimi prej 0.3 miliardë lekësh. Kredia njëditore pati përqendrim më të lartë gjatë tremujorit të fundit të vitit kryesisht nga bankat e vogla të sistemit, të cilat*

për shkak të ekzistencës së kufijve të tregtimit, kanë hasur vështirësi në gjetjen e likuiditetit në forma të tjera.

- *Instrumente mbështetëse. Kredia lombard është instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë, që iu akordohet bankave në vështirësi të përkohshme me likuiditetin, por që janë financiarisht të qëndrueshme. Ky instrument nuk gjeti asnjë përdorim gjatë vitit 2008.*

4.1.3. TREGU PARËSOR I EMETIMIT TË LETRAVE ME VLERË TË BORXHIT TË QEVERISË DHE ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT (*YIELD*)

Normat e kthimit nga investimet në bonot e thesarit në tregun parësor, sipas maturimeve, kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë pjesës më të madhe të vitit 2008. Në muajt e parë të vitit, ato kanë përcjellë rritjen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë gjatë fundit të vitit 2007, duke shfaqur një prirje rritëse. Në tremujorin e tretë u vu re një rënie relative e normave të kthimit, pas krijimit të tepricave të mëdha të likuiditetit në treg. Kështu, norma e kthimit nga investimi në rastin e bonove të thesarit me maturim 12-mujor, në muajin shtator shënoi 7.94 për qind nga 8.23 për qind në muajin janar. Gjatë tre muajve të fundit të vitit, normat e kthimit janë rritur duke përcjellë shtrëngimin e kushteve të likuiditetit në sektorin bankar dhe rritjen e kërkesës për borxh të brendshëm nga ana e qeverisë.

Grafik 45. Ecuria e *yield*-it të letrave me vlerë të qeverisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veçanërisht në dy muajt e fundit të vitit, u vu re një hezitim i bankave për të investuar në tregun parësor të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, për shtim të vlerës së investuar ose riinvestim të saj. Për këtë arsye, në kushtet kur pjesëmarrja e bankave në ankand ishte e ulët dhe shuma e borxhit të kërkuar nga qeveria nuk plotësohej në mënyrë të qëndrueshme, u konstatua një rritje e normave të kthimit nga investimi në bono thesari. Në fakt, në muajin dhjetor, norma e kthimit për investimet në bonot e thesarit me maturim 12-mujor rezultoi 8.56 për qind ose 0.3 pikë përqindjeje më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë vitit 2008, të njëjtën prirje rritëse pati edhe norma e kthimit nga investimi në bonot e thesarit me afat maturimi 6-mujor. Ndërsa, norma e kthimit nga investimet në bonot e thesarit me afat maturimi 3-mujor qëndroi mesatarisht pranë nivelit 6.25 për qind, pothuaj e njëjtë me normën bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 46. Ecuria e pjesëmarrjes së bankave dhe individëve sipas vëllimit në lekë të letrave me vlerë të qeverisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2008, preferenca e bankave për të investuar në instrumentet afatgjata ka vazhduar të rritet dhe kërkesa për to ka qenë e qëndrueshme. Ecuria e normave të kthimit nga këto investime është luhatur në varësi të ndryshimeve në raportet ofertë/kërkesë në treg. Gjatë pjesës së parë të vitit, ato kanë patur një ecuri të qëndrueshme me prirje rënëse, të përqendruar kryesisht në tremujorin e tretë. Diferencat midis normave të kthimit për letrat me vlerë me maturime të ndryshme janë zvogëluar, duke zbutur pjerrësinë e kurbës. Bie në sy ngushtimi i diferencës midis normës së kthimit nga investimi të obligacioneve 5-vjeçare dhe të atyre 2-vjeçare, që tregon për uljen e nivelit të rrezikut të perceptuar prej agjentëve, për këto letra afatgjata. Në muajt e fundit, kërkesa e bankave është kushtëzuar nga vështirësitë e lidhura me likuiditetin në treg, duke u shoqëruar nga një pjesëmarrje më e ulët dhe kërkesa më të larta për normën e kthimit nga investimi. Kështu, norma mesatare e kthimit nga investimi në obligacionet me afat maturimi 2-vjeçar, u rrit me 0.15 për qind në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

4.2 TREGU VALUTOR DHE ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT

Në fund të vitit 2008, në terma nominalë, kursi i këmbimit të lekut kundrejt euros dhe dollarit amerikan pasqyronte një rënie vjetore prej respektivisht 0.37 për qind dhe 10 për qind, kryesisht si reflektim i zhvillimeve në tregun ndërkombëtar. Megjithatë, në terma mesatarë vjetorë, leku është mbiçmuar me 0.66 për qind kundrejt euros dhe me 7.23 për qind kundrejt dollarit amerikan.

Grafik 47. Ecuria ditore e kursit të këmbimit euro/lek dhe usd/lek.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kundrejt shportës së valutave kryesore, ecuria e kursit të këmbimit të monedhës kombëtare ka qenë e ndryshueshme. Leku është forcuar kundrejt shportës së valutave kryesore gjatë periudhës janar-prill, duke kulmuar në muajin prill me një forcim prej 6.2 për qind në terma vjetorë. Në tremujorët e dytë dhe të tretë, është reflektuar një ngadalësim i ritmeve të mbiçmimit vjetor duke zbritur në 1.4 për qind në muajin shtator. Në tremujorin e fundit të vitit, kursi i këmbimit të lekut kundrejt shportës së valutave kryesore, është nënçmuar mesatarisht me 3.2 për qind në terma vjetorë.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2008, ecuria e kursit të këmbimit të lekut ka reflektuar qëndrueshmërinë e treguesve makroekonomikë të vendit, diferencën pozitive të normave të interesit sipas valutave, zhvillimet në tregun ndërkombëtar të këmbimit dhe lëvizjet e përkohshme në kërkesën dhe ofertën për valutë në tregun e brendshëm.

Aktiviteti në tregun vendas të këmbimit valutor ka treguar rritje të vazhdueshme, jo vetëm si pasojë e zgjerimit të aktivitetit tregtues, i cili ka

rezultuar me një rritje totale 31.1 për qind në terma vjetorë në vitin 2008, por edhe nga rritja e profesionalizmit të pjesëmarrësve të tregut. Këta të fundit, paraqesin një sjellje gjithnjë e më paraprirëse ndaj sezonalitetit të kursit të këmbimit.

Me fillimin e vitit 2009, presioni për nënçmimin e lekut në këmbimin me valutat kryesore është bërë i dukshëm. Pakësimi i dërgesave nga emigrantët në tremujorin e fundit të vitit 2008, rënia e eksporteve si edhe zhvillimet e krizës ndërkombëtare, kanë qenë faktorët ekonomikë dhe psikologjikë që kanë ndryshuar strukturën e kërkesës dhe të ofertës për valutë në tregun e brendshëm. Banka e Shqipërisë ka ndjekur me vëmendje situatën dhe ka kryer operacionet e nevojshme në tremujorin e parë të vitit, për të ulur luhatshmërinë dhe shpejtësinë e lëvizjes së kursit të këmbimit, të cilat mund të kenë ndikim negativ në sjelljen e agjentëve ekonomikë dhe në ecurinë e inflacionit. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë i ka rikujtuar edhe një herë të gjithë agjentëve ekonomikë, institucionalë dhe individualë, që kursi i këmbimit është i lirë. Për këtë arsye, të gjithë agjentët ekonomikë duhet të njohin, të vlerësojnë rrezikun që vjen prej lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit dhe ta administrojnë këtë rrezik, nëpërmjet kryerjes së veprimeve të nevojshme.

Grafik 48. Vëllimi total i tregtimeve valutore gjatë vitit 2008.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.3 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Gjatë vitit 2008, tregu i banesave është karakterizuar nga frenimi i ritmit të rritjes së çmimeve dhe nga luhatje të indeksit të qirasë.

Indeksi mesatar i çmimit të banesave për rrethin e Tiranës, ka rënë me 0.3 për qind në terma vjetorë, në ndryshim nga sjellja në tre vitet paraardhëse kur indeksi ka shënuar rritje të ndjeshme. Frenimi në normën e rritjes së çmimeve të banesave mund të jetë i lidhur si me zbutjen e kërkesës për banesa, ashtu edhe me një rritje të ofertës për to. Kështu, sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues, bankat raportojnë për një rënie të kërkesës së individëve për kredi për blerje banese, si edhe për një shtrëngim të standardeve të kredidhënies për këtë qëllim. Shtrëngimi i kushteve të kreditimit për banesa, veçanërisht gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, mund të ketë ndikuar në uljen relative të kësaj kërkese.

Ndërkohë, në kahun e ofertës, gjatë vitit 2008 është konstatuar një prirje rritëse e ndërtimeve të reja, duke patur ndikim për një frenim të rritjes së

Grafik 49. Pesha e kredisë për prona të patundshme në përqindje kundrejt tepricës së kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 50. Indeksi i çmimeve të shtëpive për rrethin e Tiranës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

çmimeve. Kjo duket edhe nga ecuria e indeksit të çmimit të pasurive të paluajtshme, për zonën e kryeqytetit në grafikun e mëposhtëm.

Ndërkohë, indeksi i kushtimit në ndërtim, i cili vlerëson ecurinë e kostove të ndërtimit, nuk paraqet ndryshime të theksuara gjatë vitit 2008. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007, ky indeks ka shënuar një rritje 1.4 për qind në tremujorin e katërt të vitit. Faktor kryesor në rritjen e këtij treguesi është ndryshimi pozitiv i indeksit të çmimeve të grupit "shpenzime direkte" me 0.2 për qind kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe me 2.4 për qind kundrejt tremujorit të fundit të vitit 2007. Ky grup shpenzimesh zë 67.6 për qind të shpenzimeve totale, duke patur kështu peshën kryesore në shpenzimet e ndërtimit. Brenda këtij grupi, kanë shënuar rritje indekset e nëngrupeve "shpenzime për paga" prej 1.6 për qind dhe "shpenzime makinerie" prej 0.3 për qind. Indeksi i çmimeve të nëngrupit "shpenzime materiale" ka shënuar një ulje prej 0.2 për qind në tremujorin e katërt, por një rritje prej 1.1 për qind në krahasim me fundin e vitit të kaluar. Brenda tij, mund të përmendim uljen e çmimeve të materialeve të ndërtimit prej 0.3 për qind. Indeksi i çmimeve të materialeve elektrike ka shënuar një rritje prej 3.8 për qind për tremujorin e fundit dhe një rritje prej 7.8 për qind krahasuar me fundin e vitit 2007. Ndërkohë, nuk ka ndryshime në përqindjen e fitimeve të parashikuara. Zhvillimet në këtë indeks, tregojnë që çmimet në tregun e banesave nuk kanë reflektuar plotësisht ecurinë e kostove të ndërtimit, duke nënkuptuar uljen e marzheve të fitimit për industrinë e ndërtimit.

Ecuria e çmimeve të banesave, është me rëndësi për industrinë e ndërtimit, për publikun dhe për sistemin financiar në vend. Për vetë rolin që banesat dhe pasuritë e tjera të patundshme luajnë në konsumin afatgjatë të qytetarëve, në sektorin bankar dhe në sistemin financiar, njohja e ecurisë së çmimit të tyre dhe e faktorëve që shkaktojnë ndryshimin e kësaj ecurie, merr rëndësi të madhe. Aktualisht, për të nxjerrë konkluzione mbi prirjet e ecurisë së çmimit të banesave në të ardhmen, është e nevojshme të përmirësohet metodologjia e mbledhjes së informacionit për të siguruar një shtrirje më të madhe gjeografike si edhe një vlerësim më të saktë sipas llojeve të banesave, sipërfaqeve, vendndodhjes, vitit të ndërtimit, mënyrës së financimit, mënyrës së pagesës etj..

5 ANALIZA E TREGUESVE TË SHËNDETIT TË SISTEMIT FINANCIAR

Analiza e treguesve të shëndetit të sistemit financiar përqendrohet në zhvillimet kryesore të aktivitetit të ndërmjetësimit bankar gjatë vitit, duke përfshirë marrëdhëniet midis zërave të bilancit dhe ndryshimit të strukturës së tyre, cilësinë e investimeve të sistemit financiar, kapitalizimin etj.. Kjo analizë kryhet si për sistemin financiar ashtu edhe për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit për të evidentuar faktorët sistemikë të rrezikut. Informacioni mbi treguesit e shëndetit financiar për ndërmjetësit financiarë jobanka jepet në hapësirën informuese 8. Gjithashtu, analiza plotësohet nëpërmjet analizave "stress-test" për sektorin bankar të cilat janë përmbledhur në hapësirën informuese 7.

Analiza është shtrirë edhe në grupet e bankave, që janë: Grupi 1, i cili përfshin bankat që zënë secila nga 0-2 për qind të totalit të aktiveve të sektorit; Grupi 2, që përfshin bankat që zënë secila nga 2-7 për qind të totalit të aktiveve të sektorit; dhe Grupi 3, që përfshin bankat që zënë mbi 7 për qind të totalit të aktiveve të sektorit.

5.1 ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË SISTEMIN FINANCIAR DHE SEKTORIN BANKAR

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar[30] ndaj Produktit të Brendshëm Bruto[31] (PBB-së) është rritur në 82 për qind në fund të vitit 2008, kundrejt 79.4 për qind në fund të vitit 2007. Në tabelën 9, jepet shpërndarja e peshave të subjekteve që përbëjnë sistemin financiar ndaj PBB-së në vite. Në fund të vitit 2008, vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare që operojnë në vend u rrit me 12.6 për qind krahasuar me fundin e vitit 2007. Në strukturën e aktiveve të sistemit financiar, bankat luajnë rolin kryesor. Në fund të vitit 2008, në vendin tonë operonin 16 banka. Aktivet e tyre përfaqësonin rreth 95.4 për qind të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 78 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së).

Viti	2005	2006	2007	2008
Sistemi bankar	60.4	69.6	75.9	77.7
Institucione jobanka	1.32	1.52	1.48	1.55
Shoqëri të sigurimit	1.24	1.29	1.36	1.52
Fondet e pensionit	-	-	-	-
SHKK-të	0.46	0.52	0.63	0.71

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Tabelë 9. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %).

Gjatë vitit 2008 vijoi rritja e veprimtarisë së sektorit bankar, e cila e shprehur në totalin e aktiveve të sistemit arriti në 843.1 miliardë lekë ose 12.4 për qind më e lartë se një vit më parë. Ecuria e aktivitetit megjithatë ka ndjekur një dinamikë të ndryshme gjatë vitit. Për shkak të tërheqjeve të depozitave në tremujorin e katërt '08, ndryshimi i totalit të aktiveve këtë tremujor, në krahasim me tremujorin e tretë ishte -2.7 për qind.

Veprimtaria e kreditimit, e cila përbën rreth 48 për qind të aktivit në dhjetor 2008, megjithëse vijoi trendin rritës që prej vitit 2003, u ngadalësua veçanërisht në tremujorin e fundit të vitit. Portofoli i kredive arriti në vlerën 396.8[32] miliardë lekë, duke zënë rreth 37 për qind të PBB-së. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kjo tepricë evidenton një rritje me 104.3 miliardë lekë ose rreth 36 për qind. Aktivet dhe detyrimet në valutë të sektorit bankar, pavarësisht peshës së tyre vazhdimisht në rritje ndaj totalit të bilancit, kanë dëshmuar për një ekspozim të ekuilibruar në valutë siç pasqyrohet në madhësitë e tyre të krahasueshme.

Për sa i takon mënyrës së financimit të veprimtarisë, në anën e detyrimeve të sektorit bankar, zëri kryesor janë depozitat e klientëve. Këto, në vlerën 645.1 miliardë lekë, shënuan një rritje me 2.4 për qind prej fundit të vitit të kaluar dhe përbënë rreth 77 për qind të totalit të aktiveve. Gjatë vitit 2008, pesha e depozitave të publikut në totalin e aktiveve të sektorit bankar, shënoi rënie për herë të parë pas disa viteve, si rezultat i tërheqjes së depozitave nga publiku në tremujorin e fundit të vitit. Në këtë periudhë vlerësohet se janë tërhequr rreth 49.1 miliardë lekë ose rreth 7 për qind e vlerës së tyre në tremujorin e tretë. Fondet e veta të përfaqësuara nga kapitali aksioner, arritën në 80.4 miliardë lekë duke u rritur me 1.3 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007 dhe 0.7 pikë përqindje në krahasim me fundin e tremujorit të tretë. Pavarësisht peshës së tyre vazhdimisht në rritje ndaj totalit të bilancit, aktivet dhe detyrimet në valutë, duke patur madhësi të krahasueshme, kanë dëshmuar për një ekspozim të ekuilibruar ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit. Në fund të vitit 2008, aktivet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 48.9 për qind të totalit të aktiveve kurse detyrimet në valutë të huaj zinin rreth 48.5 për qind të tyre.

Në lidhje me përqendrimin e veprimtarisë, theksojmë që në fund të vitit 2008, aktivet e bankave më të mëdha që bëjnë pjesë në Grupin 3, përfaqësojnë 73.6 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Bankat e Grupit 3, me shtimin e numrit në tremujorin e dytë, e kanë zgjeruar peshën e tyre. Në këtë mënyrë, rëndësia e mbarëvajtjes së veprimtarisë së tyre është rritur dhe roli që ato kanë në rrezikun sistemik është fuqizuar. Megjithatë, rritja e numrit të bankave brenda një grupi të caktuar, shoqërohet me rënien e përqendrimit të veprimtarisë brenda grupit dhe më tej për sektorin bankar në tërësi. Më tej, aktivet e bankave të Grupit 2 përfaqësojnë 22.6 për qind dhe ato të bankave të Grupit 1 përfaqësojnë 3.8 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar (grafik 51).

Grafik 51. Pesha e secilit grup bankar në totalin e aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vijim do të paraqitet një analizë e detajuar e karakteristikave të aktivitetit të ndërmjetësimit nga ana e sistemit bankar, duke u përqendruar në analizën e treguesve të shëndetit financiar. Në mënyrë të përmbledhur treguesit kryesorë të shëndetit financiar për vitin 2008 dhe tremujorin e parë të vitit 2009, jepen në tabelën 10 si më poshtë:

Tabelë 10. Treguesit e shëndetit financiar.

(%)	Dhjetor'07	Mars '08	Qershor'08	Shtator'08	Dhjetor'08	Mars '09
Treguesit me bazë kapitalin						
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.08	17.23	17.27	17.50	17.23	17.05
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.01	16.35	16.45	16.64	16.31	16.15
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	6.57	6.93	7.12	7.57	7.83	8.15
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	7.01	7.30	7.47	7.96	8.28	8.60
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	7.87	7.94	8.00	8.57	8.91
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit						
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	10.72	11.86	14.60	12.02	22.97	23.20
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	11.25	13.91	11.43	21.74	21.97
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	9.14	10.55	12.91	11.52	21.08	22.61
Huatë me probleme bruto ndaj huave totale	3.36	3.92	4.31	4.12	6.64	7.55
Kthimi nga kapitali (roe) (bazë vjetore)	20.74	16.28	16.62	16.33	11.35	1.49
Kthimi nga aktivet (roa) (bazë vjetore)	1.57	1.28	1.31	1.29	0.91	0.13
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve						
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	92.67	100.02	99.20	97.65	106.50	133.50
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	58.51	73.29	72.05	71.98	81.36	151.87
Likuiditeti						
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	48.94	47.05	45.86	42.83	41.27
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra	73.96	71.36	66.15	68.39	64.86	57.13
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit						
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit bazë	1.80	9.91	(0.58)	5.69	4.54	1.39
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator	1.69	9.40	(0.55)	5.41	4.30	1.31
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner	1.57	7.65	(0.53)	5.27	4.05	1.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 MJETET DHE DETYRIMET E SEKTORIT BANKAR, STRUKTURA E TYRE

Pjesën më të madhe të aktiveve të sektorit bankar, në fund të vitit 2008, e zë portofoli i kredive që përbën 47.6 për qind të totalit të aktiveve, rreth 3.5 pikë përqindje më lart, se pesha në fundin e tremujorit të tretë të vitit 2008 dhe 8.2 pikë përqindje më lart, se pesha e këtij zëri një vit më parë. Pesha e portofolit të kredisë në totalin e aktiveve të sektorit bankar, ka ardhur vazhdimisht në rritje që nga fundi i vitit 2003 (tabelë 11 dhe grafik 52.a). Zëri tjetër me më tepër peshë ndër aktivet e sektorit bankar është "veprimet me thesarin dhe ndërbankare"[33]. Në fund të dhjetorit 2008, ky zë arriti në 251.4 miliardë lekë ose në 30.1 për qind të totalit të aktiveve. Pesha e këtij zëri në totalin e aktiveve ka ndjekur një prirje rënëse (tabelë 11), duke zbritur me 5 pikë përqindje në krahasim me fundin e tremujorit të tretë të vitit 2008 dhe 9.3 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Brenda "veprimeve me thesarin dhe ndërbankare", janë veprimet me bonot e thesarit, në vlerën 107 miliardë lekë, që zënë peshën më të madhe (12.8 për qind të totalit të aktiveve), por gjithsesi me ecuri në rënie. Pesha e zërit "veprimet me letra me vlerë" (166.7 miliardë lekë në dhjetor 2008, 20 për qind të totalit të aktiveve) ka ardhur në rritje si kundrejt vitit të kaluar, me 2 pikë përqindje, ashtu edhe kundrejt tremujorit të tretë '08, me 1.7 pikë përqindje. Zërat e tjerë të aktiveve të sektorit bankar vazhdojnë të kenë një peshë relative të parëndësishme.

Tabelë 11. Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08).

Pesha ndaj totalit të aktiveve (në %)	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	76.5	72.4	58.8	50.6	39.5	30.1
- marrëdhënie me bankën qendrore	8.7	8.7	9.3	8.9	9.0	8.3
- bono thesari	49.6	45.8	35.3	26.3	17.1	12.8
- marrëdhënie me bankat e tjera	16.2	15.6	12.2	13.2	11.2	6.6
2. Veprime me klientët (bruto)	13.5	16.4	25.7	31.7	39.4	47.6
3. Veprime me letrat me vlerë	5.4	7.0	12.2	14.7	18.0	20.0
4. Mjete të tjera	0.8	0.8	0.7	0.9	1.3	1.0
5. Mjete të qëndrueshme	1.5	1.9	1.5	1.5	1.5	1.8
Totali i aktiveve	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në anën e detyrimeve të sektorit bankar, depozitat e klientëve shënojnë zërin që ka peshën kryesore me rreth 77.3 për qind të totalit të detyrimeve (grafik 52 b. dhe tabelë 12). Pesha e depozitave ndaj totalit të detyrimeve ka ardhur në rënie si kundrejt fundit të tremujorit të tretë të vitit 2008, ashtu edhe kundrejt fundit të vitit 2007, përkatësisht me 3.7 pikë përqindje dhe 7.5 pikë përqindje. Zëri i dytë më i rëndësishëm i detyrimeve është "veprime me thesarin dhe ndërbankare"[34]. Në fund të muajit dhjetor 2008, ky zë përbën 11.8 për qind të totalit të detyrimeve, rreth 3.2 pikë përqindje dhe 6.2 pikë përqindje më lart krahasuar përkatësisht me fundin e tremujorit të tretë dhe me fundin e vitit 2007. "Burimet e përhershme"[35] kanë patur një peshë në rritje. Në fund të vitit 2008, ato arritën në 9.6 për qind të totalit të detyrimeve të sektorit bankar, duke u rritur me 0.7 pikë përqindje në krahasim me fundin e tremujorit të tretë dhe me 1.3 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007. Tek "burimet e përhershme", 89 për qind e vlerës përfaqësohet nga "kapitali i aksionerëve", i cili në fund të vitit arriti në 71.4 miliardë lekë, duke zënë 8.6 për qind të totalit të detyrimeve. Edhe pesha e këtij zëri shfaq një prirje rritëse, krahasuar me fundin e vitit të kaluar duke u rritur me 1.3 pikë përqindje (grafik 52 b.). Zëri "detyrime të tjera"[36] zinte vetëm 1.1 për qind të totalit të detyrimeve në fund të muajit dhjetor 2008, 0.1 pikë përqindje më shumë se vlera e një viti më parë.

Tabelë 12. Pesha e zërave të pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08).

Pesha ndaj totalit të pasiveve (në %)	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	4.4	4.5	4.1	7.6	5.7	11.8
- marrëdhënie me bankën qendrore	0.2	0.2	0.2	0.2	0.0	0.1
- bono thesari	0.0	0.0	0.0	1.4	0.2	2.4
- marrëdhënie ndërbankare	4.2	4.3	4.0	4.0	5.3	9.0
2. Veprime me klientët (bruto)	88.7	88.1	88.1	84.2	84.9	77.3
3. Detyrime të tjera	0.7	1.0	0.6	0.8	1.0	1.1
4. Burimet e përhershme, nga këto:	6.2	6.3	7.2	7.4	8.4	9.6
- kapitali i aksionerëve	5.9	6.1	6.6	6.8	7.5	8.6
Totali i pasiveve	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Financimi i veprimtarisë bankare vijon të mbizotërohet nga burime të brendshme, prej të cilave depozitat përbëjnë pjesën kryesore. Megjithatë, për

shkak të rënies së depozitave të sektorit bankar në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, kryesisht në valutë, financimi i veprimtarisë me burime të huaja, i shfaqur në formën e rritjes së detyrimeve ndaj jorezidentëve, u ngjit në fund të vitit në 10.1 për qind të totalit të bilancit, nga 8.3 për qind në muajin shtator 2008 dhe 6.1 për qind në fund të vitit 2007.

Grafik 52. Pesha e zërave të aktiveve dhe pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '08).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3 MARRËDHËNIA E ZËRAVE TË BILANCIT

5.3.1 PËRBËRJA E BILANCIT SIPAS VALUTAVE DHE POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË

Në fund të vitit 2008, aktivet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 48.9 për qind të totalit të aktiveve, rreth 1.7 pikë përqindje më pak se fundi i muajit shtator 2008 dhe rreth 2 pikë përqindje më shumë se fundi i vitit 2007. Në të njëjtën periudhë, detyrimet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 48.5 për qind të totalit të aktiveve, rreth 1.7 pikë përqindje më pak se fundi i muajit shtator 2008 dhe 1.6 pikë përqindje më shumë se fundi i vitit 2007.

Në peshën e tyre ndaj totalit të aktiveve, aktivet në valutë dhe detyrimet në valutë kanë qenë pothuaj gjithmonë në vlera shumë të përafërta, duke dëshmuar kështu një ekspozim të ekuilibruar e të përputhur ndaj aktivitetit në valutë, nga ana e sektorit bankar. Ecuria e tyre në disa periudha, jepet në tabelën e mëposhtme:

Pesha ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar (në %)			
Periudha	Aktive në valutë	Detyrime në valutë	Diferenca (1)-(2)
Dhjetor 2005	41.1	41	0.1
Mars 2006	41.5	41	0.5
Qershor	41.6	41.6	0
Shtator	43.3	43.2	0.1

Tabelë 13. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Dhjetor	44.2	44	0.2
Mars 2007	45.6	45.2	0.4
Qershor	45.7	45.7	0
Shtator	46.6	46.5	0.1
Dhjetor	46.8	46.9	-0.1
Mars 2008	47.9	47.7	0.2
Qershor	48	48.1	-0.1
Shtator	50.6	50.2	0.4
Dhjetor 2008	48.9	48.5	0.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë (në përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Edhe pse e ekuilibruar, veprimtaria e sektorit bankar në valutë ka ardhur vazhdimisht në rritje, siç dëshmohet edhe nga ecuria e peshës së aktiveve dhe detyrimeve në valutë, gjatë tre viteve të fundit.

Duke qenë se depozitat dhe kreditë janë zërat me peshën më të madhe në bilanc, ato përcaktojnë në masën më të madhe ndjeshmërinë e bankës ndaj ekspozimit në valutë. Në fund të dhjetorit 2008, depozitat në valutë zinin rreth 43.1 për qind të totalit të depozitave. Spektri i shtrirjes së këtij raporti për bankat, varionte nga 29 në 70 për qind. Në të njëjtën periudhë, kredia në valutë zinte 72.6 për qind të totalit të kredisë. Ecuria e këtij raporti jepet në grafikun 53:

Sipas grupeve të bankave, ecuria e këtij raporti jepet në grafikun 54. Siç duket edhe nga grafiku, bankat e Grupit 1 janë ato që kanë preferuar më tepër kredinë në valutë, dhe ky raport ka qenë në rritje kundrejt fundit të tremujorit të tretë të vitit 2008. Dy grupet e tjera të bankave e kanë këtë raport midis 69 dhe 75 për qind. Por, në ndryshim nga grupi 1, ky raport ka ardhur në rënie kundrejt fundit të tremujorit të tretë të vitit 2008.

Grafik 54. Kredia në valutë ndaj totalit të kredisë për grupet bankare.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 55. Depozitat në valutë ndaj kredive në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 56. Ndryshimi në depozita në valutë ndaj kredive në valutë sipas tremujorëve (në pikë përqindje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 57. Depozitat në valutë ndaj kredive në valutë sipas grupeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Madhësia e përdorimit të valutës në veprimtarinë e ndërmjetësimit të sektorit bankar, del në pah edhe nga raporti i depozitave në valutë ndaj kredive në valutë, ecuria e të cilit paraqitet në grafikun 55. Në tremujorin e fundit të vitit 2008, raporti depozita në valutë ndaj kredisë në valutë, për të gjithë sektorin bankar, zbriti për herë të parë nën nivelin 100 për qind, duke shënuar në fund të vitit vlerën 96.5 për qind.

Rënia e ndjeshme e këtij raporti në tremujorin e fundit të vitit, është përcaktuar prej rënies së depozitave në valutë të sektorit bankar, për shkak të tërheqjes së tyre prej publikut. Ndryshimi sipas tremujorëve i ecurisë së këtij raporti, jepet në grafikun 56.

Sipas grupeve të bankave, bankat e Grupit 2 e kanë këtë raport nën nivelin 100 për qind, përkatësisht pranë nivelit 61 për qind (grafik 57). Ndërkohë që bankat e grupeve 1 dhe 3 e kanë rreth 110 për qind. Kjo do të thotë që veprimtaria e kredidhënies në valutë të bankave të Grupit 2, krahas depozitave, financohet nga të tjera burime, ku vendin kryesor e zënë huamarrjet nga bankat mëmë. Ky ekspozim, i bën këto banka më të ndjeshme ndaj kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare.

Në fund të muajit dhjetor 2008, pozicioni i hapur neto në valutë i sektorit bankar përbënte 4.3 për qind të kapitalit rregullator (grafik 58.a.). Ky tregues, gjatë viteve të kaluara ka qenë pothuaj gjithmonë i moderuar "në blerje", në intervalin 0-10 për qind. Nga analiza sipas grupeve të bankave për pozicionin valutor neto (grafik 58.b.), konstatohet që bankat e Grupit 2 kanë preferuar të kenë në vazhdimësi një pozicion neto valutor "në blerje", në vlera të qëndrueshme dhe relativisht më të larta se bankat e grupeve të tjera. Ka shumë mundësi që kjo sjellje të jetë kushtëzuar nga struktura e tyre e burimeve (pamjaftueshmëria e depozitave) dhe nga nevoja për të patur të disponueshme aktive likuide në valutë, në funksion të kërkesave të ndryshme.

Grafik 58. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3.2 PËRBËRJA SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Grafik 59. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe pasiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2008, aktivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi[37] mesatar të mbetur prej rreth 31.8 muajsh, nga 28.8 muaj që llogaritej një tremujor më parë dhe 25.5 muaj referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Në të njëjtën periudhë, pasivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi[38] mesatar të mbetur prej rreth 9.7 muajsh, nga 9.4 muaj një tremujor më parë dhe 9.2 muaj referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ecuria e maturimit mesatar të aktiveve dhe të pasiveve në vitet e fundit jepet në grafikun 59.

Nga grafiku 59, vihet re se maturimi mesatar i aktiveve të sektorit bankar që nga muaji qershor 2005 është rritur me rreth 16.7 muaj (nga 15 muaj në 31.7 muaj). E njëjta ecuri vihet re edhe për pasivet, ku maturimi mesatar i tyre është rritur me rreth 1.9 muaj (nga 7.8 muaj në 9.7 muaj). Diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është zgjeruar, prirje e cila do të tentojë të zgjerohet edhe në të ardhmen. Zgjerimi i kësaj diference, e bën sektorin bankar më të ndjeshëm ndaj rreziqeve të likuiditetit dhe të tregut, ndaj kërkon një kontroll më të kujdesshëm nga ana e industrisë bankare.

Duhet patur parasysh që kategorizimi "në ditë" i aktiveve dhe i detyrimeve, i referohet afatit të mbetur të maturimit dhe jo aftësisë së aktivit ose detyrimit për t'u tregtuar. Kështu, letrat me vlerë supozohet që mbahen deri në maturim. Sigurisht, kur bëhet analiza e treguesve të likuiditetit, tregtueshmëria e një produkti përcakton edhe karakteristikat e tij të likuiditetit dhe ndikon në treguesit e përgjithshëm të likuiditetit të bankës.

Në lidhje me vlerësimin e maturimit të zërave të veçantë të bilancit, jemi përqendruar tek depozitat nga njëri krah dhe kreditë nga krahu tjetër, si produkte që ndikojnë më tepër diferencën (gap-in) e maturimit të zërave të bilancit. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2008, depozitat shfaqin një afat maturimi[39] mesatar prej rreth 4.7 muajsh, krahasuar me rreth 4.9 muaj në tremujorin e tretë dhe në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në fund të vitit 2008, maturimi mesatar[40] i portofolit të kredisë ka rënë në 47.4 muaj, krahasuar me 47.7 muaj në fundin e tremujorit të tretë. Megjithatë, afati mesatar i maturimit të kredive, mbetet rreth 1.9 muaj më i gjatë se vlera e një viti më parë.

Ecuria e kohëzgjatjes mesatare të portofolit të depozitës dhe kredisë, jepet në grafikët 60 dhe 61 më poshtë.

Grafik 60. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave (në muaj).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 61. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë (në muaj).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3.3 PËRBËRJA SIPAS MËNYRËS SË FINANCIMIT

Gjatë vitit 2008, vërehet një rënie e ndjeshme e kontributit të depozitave në rritjen e aktiveve. Rritja e tyre ka kontribuar me vetëm rreth 13 për qind në rritjen e aktiveve, shumë më pak se mesatarja[41], duke treguar një rënie të lartë nga muaji shtator. Nga ana tjetër, kontributi i transaksioneve të grupuara në "veprime me thesarin dhe ndërbankare", ku përfshihen huamarrjet nga bankat e huaja mëmë, ka qenë 62 për qind, duke treguar, përveçse një vlerë shumë më të lartë se mesatarja, shifrën më të lartë të tre viteve të fundit. Kjo tregon një zhvendosje të mënyrës së financimit të aktivitetit për bankat vendase, të cilat janë mbështetur tek huadhënia nga jashtë si rezultat i rënies së depozitave në këtë periudhë. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, rritja e depozitave ka dhënë kontributin kryesor në rritjen e aktiveve.

Grafik 62. Kontributi në rritjen e aktiveve nga burimet në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në "hapësirën informuese 6" jepet në mënyrë më të detajuar ecuria e depozitave gjatë vitit 2008 dhe tremujorit të parë të vitit 2009.

"Burimet e përhershme", kanë kontribuar në masën 19 për qind të rritjes së aktiveve, mbi mesatare. Ndërkohë që edhe kontributi i zërave të tjerë, si "detyrime të tjera" dhe "interesa të përllogaritur" tregon shifra mbi mesataren, përkatësisht 2 dhe 4 për qind.

Grafik 63. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 64. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve sipas grupeve të bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 65. Detyrimet ndaj jorezidentëve ndaj totalit të detyrimeve në valutë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në raport me totalin e detyrimeve të sektorit bankar, "detyrimet ndaj jorezidentëve", të cilat ndikohen kryesisht prej huamarrjeve nga grupet bankare zotëruese, kanë shënuar rritje në tremujorin e fundit të vitit 2008, madje edhe në tremujorin e parë të vitit 2009 (grafik 63).

Siç vërehet nga grafiku 64, bankat e Grupit 2, japin kontributin kryesor në ecurinë e zërit "detyrime ndaj jorezidentëve".

Në rastin e bankave që veprojnë në vendin tonë, detyrimet ndaj jorezidentëve përfaqësojnë linja kredie të marra nga grupet bankare zotëruese, dhe jo hua të marra nga banka të tjera të huaja. Për këtë arsye, siguria për qëndrueshmërinë e tyre përgjatë kohës, është më e madhe.

Meqenëse, huamarrjet nga bankat mëmë janë gjithmonë në valutë, rritja e tyre duke filluar prej tremujorit të fundit të vitit 2008, ka ndikuar në rritjen e peshës së "detyrimeve ndaj jorezidentëve" në totalin e "detyrimeve në valutë", duke u ngjitur në nivelin 21.8 për qind në fund të tremujorit të parë të vitit 2009 (grafik 65). Në rritjen e këtij raporti për tremujorin e fundit të vitit 2008, ka ndikuar rënia e depozitave në valutë të sektorit bankar.

Në grafikun 66 paraqitet ecuria e indeksit Herfindahl, i cili që prej muajit shtator 2008 shfaq një përqendrim në rënie të "detyrimeve ndaj jorezidentëve", për sektorin bankar.

Grafik 66. Përqendrimi i detyrimeve ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me përdorimin e financimit të huaj, konstatohet se prej dhjetorit të vitit 2006 ka patur një zhvendosje nga "aktive nga jorezidentët" drejt "aktive në valutë" (grafik 67), ku përfshihet edhe huadhënia e brendshme në valutë. Në fakt, që prej dhjetorit të vitit 2006, në vlerë relative sektori bankar përgjithësisht ka investuar gjithmonë e më pak pranë grupeve përkatëse zotëruese, dukuri që vërehet nga një rënie e vazhdueshme e "aktiveve ndaj jorezidentëve" në krahasim me "aktivet në valutë". Kjo gjë ka ndodhur në një kohë kur "aktivet në valutë" janë rritur dhe tregon përparësinë që sektori bankar i ka dhënë veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar në vend, nëpërmjet kredidhënies në valutë. Për tremujorin e fundit të vitit 2008, duhet patur parasysh që kjo ecuri është theksuar për shkak të nevojës afatshkurtër për të ulur aktivet me jorezidentët dhe për t'i përdorur ato si mjete për të paguar uljen e vlerës së depozitave në valutë.

Grafik 67. Ecuria e aktiveve të jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 68. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Diferenca midis "aktive nga jorezidentët" me "detyrime ndaj jorezidentëve" të sektorit bankar ka ardhur duke u ngushtuar (grafik 68). Në tremujorin e parë të vitit 2009, sektori bankar paraqitet për herë të parë si "debitor" ndaj jorezidentëve, pra "detyrimet ndaj jorezidentëve" janë më të larta se "aktivet e jorezidentëve".

Hapësirë informuese 6. Depozitat dhe ecuria e tyre.

Niveli i depozitave të sektorit bankar, pësoi rënie në tremujorin e fundit të vitit 2008, duke ndikuar ndjeshëm në rritjen e tyre gjatë gjithë vitit, që rezultoi e dobët. Rënia e depozitave erdhi si rezultat i lëkundjes së besimit të publikut në qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për shkak të efekteve psikologjike të lidhura me zhvillimin dhe ashpërsimin e krizës ndërkombëtare financiare dhe pasigurinë mbi efektin ndaj sektorit bankar shqiptar. Për shkak të situatës mjaft të mirë të likuiditetit dhe të kapitalizimit të veprimtarisë, sektori bankar e përballoi mirë situatën e krijuar. Pavarësisht rënies së përgjithshme të depozitave, depozitat e reja pranë bankave kanë qenë të konsiderueshme, duke reflektuar edhe përpjekjet e bankave për

të rritur ato nëpërmjet ofertave më tërheqëse të normave të interesit. Depozitat mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar, por shkalla e përqendrimit të tyre ka rënë.

Totali i depozitave ka shënuar një rritje prej rreth 2.4 për qind krahasuar me fundin e vitit 2007, ndërkohë që rritja e dy viteve të kaluara qëndron rreth nivelit 20 për qind (tabelë 14). Ndërkohë, kundrejt fundit të muajit shtator 2008, totali i depozitave ka shënuar një rënie me 7 për qind, për shkak të intensifikimit të tërheqjeve nga ana e klientëve të bankave gjatë muajve tetor – dhjetor 2008.

Tabelë 14. Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2008.

	2004	2005	2006	2007	2008
Rritja e totalit të depozitave (në %)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 69. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.

(Dhjetor 2008, në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në analizën e strukturës së depozitave sipas maturimit, vërehet se në muajin dhjetor 2008, shumica e depozitave të sektorit bankar, rreth 66 për qind, janë me maturim deri në një vit (grafik 69). Kundrejt muajit shtator 2008, depozitat me afat deri në një muaj janë rritur me 6 pikë përqindje; ato me afat maturimi 6 deri në 12 muaj janë rritur me 0.2 pikë përqindje; depozitat mbi 5 vjet, të cilat përbëjnë një peshë të papërfillshme, janë pothuaj të pandryshuara, ndërsa maturimet e tjera kanë pësuar rënie. Kundrejt fundit të vitit 2007, depozitat me afat maturimi 6-12 muaj janë rritur me 3.7 pikë përqindje; ato me afat maturimi 1-3 muaj janë rritur me 0.1 pikë përqindje; depozitat me afat maturimi mbi 5 vjet janë të pandryshuara, ndërsa depozitat e afateve të tjera të maturimit kanë rënë.

Lidhur me strukturën e depozitave sipas monedhës, vërehet se në fund të vitit 2008, depozitat në lekë përbënin 57 për qind të totalit të depozitave, në vlerën 367.3 miliardë lekë, ndërsa ato në valutë përbënin 43 për qind të totalit të depozitave, në vlerën 277.9 miliardë lekë. Pesha e depozitave në lekë është rritur me 2.5 pikë përqindje kundrejt fundit të muajit shtator dhe ka rënë me 0.2 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007.

Ecuria e depozitave të reja ka reflektuar situatën e ndjeshme të ecurisë së depozitave në përgjithësi, veçanërisht në tremujorin e fundit të vitit. Kështu, në muajin dhjetor, u pranuan 30.5 miliardë lekë depozita të reja në monedhën vendase, rreth 20 për qind më pak se depozitat e reja të pranuara në muajin shtator dhe rreth 17 për qind më pak se depozitat e reja të pranuara në dhjetor 2007. Megjithë rënien, ecuria e depozitave të reja sipas muajve të tremujorit të fundit të vitit ka shënuar rritje. Kështu, depozitat e reja në lekë të pranuara në muajin dhjetor, ishin përkatësisht 10 dhe 31 për qind më të larta, në krahasim me ato të muajve tetor dhe nëntor. Për sa i takon strukturës së maturimit të depozitave të reja të pranuara, në fund të vitit 2008 është vënë re një rritje në peshën e depozitave të reja me maturim deri në 6 muaj (veçanërisht të atyre me maturim 1 dhe 3-mujor).

Tabelë 15a. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar në lekë.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2007	Mars 2008	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008
2 vjet	2.12	1.37	0.78	2.04	1.31
1 vit	29.96	28.35	24.21	41.72	29.60
6 muaj	17.99	19.04	22.04	15.74	17.10
3 muaj	15.82	22.72	22.04	18.52	23.91
1 muaj	33.76	28.12	30.46	21.39	27.77

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për depozitat e reja në lekë, ka qenë 5.48 për qind në dhjetor, në krahasim me 4.9 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Norma më e lartë e interesit, ka reflektuar kërkesën më të lartë të sektorit bankar për depozita në lekë, në kushtet e rënies së tyre.

Depozitat e reja të pranuara nga sektori bankar në euro, në muajin dhjetor 2008, ishin 751 milionë euro ose 92.2 miliardë lekë. Ecuria e tyre gjatë tremujorit të fundit të vitit ka qenë në rënie, ndonëse me një ritëm më të ngadalësuar. Kështu, depozitat e reja në euro të pranuara në muajin dhjetor 2008 ishin 15.2 për qind dhe 9.4 për qind më të ulëta, përkatësisht se ato të muajve tetor e nëntor. Në krahasim me muajin shtator kjo shifër është pothuaj e pandryshuar, ndërsa është rreth 68 për qind më e lartë kundrejt të njëjtit tregues të muajit dhjetor 2007. Në lidhje me strukturën e maturimit të depozitave të reja në monedhën evropiane, vërehet se janë preferuar nga publiku depozitat 1-mujore, të cilat përbëjnë edhe peshën dërrmuese të tyre (tabelë 15b).

Tabelë 15b. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në euro.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2007	Mars 2008	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008
2 vjet	0.51	0.18	0.24	0.36	0.13
1 vit	8.24	5.76	5.51	9.45	3.56
6 muaj	6.64	6.02	4.98	4.19	2.18
3 muaj	10.98	23.50	9.55	8.97	8.78
1 muaj	73.49	64.41	79.63	76.85	85.31

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për depozitat e reja në euro ka qenë 3.14 për qind në muajin dhjetor 2008, kundrejt dhe 3.01 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Përsëri, rritja e normës së interesit për depozitat në euro, ka reflektuar kërkesën më të lartë të sektorit bankar për depozita në euro, në kushtet e rënies së tyre.

Depozitat e reja në usd të pranuara nga sektori bankar, në muajin dhjetor 2008 ishin 63.8 milionë usd ose 5.3 miliardë lekë. Ecuria e tyre gjatë tremujorit të fundit të vitit ka qenë në rënie, ndonëse me një ritëm më të ngadalësuar. Kështu, depozitat e reja në usd të pranuara në muajin dhjetor ishin 68 për qind dhe 53 për qind më të ulëta, përkatësisht se ato të muajve tetor e nëntor. Kjo shifër është 54 për qind më e ulët sesa ajo e muajit shtator dhe 48 për qind më e ulët sesa ajo e muajit dhjetor 2007. Gjatë gjithë vitit 2008, depozitat me afat maturimi nën 3 muaj përbëjnë mbi 70 për qind të totalit të depozitave të reja në monedhën amerikane (tabelë 16).

Tabelë 16. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në usd.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2007	Mars 2008	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008
2 vjet	0.33	0.18	0.37	0.16	0.12
1 vit	21.48	12.38	10.33	16.64	15.82
6 muaj	10.59	11.63	10.87	10.42	12.42
3 muaj	21.82	24.07	21.23	26.04	22.55
1 muaj	45.47	51.06	57.14	46.56	49.09

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 70. Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit respektivisht për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare mujore e interesit për depozitat e reja në usd, ka qenë 2.01 për qind në dhjetor 2008, krahasuar me 3.66 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Për muajt e parë të vitit 2009, pranimet e reja të depozitave dhe të llogarive rrjedhëse në lekë shfaqin një prirje rënëse në baza mujore, por me një ritëm rënieje tepër të ngadalësuar. Kjo ka përkuar me vijimin e prirjes rënëse të depozitave në tremujorin e parë të vitit 2009. Duke filluar nga muaji maj, stoku i depozitave ka rinisur të rritet duke reflektuar një qëndrueshmëri më të madhe të depozitave ekzistuese.

Pranimet e depozitave të reja dhe të llogarive rrjedhëse në euro, shfaqin një ecuri të qëndrueshme gjatë muajve të parë të vitit 2009. Ndërkohë që vërehet përmirësim më i qëndrueshëm i flukseve të reja hyrëse nga depozitat/llogaritë rrjedhëse në dollarë amerikanë.

Në përgjithësi, ecuria e depozitave të reja, mbështet mendimin që rikthimi i depozitave në sektorin bankar ende nuk është vendosur mbi ritme rritjeje të qëndrueshme. Gjithashtu, faktorë të tjerë që lidhen me mundësinë e zgjatjes së zhvillimeve të pafavorshme të krizës ndërkombëtare, pritjet më të ulëta për flukset nga emigracioni, vështirësitë për rritjen në përgjithësi të të ardhurave të agjentëve ekonomikë dhe rënien e ritmit të rritjes së kredisë, mund të shtyjnë në kohë dhe të ulin vlerën e një rikuperimi të dëshiruar të depozitave të sektorit bankar. Për këtë arsye, nevojitet që situata e likuiditetit të bankave të ndiqet me vëmendje, në vazhdimësi.

Grafik 71. Vëllimi total i pranimeve të reja në euro kundrejt normave mesatare të interesit respektivisht për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe usd.

71.a. Pranimet e reja të depozitave dhe llogarive rrjedhëse në euro dhe normat sipas muajve (në milionë euro).

71.b. Pranimet e reja të depozitave dhe llogarive rrjedhëse në usd sipas muajve dhe normat (në milionë usd).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.3.4 SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE DHE CILËSIA

Shpërndarja e investimeve në sistemin bankar pasqyron ecurinë e zërave përbërës të aktivit në periudha të ndryshme, për të parë në këtë mënyrë orientimin e investimeve nga bankat dhe nivelin e rrezikut që ka sipërmarrë sektori bankar gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Grafik 72. Shpërndarja e kontributit të zërave të aktivit në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 73. Ecuria e zërave të aktivit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vazhdim jepet shpërndarja e kontributit të zërave të aktivit në harkun kohor prej 3 vitesh[42], duke filluar nga muaji mars 2006.

Nga grafikun 72 vërehet se kontributi i zërave përbërës të aktivit deri në tremujorin e tretë të vitit 2008, ka një ecuri normale, pothuaj shumë pranë vlerave të mesatares historike. Kontributin më të madh në rritjen e aktiveve e ka dhënë zëri "veprime me klientë- bruto", që përfaqëson veprimtarinë e kredidhënies. Kështu në tremujorin e tretë vitit 2008, ky zë përfitoi 74.5 për qind të rritjes së aktiveve, shumë pranë mesatares prej 73.5 për qind të llogaritur duke filluar nga muaji mars 2006. Zëri "veprime me letra me vlerë" për të njëjtën periudhë përfitoi 22.4 për qind të rritjes së aktiveve, më pak se mesatarja historike prej 30.4 për qind. Nga zërat e aktivit, më pak kanë përfituar zërat "mjete të tjera" dhe "mjete të qëndrueshme", përkatësisht 1.9 dhe 2.6 për qind. Mesatarja historike e përfitimit të këtyre zërave llogaritet përkatësisht në nivelet 1.1 dhe 1.3 për qind. Ulja e "veprimeve me thesarin dhe ndërbankare" si edhe rritja e vlerës së "fondeve rezervë", kanë dhënë një kontribut negativ në rritjen e aktiveve.

Nga grafiku 72, vërehet se në tremujorin e fundit të vitit 2008, zërat e aktivit janë luhatur nga prirjet normale të tyre si pasojë e zhvillimeve financiare ndërkombëtare, duke kontribuar në rënie të nivelit të aktiveve të sistemit bankar. Për të kuptuar më mirë ecurinë e zërave të aktiveve në tremujorin e fundit të vitit 2008, grafiku 73 paraqet gjendjet "stok" të tyre:

Nga grafikët e mësipërm vihet re se prirja afatgjatë rritëse e aktiveve të sektorit bankar është "thyer" përkohësisht në tremujorin e fundit të vitit 2008, periudhë në të cilën aktivet ranë me 2.7 për qind. Zëri "veprime me letrat me vlerë" ka ruajtur ecurinë në kohë. Zëri "veprime me klientë-bruto", që përfaqëson kreditimin, ka qenë i qëndrueshëm por shënon rënie të ritmit rritës në tremujorin e fundit të vitit. Sektori bankar ka zvogëluar zërin "veprime me thesarin dhe ndërbankare" në masën 16.6 për qind krahasuar me një

tremujor më parë. Ndikimin kryesor në këtë rënie e ka dhënë zëri "depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare", i cili ka rënë në masën 49 për qind krahasuar me një tremujor më parë dhe 38 për qind referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Paralelisht, bankat kanë zvogëluar portofolin e bonove të thesarit në masën 9.4 për qind krahasuar me një tremujor më parë dhe 15.8 për qind referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kërkesat më të larta për likuiditet kanë shtyrë bankat të tërhiqnin vendosjet e tyre në bankat mëmë për të financuar nevojat e brendshme. Gjithashtu, në këtë periudhë bankat kanë filluar të rrisin me ritme më të shpejta fondet rezervë për humbjet e mundshme që mund të vinin nga kreditimi. Kjo vihet re dhe nga grafiku 73 ku në tremujorin e fundit të vitit 2008, zëri "fonde rezervë të krijuara" u rrit me 46.6 për qind krahasuar me një tremujor më parë.

Grafik 74. Ecuria e aktiveve me rrezik të sektorit bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 75. Aktivet me rrezik ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për të vlerësuar në mënyrë më të plotë nivelin e rrezikut të investimeve të zërave të aktivit, analizojmë ecurinë e aktiveve me rrezik të sektorit bankar. Kjo ecuri jepet në grafikun 74:

Ecuria e aktiveve me rrezik të sektorit bankar, vijon të paraqesë një prirje rritëse, ndonëse me një ritëm më të ulët gjatë vitit 2008. Në fund të vitit 2008 ato përbënin rreth 40.8 për qind të totalit të aktiveve nga 38.9 për qind një tremujor më parë dhe 41 për qind referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo rritje në bazë tremujore, u shkaktua kryesisht si rezultat i rënies së nivelit të aktiveve me rrezik më të ulët[43]. Ecuria e aktiveve me rrezik përcaktohet kryesisht nga ecuria e portofolit të kredisë[44], i cili në dhjetor të vitit 2008 zinte 47.6 për qind të totalit të aktiveve, krahasuar me 44 për qind një tremujor më parë dhe 39.4 për qind një vit më parë. Përsa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit (grafik 75), raporti i "aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve" ka shënuar rritje veçanërisht për bankat e Grupit 1 dhe të Grupit 3, pasi edhe portofoli i kredive për bankat e këtyre dy grupeve është zgjeruar me ritme më të shpejta (për bankat e Grupit 1: nga 36.5 për qind e totalit të aktiveve në dhjetor 2007, në 47 për qind të aktiveve në dhjetor 2008; për bankat e Grupit 3 është rritur nga 33 për qind, në 43 për qind të totalit të aktiveve për të njëjtën periudhë).

Krahas mënyrës së shpërndarjes të financimeve në drejtime të ndryshme të veprimtarisë, i është kushtuar vëmendje e veçantë karakteristikave të portofolit të kredisë. Për këtë qëllim, në vazhdim analizohen në mënyrë më të detajuar ritmi i rritjes së kredisë dhe përdorimi i saj, përbërja e portofolit të kredisë sipas

natyrës së huamarrësit; sipas përdorimit; sipas valutave; sipas kohëzgjatjes; sipas shpërndarjes sektoriale; ecuria e kredisë me probleme si dhe mbulimi me kolateral.

Në tremujorin e fundit të vitit 2008, sektori bankar dha kredi të re në masën 70.3 miliardë lekë, nga 68.1 miliardë lekë që u dha një tremujor më parë dhe 77 miliardë lekë referuar të njëjtës periudhë, një vit më parë. Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 51.7 miliardë lekë, nga 39.4 miliardë lekë që u mblodhën një tremujor më parë dhe 44 miliardë referuar periudhës së një viti më parë. Si rezultat, stoku i portofolit të kredisë u rrit në 396.7 miliardë lekë, 5 për qind më shumë se një tremujor më parë dhe 35.6 për qind më shumë se një vit më parë.

Raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë, përfaqëson treguesin e përdorimit të kredisë. Për fundin e muajit dhjetor 2008, ky raport ishte 73.6 për qind nga 57.8 për qind në shtator 2008 dhe 57.4 për qind, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë (grafik 76). Në muajin mars 2009, ky tregues ka zbritur në nivelin 64 për qind. Mesatarja e këtij treguesi që prej muajit mars 2006 është 60 për qind. Rritja e treguesit gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008, i atribuohet përpjekjeve më të mëdha të bankave për të mbledhur kreditë në kushtet e nevojave të tyre për likuiditet. Ecuria e tij në fund të tremujorit të parë të vitit 2009, kushtëzohet nga rënia e vlerës së kredisë së re.

Grafik 76. Kredia e re (djathtas) dhe përdorimi i kredisë (majtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun 77, paraqitet niveli i kredisë së re në çdo tremujor sipas viteve, në raport me vlerën e tij në tremujorin e parë të vitit 2005.

Ajo që evidentohet qartë në grafik është qëndrueshmëria e dhënies së kredisë së re gjatë vitit 2008 dhe rënia e saj në tremujorin e fundit të vitit, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007. Gjithashtu, nga grafiku konstatohet rënia e ritmit të kredisë së re në tremujorin e parë të vitit 2009.

Grafik 77. Kredia e re sipas tremujorëve në vite (mars 2005 = 1).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve të përdoruesve, gjatë vitit 2008, sektori i biznesit përfitoi rreth 80 për qind të kredisë së re ose rreth 208 miliardë lekë, me një rritje 34 miliardë lekë ose 19.6 për qind krahasuar me një vit më parë. Ndryshe nga sektori i biznesit, për individët kredia e re e dhënë gjatë vitit 2008 rezultoi 69 miliardë lekë, rreth 3.6 miliardë lekë ose 4.9 për qind më pak se një vit më parë.

Shpërndarja e kredisë së re sipas mënyrës së përdorimit për sektorin e biznesit, jepet në grafikun

Grafik 78. Shpërndarja e kredisë së re të bizneseve sipas qëllimit të përdorimit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 79. Shpërndarja e kredisë së re për individët sipas qëllimit të përdorimit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

78. Vihet re që kredia e re për investime në pasuri të paluajtshme, paraqet peshë të lartë prej rreth 23 për qind në tremujorin e dytë të vitit dhe një rënie të theksuar të peshës në tremujorin e katërt të vitit, në nivelin 10 për qind.

Shpërndarja e kredisë së re sipas mënyrës së përdorimit për individët/familjet, jepet në grafikun 79. Gjatë vitit 2008, vihet re që kredia e re dhënë individëve është kryesisht e përqendruar në kategorinë "investime në pasuri të paluajtshme". Pesha më e lartë për këtë kategori shfaqet në tremujorin e tretë të vitit, me rreth 58 për qind. Në tremujorin e fundit të vitit vihet re një zhvendosje drejt formës "overdraft", ku pesha e kësaj të fundit ka arritur në nivelin 25 për qind. Në të njëjtën kohë, pesha e kategorisë "investime për pasuri në paluajtshme" bie në nivelin 43 për qind.

Në lidhje me përbërjen sipas monedhave, bie në sy rritja e kredisë së re të dhënë në lekë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008. Në këtë periudhë, u dhanë kredi në lekë rreth 26.2 miliardë lekë (për biznese dhe individë), duke përbërë rreth 37.2 për qind të totalit të kredisë së re për tremujorin. Për kredinë e re të dhënë në valutë, kredia në euro (për biznes dhe individë) ishte rreth 35 miliardë lekë ose rreth 50 për qind e kredisë së re, krahasuar me rreth 48 miliardë lekë ose 62 për qind, në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kredia e re e dhënë në dollarë amerikanë zuri një peshë më të vogël me rreth 12.6 për qind të totalit të kredisë së re. Kredia e dhënë në monedha të tjera, ishte vetëm 0.5 për qind e kredisë së re të dhënë nga sektori bankar.

Në mënyrë më të detajuar, për sektorin e biznesit dhe për individët, përbërja e kredisë së re gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008 sipas përdorimit dhe valutës, jepet në tabelën 17, më poshtë:

Tabelë 17. Të dhënat e kredisë së re, për tremujorin e katërt të vitit 2008.

Biznesi (000 lek)	53,491,011	%	Individët (000 lekë)	17,120,000	%
lekë	17,039,444	31.85	lekë	9,123,908	53.29
overdraft	8,025,898	47.10	overdraft	1,843,467	20.20
kapital qarkullues	6,060,468	35.57	konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	690,787	7.57
investime në blerje pajisjesh	1,761,154	10.34	konsum i mallrave të qëndrueshëm	2,056,981	22.54
investime për pasuri të paluajtshme	1,191,923	7.00	për pasuri të paluajtshme	3,219,785	35.29
usd	7,964,507	14.89	për ushtrim aktiviteti	1,312,888	14.39
overdraft	5,072,230	63.69	usd	900,865	5.26
kapital qarkullues	1,958,309	24.59	overdraft	709,323	78.74
investime në blerje pajisjesh	885,156	11.11	konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	46,917	5.21
investime për pasuri të paluajtshme	48,812	0.61	konsum i mallrave të qëndrueshëm	27,434	3.05

euro	28,468,642	53.22	për pasuri të paluajtshme	112,906	12.53
overdraft	14,536,432	51.06	për ushtrim aktiviteti	4,286	0.48
kapital qarkullues	5,307,187	18.64	euro	6,467,310	37.78
investime në blerje pajisjesh	4,624,189	16.24	overdraft	1,624,140	25.11
investime për pasuri të paluajtshme	4,000,836	14.05	konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	360,564	5.58
monedha të tjera	18,418	0.03	konsum i mallrave të qëndrueshëm	475,433	7.35
			për pasuri të paluajtshme	3,691,524	57.08
			për ushtrim aktiviteti	315,651	4.88
			monedha të tjera	335,716	1.96

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas afatit të përdorimit, gjatë vitit 2008, kredia e re afatshkurtër rezultoi 150.4 miliardë lekë, rreth 30.6 miliardë lekë ose 25.5 për qind më shumë se një vit më parë. Për të njëjtën periudhë, kredia afatgjatë rezultoi 75.2 miliardë lekë, rreth 1 miliard lekë ose 1.4 për qind më shumë se një vit më parë. Kredia afatmesme rezultoi 51.2 miliardë lekë, duke shënuar një rënie prej 1.2 miliardë lekësh ose 2.4 për qind, krahasuar me një vit më parë. Sipas tremujorëve, kredia afatshkurtër ka shënuar peshën më të madhe në tremujorin e fundit të vitit me rreth 60 për qind, ndërsa ajo afatgjatë në tremujorin e tretë të vitit me rreth 34 për qind.

Në lidhje me shpërndarjen e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë për vitin 2008, 26.3 për qind e saj ka shkuar në mbështetje të sektorit të tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë; rreth 12.3 për qind e kredisë së re është drejtuar në sektorin e ndërtimit; rreth 9.7 për qind e kredisë së re është drejtuar në sektorin e transportit, magazinimit dhe telekomunikacionit; dhe rreth 9.2 për qind është orientuar drejt sektorit të industrisë (nga 11.1 për qind në vitin 2007). Sipas tremujorëve, vërehet një rritje e konsiderueshme e peshës së kredisë së re drejtuar sektorit të tregtisë në tremujorin e katërt të vitit 2008, në nivelin 35 për qind të kredisë së re për periudhën; një rënie e peshës së kredisë së re drejtuar sektorit të industrisë në tremujorin e tretë të vitit në nivelin 7.8 për qind, si edhe një rritje e theksuar e peshës së kredisë së re drejtuar sektorit të transportit, magazinimit dhe telekomunikacionit në nivelin 26 për qind në tremujorin e parë të vitit. Në përgjithësi, kjo sjellje mund të përcaktohet më shumë prej karakteristikave të zhvillimit në secilin sektor, duke përfshirë ciklet e ndryshme të investimeve, të shitjeve, të sezonalitetit, të import-eksportit etj..

Në lidhje me zhvillimet e vlerës "stok" të portofolit të kredisë, në fund të vitit 2008, teprica e kredisë së sektorit bankar rezultoi 396.7 miliardë lekë, duke përfaqësuar 37 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së)[45]. Rreth 254 miliardë lekë rezultojnë si kredi e përftuar nga sektori i biznesit, duke shënuar një rritje me 69.6 miliardë lekë ose 38 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe 13.6 miliardë lekë ose 6 për qind me tremujorin e tretë të vitit. Pjesa e portofolit e përfituar nga individët/familjet, vlerësohet në rreth 134.3 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 31.3 miliardë lekësh ose 30.3 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit, kredia e dhënë për individët u rrit me 4.9 miliardë lekë ose 3.8 për qind. Pjesa e portofolit të kredisë që është investuar në pasuritë e paluajtshme është rreth 149.8 miliardë lekë.

Grafik 80. Shpërndarja e kredisë, dhjetor 2008.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 81. Pesha e tepricës së kredisë së bizneseve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të bizneseve në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga kredia për sektorin e biznesit në fund të vitit 2008, rreth 75.6 miliardë lekë (ose 29.7 për qind) janë marrë në formën "overdraft"; rreth 48.7 miliardë (ose 19.2 për qind) janë marrë si kredi për kapital qarkullues; rreth 68.3 miliardë lekë (ose 27 për qind) përfaqësojnë investime në blerje makinerish dhe pajisjesh dhe rreth 61.2 miliardë lekë (ose 24 për qind) përfaqësojnë investime në pasuri të paluajtshme.

Në një periudhë kohore prej tre vjetësh, teprica e kredisë së dhënë bizneseve, shfaq një zhvendosje graduale drejt kredisë në formën "overdraft" dhe "investime për pasuri të paluajtshme"; një qëndrueshmëri të kredisë në formën e "kapitalit qarkullues" dhe një rënie të dukshme të kredisë në formën e "investimeve në blerje pajisjesh".

Nga kredia për individët/familjet, rreth 7.5 miliardë lekë (ose 5.6 për qind) janë marrë kredi "overdraft"; rreth 3.8 miliardë lekë (ose 2.9 për qind) janë marrë kredi për mallra konsumi; rreth 22.3 miliardë lekë (ose 16.6 për qind) janë marrë kredi për blerje mallrash të qëndrueshëm; rreth 12 miliardë lekë (ose 8.9 për qind) janë marrë kredi për ushtrim aktiviteti dhe rreth 88.6 miliardë lekë (ose 66 për qind) janë kredi për blerje pasurish të paluajtshme.

Teprica e kredisë akorduar individëve në vite është përqendruar në formën e investimeve në pasuri të paluajtshme (tabelë 18).

Tabelë 18. Pesha e tepricës së kredisë së individëve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të individëve në përqindje.

	T IV-06	T I-07	T II-07	T III-07	T IV-07	T I-08	T II-08	T III-08	T IV-08
Overdraft	4.7	4.84	4.86	5.06	4.4	4.5	4.6	4.8	5.6
Kapital qarkullues	3.08	2.1	2.3	2.4	2.04	2.1	2.03	3.4	2.9
Investime blerje pajisjesh	19.5	17.7	19	19.1	19	17.3	17	16.4	16.6
Investime pasuri paluajtshme	59.3	62	61.1	62.4	63.9	65.7	66.2	65.7	65.9
Ushtrim aktiviteti	13.4	13.3	12.6	11.1	10.6	10.4	10.1	9.6	8.9

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2008, kredia që ka shkuar për konsum të pastër, e identifikuar si kredi e dhënë për individët në formë "overdraft", për konsum të mallrave jo të qëndrueshëm dhe të mallrave të qëndrueshëm, vlerësohet 33.7 miliardë lekë ose rreth 8.7 për qind e totalit të portofolit të kredisë, 25.1 për qind e portofolit të kredisë së dhënë për individët dhe rreth 3.1 për qind e PBB-së. Kredia e përdorur për qëllime investimi (blerje pajisjesh dhe makinerish dhe

për ushtrim aktiviteti) vlerësohet rreth 80.3 miliardë lekë ose 20.7 për qind e totalit të portofolit të kredisë dhe 7.5 për qind e PBB-së. Kredia e përdorur për investime në pasuritë e paluajtshme (për biznese dhe individë) vlerësohet 149.8 miliardë lekë ose 13.9 për qind e PBB-së. Përbërja e portofolit të kredisë sipas përdorimit jepet në grafikun 82:

Grafik 82. Shpërndarja e kredisë (në % ndaj totalit) në dhjetor 08.



- Huamarrje pa përfshirjen e huave të pasurive të paluajtshme nga biznes
- Hua për pasuritë e paluajtshme nga biznesi
- Hua për pasuritë e paluajtshme nga individët
- Hua investimi (individë dhe biznes)
- Huamarrje për konsum

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, veprimtaria krediduese e sektorit bankar është përqendruar kryesisht në qarkun e Tiranës, të Durrësit, të Elbasanit, të Shkodrës, të Fierit dhe të Vlorës. Në tremujorin e katërt të vitit 2008, pesha e kredisë për këto rrethe ndaj totalit të kredisë, llogaritej 88.3 për qind. Aktiviteti kreditues përqendrimin më të madh e ka në Tiranë, ku kredia e dhënë rezulton rreth 264 miliardë lekë ose rreth 68 për qind, pothuaj e pandryshuar prej një viti më parë (tabelë 19).

Tabelë 19. Pesha e kredisë sipas qarqeve kryesore të vendit në përqindje.

	T IV-06	T IV-07	T III-08	T IV-08
Tiranë	67.5	67.2	67.7	67.9
Durrës	7.6	7.6	7.5	7.4
Elbasan	3.2	3.4	3.2	3.2
Shkodër	2.5	2.5	2.6	2.6
Fier	3.8	3.8	3.4	3.4
Vlorë	4.0	3.8	3.7	3.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e kredisë sipas afateve të maturimit, për qarqet kryesore ku është dhënë kredia, rezulton sipas grafikëve 83, 84, 85. Vihet re që kredia afatgjatë e ka peshën më të madhe në kredinë e dhënë në qarkun e Shkodrës me rreth 52.3 për qind. Ndërsa kredia afatshkurtër e ka peshën më të madhe në kredinë e dhënë në qarkun e Fierit, me rreth 36 për qind.

Grafik 83. Pesha e kredisë afatshkurtër sipas rretheve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 84. Pesha e kredisë afatmesme sipas rretheve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 85. Pesha e kredisë afatgjatë sipas rretheve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 86. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë për rrethet kryesore të vendit në përqindje (TIV-2008).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 87. Ecuria e treguesit kredi me probleme ndaj totalit të kredisë për sistemin.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në Tiranë, në shpërndarjen e kredisë mbizotëron kredia afatgjatë, me rreth 45.5 për qind të kredisë së dhënë.

Në lidhje me përbërjen sipas monedhave, kredia në lekë shfaq peshën më të madhe në qarkun e Elbasanit me rreth 46.5 për qind të kredisë së dhënë. Ndërsa kredia në valutë e ka peshën më të madhe në qarkun e Tiranës, me rreth 79 për qind të kredisë së dhënë.

Në lidhje me përbërjen sipas grupeve të përdorimit, qarku i Tiranës shfaq peshën më të lartë të kredisë së dhënë bizneseve, në masën 70 për qind në tremujorin e fundit të vitit 2008. Qarku i Shkodrës shfaq peshën më të lartë të kredisë së dhënë individëve, me rreth 49 për qind. Pesha e kredisë konsumatore, e llogaritur si raport i tepricës së kredisë konsumatore ndaj totalit të tepricës së kredisë së dhënë individëve për secilin nga qarqet, për tremujorin e katërt të vitit 2008, llogaritet rreth 42 për qind.

Në lidhje me përdorimin e kredisë sipas sektorëve, për tremujorin e katërt të vitit, kredia e dhënë për sektorin e tregtisë është më e lartë në qarkun e Fierit, me rreth 38 për qind, dhe atë të Tiranës me rreth 20.5 për qind. Sektori i industrisë paraqet peshën më të madhe në qarkun e Elbasanit, me rreth 18 për qind të totalit të kredisë së dhënë në këtë qark.

5.3.4.1 Cilësia e kredisë

Në vitin 2008, cilësia e kredisë shënoi rënie. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, mbi baza bruto, në fund të vitit 2008 u ngjit në nivelin 6.6 për qind, kundrejt 4.1 për qind në tremujorin e tretë të vitit dhe 3.4 për qind në fund të vitit 2007 (grafik 87). Vetëm gjatë tremujorit të katërt të vitit, kreditë me probleme të sektorit bankar u rritën me rreth 10.7 miliardë lekë ose 69 për qind krahasuar me një tremujor më parë. Ndërkohë që teprica e kredisë në të njëjtën periudhë u rrit me rreth 5.1 për qind. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2007, kreditë me probleme u rritën me rreth 16.5 miliardë lekë ose me 168 për qind, ndërkohë që teprica e kredisë u rrit me rreth 36 për qind.

Sipas kategorive të klasifikimit, vërehet që në fund të vitit 2008, 78.3 për qind e portofolit të kredisë konsiderohej "standard", pra që shlyhet rregullisht, dhe vetëm 1.3 për qind e portofolit konsiderohej si "kredi e humbur", për të cilën bankat kanë filluar procedurat e rikuperimit nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit. Pjesa tjetër e kredive, e klasifikuar në tre kategori, përfshin kredi në të cilat kredimarrësi shfaq vonesa në kohë për pagesën ose probleme të tjera, por sidoqoftë ai paguan brenda një kufiri kohor të përcaktuar nga banka.

Përsa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, për tremujorin e katërt të vitit 2008, bankat e përfshira në Grupin 3 kanë shënuar rritjen më të madhe të treguesit "hua me probleme bruto ndaj totalit të huave", duke arritur në 6.4 për qind nga 3.2 për qind që llogaritej një tremujor më parë. Nivelin më të lartë të raportit të mësipërm e kanë arritur bankat e Grupit 2 me rreth 7.7 për qind, nga 6.3 për qind një tremujor më parë. Për bankat e Grupit 1, ky raport llogaritet në 3.5 për qind me një luhatje gati të papërfillshme nga një tremujor më parë (grafik 88).

Grafik 88. Ecuria e cilësisë së kredisë (bruto) për grupet sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një pamje më të qartë të ecurisë së portofolit të kredisë mund ta japë krahasimi i tepricës së kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, i zhveshur nga efekti i kredive të reja, të cilat rrisin emëruesin e raportit por problemet i shfaqin në një kohë të mëvonshme. Për tremujorin e katërt të vitit 2008, ky raport është rritur në nivelin 8.1 për qind. Ecuria e këtij raporti, përforcon prirjen rënëse që ka shfaqur cilësia e portofolit të kredisë së sektorit bankar.

Sipas grupeve të përdoruesve, cilësia e kredisë ka rënë si për bizneset ashtu edhe për individët. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë, përkatësisht për individët dhe bizneset, llogaritet në nivelet 5.5 për qind dhe 7.6 për qind, krahasuar me 3 për qind dhe 3.6 për qind në fundin e vitit 2007.

Sipas monedhës, në tremujorin e katërt të vitit 2008, raporti i kredive me probleme në lekë ndaj tepricës së kredisë në lekë dhe ai i kredive me probleme në valutë ndaj tepricës së kredisë në valutë, rezultojnë përkatësisht në nivelet 7.5 për qind dhe 6.3 për qind, nga 3.9 për qind dhe 3.2 për qind në fund të vitit 2007. Gjatë tremujorëve të vitit 2008, vihet re një rënie e qëndrueshme e portofolit të kredisë në lekë, ku raporti arrin vlerën më të lartë kryesisht në tremujorin e fundit të vitit.

Treguesit që masin cilësinë e portofolit të kredive në valutë, ku kredimarrësi është i mbuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit[46] ose i pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit[47], ishin përkatësisht 6.3 për qind dhe 5.9 për qind, kundrejt 3.2 për qind dhe 3.4 për qind në fund të vitit 2007.

Grafik 89. Cilësia e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 90. Hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner për sistemin bankar në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas sektorëve të ekonomisë, në tremujorin e katërt të vitit 2008, sektori i tregtisë shfaq peshën më të lartë të kredive me probleme me rreth 32 për qind të totalit të kredive me probleme, i ndjekur nga sektori i ndërtimit me rreth 16.4 për qind dhe sektori i industrisë me rreth 11 për qind. Në fakt, këta sektorë përfitojnë pjesën më të madhe të kredisë së sektorit bankar. Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë gjithsej, të dhënë për secilin prej sektorëve të mësipërm, ishte 9.7 për qind për sektorin e tregtisë, 7.6 për qind për sektorin e ndërtimit dhe 6.7 për qind për sektorin e industrisë (grafik 89).

Është e rëndësishme të vlerësohet aftësia e sektorit bankar për të përballuar humbjet e mundshme të portofolit të kredisë nëpërmjet kapitalit të tij. Edhe në këtë rast vërehet që në fund të vitit 2008, raportet e kredive me probleme neto ndaj elementeve të kapitalit, kanë shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke nënkuptuar një rritje të sasisë së kapitalit që nevojitet për të përballuar kredinë me probleme. Konkretisht, në fund të vitit 2008, raporti "kredi me probleme neto ndaj kapitalit bazë", u ngjit në nivelin 22.9 për qind, rreth 12.2 pikë përqindjeje më i lartë se një vit më parë. Raporti "kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator" dhe "kredi me probleme neto ndaj kapitalit aksioner" ishin përkatësisht 21.7 për qind dhe 21.1 për qind, duke u rritur përkatësisht me 11.7 pikë përqindje dhe 11.9 pikë përqindje, në krahasim me një vit më parë (grafik 90). Ecuria e këtyre raporteve, tregon që aftësia e sektorit bankar për të mbuluar me kapital humbjet e mundshme nga veprimtaria e kreditimit, ka rënë gjatë vitit 2008. Megjithatë, vlerësimet e ndryshme dhe analizat "*stress-test*" tregojnë që kapitali i sektorit bankar mbetet i mjaftueshëm[48] për të përballuar humbje të mundshme më të mëdha.

Sipas grupeve të bankave, në tremujorin e katërt të vitit, rritjen më të madhe në nivel mesatar për treguesit "kredi me probleme neto ndaj kapitalit" e shfaqin bankat e Grupit 3, ku treguesi llogaritet në nivelin 22.3 për qind, me një rritje prej rreth 15 pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë. Bankat e Grupit 2 shfaqin vlerën më të lartë të treguesit "kredi me probleme neto ndaj kapitalit bazë", në nivelin 33 për qind, rreth 7.3 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Bankat e Grupit 2 shfaqin edhe vlerën më të lartë për treguesin "kredi me probleme neto ndaj kapitalit aksioner", në nivelin 32 për qind, rreth 16 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Për bankat e Grupit 1, vlerat mesatare të treguesve të mësipërm, mbeten në nivele të ulëta.

5.3.4.2 Fondet rezervë për humbjet nga kreditë (provigjonet)

Në vijim të rënies së cilësisë së kredisë, sektori bankar ka rritur fondet e nevojshme rezervë (provigjonet), në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ. Në tremujorin e katërt të vitit, fondet e provigjonimit për sektorin bankar arritën në 11.3 miliardë lekë[49], rreth 47 për qind më shumë se një tremujor më parë dhe rreth 139.2 për qind më shumë se një vit më parë. Në fund të vitit 2008, raporti "provigjone për kreditë me probleme/huave me probleme" (raporti i mbulimit) ka zbritur në nivelin 43 për qind, si rezultat i rritjes së kredisë me probleme (69 për qind) me një ritëm më të lartë se ai i provigjoneve (47 për qind) në tremujorin e fundit të vitit.

Kredia me probleme ka vijuar të rritet edhe në tremujorin e parë të vitit 2009. Në fund të tremujorit të parë, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, u ngjit në nivelin 7.5 për qind. Pritjet janë që kjo prirje të vazhdojë dhe të kulmojë në pjesën e dytë të këtij viti. Sigurisht, që kjo prirje do të ndikojë në rezultatin financiar të sektorit bankar, si edhe në aftësinë e tij për të kredituar në vlera të qëndrueshme, në vitin aktual por edhe në atë të ardhshëm. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2009, raporti i mbulimit (provigjone ndaj kredive me probleme) u ngjit në nivelin 46.7 për qind. Nëse kjo prirje do të rezultojë e qëndrueshme, ajo tregon edhe për uljen e ritmit të rritjes së kredive me probleme.

Në procesin e kredidhënies, një rol të rëndësishëm luan kolaterali, si burimi i fundit i rikuperimit të vlerës së kredisë me probleme në një masë të pjesshme ose të plotë. Për fundin e vitit 2008, vlera e atyre kredive për të cilat ekziston kolaterali, kryesisht në formën e pasurive të paluajtshme, rezulton rreth 60 për qind e totalit të portofolit të kredisë, pothuajse në të njëjtin nivel si një vit më parë. Për sa i përket mbulimit me kolateral të portofolit të kredisë me probleme për fundin e vitit 2008, ai llogaritet rreth 69.3 për qind, krahasuar me rreth 76.5 për qind për të njëjtën periudhë një vit më parë. Në rastin e kredisë në valutë kur klienti nuk ka të ardhura në valutë, vlera e kolateralit mbulon rreth 61 për qind të vlerës së kredisë.

Grafik 91. Hua me probleme neto ndaj kapitalit aksioner për grupet sipas madhësisë së aktivitetit në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 92. Raporti i mbulimit të kredive me probleme me provigjone sipas tremujorëve në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 93. Mbulimi i kredisë me kolateral.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.4 ZËRAT JASHTË BILANCIT

Në fund të vitit 2008, totali i zërave jashtë bilancit përbënte 89 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar, në vlerën 743 miliardë lekë. Në fund të vitit 2007, ky tregues ishte në vlerën 54 për qind. Ky raport ka patur një rritje të ndjeshme duke filluar nga muaji gusht i vitit 2008, kur arriti në 79 për qind, në krahasim me 59 për qind në muajin qershor. Peshën kryesore në zërat jashtë bilancit, e përbëjnë "garancitë e marra" nga klientët.

"Angazhimet e marra", të cilat përfshijnë angazhimet e financimit si edhe garancitë e marra nga klientët dhe institucionet financiare, arritën vlerën 640 miliardë lekë dhe përbëjnë rreth 86 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit. Tek "angazhimet e marra", janë "garancitë e marra"[50] ato që zënë peshën kryesore: në muajin dhjetor 2008 këto arritën në 617 miliardë lekë ose 83 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit. Pesha e "garancive të marra" në totalin e zërave jashtë bilancit, është rritur kundrejt fundit të vitit 2007, me rreth 4 pikë përqindje.

"Angazhimet e dhëna", në shifrën 51 miliardë lekë, përbëjnë vetëm 6.9 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit. Tek "angazhimet e dhëna", peshën kryesore e zënë "garancitë e dhëna" kryesisht për klientët, me 3.6 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit dhe "angazhimet e financimit", kryesisht për klientët, me 3 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit. Në përgjithësi, pesha e "angazhimeve të dhëna" ka ndjekur një prirje rënëse gjatë vitit 2008. Në fund të vitit, kundrejt fundit të tremujorit të tretë, ato kanë rënë me 1.8 pikë përqindje; kundrejt fundit të tremujorit të dytë me rreth 5 pikë përqindje; kundrejt fundit të tremujorit të parë me rreth 5.7 pikë përqindje dhe kundrejt fundit të vitit 2007, me rreth 6.7 pikë përqindje.

Ndër zërat e tjerë jashtë bilancit, "transaksionet në valutë" përbëjnë 6.9 për qind të totalit të zërave jashtë bilancit, ndërsa "angazhimet e tjera" dhe "angazhimet për instrumentet financiare" kanë pesha të papërfillshme.

5.5 REZULTATI FINANCIAR DHE KAPITALI

5.5.1 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E PËRDORIMIT TË BURIMEVE

Edhe gjatë vitit 2008, sektori bankar pati një rezultat financiar neto pozitiv, por më të ulët se në vitin 2007. Sipas tremujorëve, konstatohet realizimi i një rezultati financiar negativ në tremujorin e fundit të vitit, kryesisht si rezultat i rritjes së fondeve rezervë për kreditë, rënies së afatit mesatar dhe të vëllimit të kredidhënies dhe uljes së investimeve me jorezidentët. Prirja e rënies së fitimit pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2009.

Në fund të vitit 2008, sektori bankar shënoi një rezultat financiar neto pozitiv në vlerën 7.3 miliardë lekë. Ky rezultat është 0.3 miliardë lekë ose 4

për qind më i ulët se ai i fundit të tremujorit të tretë të vitit dhe 2.6 miliardë lekë ose 26 për qind, më i ulët se rezultati financiar i regjistruar në fund të vitit 2007. Rezultati financiar i realizuar nga sistemi në tremujorin e katërt të vitit ishte negativ (humbje), në masën 333.4 milionë lekë.

Për të njëjtën periudhë, norma vjetore e kthimit mbi kapitalin (RoE)[51] shënoi vlerën 11.4 për qind. Ndërsa norma vjetore e kthimit nga aktivet (RoA) shënoi vlerën 0.9 për qind. Kthimi nga kapitali i sektorit bankar është 5 pikë përqindje më i ulët se në fund të tremujorit të tretë të vitit dhe 9.4 pikë përqindje më i ulët krahasuar me fundin e vitit 2007. Gjatë vitit 2008, ecuria e këtij treguesi ka qenë në rënie, duke përjashtuar muajt maj, qershor e korrik (grafik 94.a). Ndërkohë, treguesi i kthimit nga aktivet (RoA), është 0.4 pikë përqindje më i ulët se në fund të muajit shtator dhe 0.7 pikë përqindje më i ulët se në fund të vitit 2007. Ky tregues, ka shënuar rënie gjatë tremujorit të fundit të vitit (grafik 94.b).

Grafik 94. Kthimi nga kapitali dhe të ardhurat neto ndaj totalit të aktiveve për sektorin bankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 95. Kthimi nga kapitali dhe të ardhurat neto ndaj totalit të aktiveve për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e treguesve të kthimit nga kapitali dhe të të ardhurave neto ndaj totalit të aktiveve për grupet e bankave, paraqitet në grafikun 95.

Prej grafikut mund të konstatohet që ndikimin kryesor në rënien e të dy treguesve (RoE dhe RoA) e kanë sjellë bankat e Grupit 2, të cilat kanë shënuar një rënie të shpejtë të tij gjatë vitit 2008.

Rënia e këtyre treguesve është kushtëzuar nga ecuria e disa raporteve në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të sektorit bankar. Nga grafiku 96.a., vërehet që raporti "shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë" është rritur gjatë tremujorit të parë të vitit 2008, ka rënë sërish në prill duke mbajtur vlera të qëndrueshme deri në muajin shtator, dhe ka shënuar rritje gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008, duke arritur vlerën 81.4 për qind në fund të dhjetorit. Sipas grupeve të bankave (grafik 96.b.), rritja e treguesit të lartpërmendur për bankat e Grupit 3 gjatë tremujorit të fundit të vitit, përbën gjysmën e rritjes së regjistruar gjatë gjithë vitit 2008 për këtë grup.

Grafik 96. Shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë për sektorin bankar e grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e "shpenzimeve jo për interesa" të sektorit bankar është ndikuar nga rritja e provigjoneve me rreth 8 miliardë lekë gjatë vitit 2008. Gati gjysma e kësaj rritjeje të provigjoneve, u realizua në tremujorin e fundit të vitit. Nga ana tjetër, ritmi i realizimit të të ardhurave bruto të veprimtarisë, zbriti në 5.4 miliardë lekë në tremujorin e fundit të vitit, kundrejt mesatarisht 7.9 miliardë lekëve në tremujorët e mëparshëm të vitit 2008. Për këtë arsye, në fund të vitit 2008, raporti i "shpenzimeve për provigjone" ndaj "të ardhurave bruto të veprimtarisë" shënoi vlerën 29.3 për qind, duke regjistruar një rritje me rreth 10 pikë përqindje dhe 17 pikë përqindje, përkatësisht kundrejt fundit të tremujorit të tretë dhe fundit të një viti më parë.

Për të vlerësuar kontributin që jep veprimtaria bazë e ndërmjetësimit në të ardhurat e përgjithshme të sektorit bankar, analizohet raporti "të ardhura neto nga interesat/të ardhurat bruto të veprimtarisë". Në fund të dhjetorit 2008, ky

raport shënoi vlerën 106.5 për qind, 9 pikë përqindje më i lartë se në fund të tremujorit të tretë dhe 14 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë (grafik 97.a). Në rast se analizohen pjesët përbërëse të këtij raporti, vërehet që gjatë tremujorit të fundit të vitit 2008, ritmi i rritjes së të ardhurave nga interesi ishte më i lartë se ai i rritjes së të ardhurave bruto të veprimtarisë. Krahasuar me fundin e vitit 2007, të ardhurat neto nga interesi për sektorin bankar shfaqin një rritje prej 12.3 për qind, kundrejt një rënieje prej 0.4 për qind të të ardhurave bruto të veprimtarisë. Rënia e të ardhurave bruto të veprimtarisë është kushtëzuar nga rritja e shpenzimeve të veprimtarisë, veçanërisht të atyre për provigjone.

Ky raport ka ardhur në rritje edhe për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit (grafik 97.b), ku në tremujorin e fundit të vitit rritjen më të madhe e kanë shfaqur bankat e Grupit 3, me rreth 10.7 pikë përqindje kundrejt tremujorit të mëparshëm. Rritjen më të madhe krahasuar me fundin e vitit të kaluar e shfaqin bankat e Grupit 2, me rreth 24 pikë përqindje.

Grafik 97. Të ardhurat neto nga interesat ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë për sektorin bankar e grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.5.2 TREGUESIT E KAPITALIT

Në fund të vitit 2008, megjithë dukuritë e vërejtura si pasojë e krizës financiare ndërkombëtare, sektori bankar vijoi të jetë i mirëkapitalizuar. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, i vlerësuar sipas raportit të kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me koeficientët përkatës të rrezikut, shënoi vlerën 17.2 për qind[52], duke rënë me 0.3 pikë përqindje krahasuar me fundin e tremujorit të tretë të vitit dhe duke u rritur me 0.2 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007 (grafik 98.a.). Sipas elementeve përbërëse të këtij treguesi, vërehet që në fund të vitit 2008, kapitali rregullator i sektorit bankar u ngjit në 58.6 miliardë lekë. Ky tregues shfaq një pirje rritëse që nga fundi i vitit 2007, me rreth 27 për qind. Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun u ngjit në 340.2 miliardë lekë, duke qenë 25.7 për qind më i lartë se në fund të vitit 2007.

Sipas grupeve të bankave, në fund të vitit 2008, bankat e Grupit 1 patën një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit prej rreth 31 për qind. Bankat e Grupit 2 rreth 15 për qind dhe ato të Grupit 3 rreth 17 për qind. Për bankat e Grupit 1, ky tregues ndjek një prirje të qartë rënëse që prej muajit shtator 2006, ndërsa për bankat Grupit 2 dhe Grupit 3, treguesi shfaq qëndrueshmëri gjatë viteve të fundit (grafik 98.b).

Grafik 98. Normat e mjaftueshmërisë së kapitalit (madhësia e kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kur krahasohet me aktivet e ponderuara me koeficientët përkatës të rrezikut, kapitali bazë imiton ecurinë e kapitalit rregullator (grafik 99.a). Në fund të vitit 2008, ky raport shënoi vlerën 16.3 për qind për të gjithë sektorin bankar. Sipas grupeve të bankave (grafik 99.b), ky raport ishte rreth 29 për qind për bankat e Grupit 1, rreth 12 për qind për bankat e Grupit 2 dhe rreth 17 për qind për bankat e Grupit 3.

Grafik 99. Raporti i kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të dhjetorit 2008, kapitali aksioner zinte 8.6 për qind të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Ky tregues shfaq një rritje me 0.6 pikë përqindje, krahasuar me fundin e tremujorit të tretë të vitit 2008 dhe një rritje me 0.9 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2007. Treguesi paraqet një prirje rritëse në vite edhe pse ritmi i rritjes ka filluar të zvogëlohet (grafik 100.a).

Sipas grupeve të bankave, në fund të vitit 2008, raporti "kapital aksioner ndaj totalit të aktiveve" është rreth 21 për qind për bankat e Grupit 1, rreth 7.7 për qind për bankat e Grupit 2 dhe rreth 8.2 për qind për bankat e Grupit 3 (grafik 100.b). Për bankat e Grupit 3, ky tregues ka shënuar një rritje të lehtë por të qëndrueshme në afat të mesëm, ndërsa për bankat e Grupit 1, ky raport ka shënuar rënie të vazhdueshme që prej muajit shtator 2006. Për bankat e Grupit 2 treguesi ka qenë i qëndrueshëm.

Grafik 100. Treguesi i levës financiare.

100.a. Raporti i levës financiare për sektorin bankar.



100.b. Raporti i levës financiare për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.6 TREGUESIT E LIKUIDITETIT

Megjithë tërheqjen e depozitave në tremujorin e fundit të vitit 2008, treguesit e likuiditetit nuk shfaqin rënie të rëndësishme, duke mbetur larg niveleve kritike. Gjatë kësaj periudhe, kërkesa më e lartë e sektorit bankar për fonde afatshkurtra në valutë dhe në lekë, është plotësuar nëpërmjet pakësimit të investimeve likuide, huave të përfituara nga grupet bankare zotëruese, si edhe likuiditetit të marrë hua nga Banka e Shqipërisë. Megjithatë, kërkesa më e lartë për fonde afatshkurtra ka kufizuar aftësinë e sektorit bankar për të kredituar ekonominë. Situata e likuiditetit në valutë, ka rritur varësinë prej qëndrueshmërisë së linjave të huaja të financimit.

Megjithë prirjen rënëse të viteve të fundit, pesha e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar vazhdon të tregojë vlera të mira. Në fund të vitit 2008, vlera e këtij treguesi ishte 42.8 për qind, kundrejt 44 për qind në fund të vitit 2007 (grafik 101.a). Për sa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit në fund të tremujorit të katërt të vitit 2008, evidentohet një rënie

e konsiderueshme e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve për Grupin 3, me 8.8 pikë përqindje referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë, duke arritur në 46.5 për qind nga 55.4 për qind. Në bazë tremujore, treguesi i likuiditetit për këtë grup ra me 3.3 pikë përqindje (grafik 101.b).

Grafik 101. Treguesi i likuiditetit të sistemit bankar dhe grupet e bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Raporti "aktive likuide me detyrimet afatshkurtra" për sektorin bankar shqiptar ka shfaqur rënie që nga fillimi i vitit. Kështu, që nga muaji janar 2008, ky tregues ka rënë me pothuaj 14 pikë përqindjeje. Për sa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, ky tregues ka rënë ndjeshëm kryesisht për bankat e Grupit 1 dhe të Grupit 3, krahasuar me periudhën e një viti më parë. Në këtë mënyrë, në fund të vitit 2008, raporti "aktive likuide me detyrimet afatshkurtra" për bankat e Grupit 1, zbriti në 63.6 për qind nga 79.9 për qind referuar të njëjtës periudhë një vit më parë, duke ndjekur një prirje rënëse gjatë gjithë vitit 2008. Ndërsa për bankat e Grupit 3, për të

Grafik 102. Raporti i aktiveve likuide me detyrimet afatshkurtra për sistemin bankar dhe grupet e bankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

njëjtën periudhë, ky raport ra në nivelin 69.3 për qind nga 83.3 për qind që ishte një vit më parë dhe 74.7 për qind referuar fundit të tremujorit të tretë të vitit (grafik 102).

Hapësirë Informuese 7. Analiza "Stress-Test".

Për të realizuar analizën "stress-test", supozohen lëvizje ekstreme dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje, në kursin e këmbimit, në normat e interesit, në cilësinë e kredisë etj.. Mbi bazën e këtyre lëvizjeve vlerësohet ndikimi i tyre në treguesit e kapitalit të sektorit bankar. Duhet patur në konsideratë që efekti i lëvizjeve ekstreme për treguesit e mësipërm, supozohet i menjëhershëm, në kushtet e pandryshueshmërisë së vlerave të kapitalit. Në praktikë, kjo është pothuaj e pamundur. Lëvizja e treguesve zakonisht ndodh përgjatë një segmenti të caktuar kohor që mund të jetë i shkurtër por jo i menjëhershëm dhe bankat kanë mundësi të rrisin kapitalin për t'i bërë ballë rreziqeve të ndryshme të ardhme. Për interpretimin e rezultateve të stress-test-it paraqiten dy nivele. Niveli i parë përfaqësohet nga koncepti i "ndjeshmërisë" dhe vlerëson nëse goditja shkakton lëvizje të ndjeshme mbi treguesin e kapitalizimit, por pa e zbritur atë nën nivelin minimal të lejuar. Niveli i dytë përfaqësohet nga koncepti i "rrezikut" dhe vlerëson nëse goditja shkakton uljen e normës së mjaftueshmërisë të kapitalit nën nivelin e lejuar prej 12 për qind.

Për treguesit e fundit të vitit 2008, analiza "stress-test" tregon që: a) sektori bankar në tërësi paraqet një rezistencë të mirë ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit, rrezikut të normës së interesit dhe rrezikut të tërthortë të kreditit nëpërmjet ndryshimit të normave të interesit; dhe b) kryesisht për bankat e Grupit 2, rreziku i tërthortë i kursit të këmbimit, veçanërisht për veprimtarinë me monedhën evropiane dhe rreziku i kreditit, përbëjnë rreziqet kryesore, të cilat, në një skenar të përkeqësuar qëllimisht, shkaktojnë rënie më të ndjeshme në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Gjithsesi, në nivel të përgjithshëm të sektorit bankar, ekspozimi ndaj këtyre rreziqeve është i kufizuar.

Një tabelë përmbledhëse e rezultateve të stress-test paraqitet më poshtë.

Tabelë 20. Rezultate të stress-test-it.

	Goditjet	Sektori bankar	Grupet sipas madhësisë së kapitalit		
			G1	G2	G3
Rreziku i kredisë	Rritja 100% e kredive me probleme	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
		Paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Paraqet ndjeshmëri	Paraqet ndjeshmëri

	Goditjet	Sektori bankar	Grupet sipas madhësisë së kapitalit		
			G1	G2	G3

Rreziku i drejtpërdrejtë i normës së interesit	1. Lek	Rritje e normës së interesit në lekë me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Paraqet ndjeshmëri
		Rritje e normës së interesit në lekë me 4-10%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Paraqet ndjeshmëri
	2. Usd	Rritje e normës së interesit në usd me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
		Rritje e normës së interesit në usd me 3 - 10%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
	3. Euro	Rritje e normës së interesit në euro me 3%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri

		Goditjet	Sektori bankar	Grupet sipas madhësisë së kapitalit		
				G1	G2	G3
Rreziku i drejtpërdrejtë i kursit të këmbimit	1. Usd	Nënçmim i usd ndaj lekut me 50%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
	2. Euro	Nënçmim i euros ndaj lekut me 50%	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri

Rreziku indirekt i normës së interesit	1. Lek	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në lekë	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
	2. Usd	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në usd	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
	3. Euro	Rritje me 5 % e normës së interesit të kredisë në euro	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
Rreziku indirekt i kursit të këmbimit	1. Usd	Nënçmimi i lekut ndaj usd me 50%.	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri
	2. Euro	Nënçmimi i lekut ndaj euros me 50%.	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik	Nuk paraqet rrezik
			Nuk paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri	Paraqet ndjeshmëri	Nuk paraqet ndjeshmëri

RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT.

Aplikimi i stress-test-it mbi rrezikun e kursit të këmbimit vlerëson efektin që sjell mbiçmimi/nënçmimi i monedhës vendase ndaj dy monedhave të huaja kryesore (usd, euro) mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kapitalin rregullator.

Për këtë lloj rreziku, në përgjithësi lëvizjet normale të kursit të këmbimit kanë një efekt jo të rëndësishëm në treguesit e kapitalit të sektorit bankar, në kushtet kur pozicioni i hapur valutor i sektorit bankar kufizohet me rregullore dhe vetë bankat, në praktikë, preferojnë të kenë një pozicion pothuaj të mbyllur. Në rastin e mbiçmimit të valutës kundrejt lekut, efekti në treguesit e kapitalit është jo i rëndësishëm, në kushtet kur një pjesë e konsiderueshme e kapitalit është në valutë dhe të gjithë treguesit që analizohen shprehen në lekë. Efektin më domethënës në treguesit e kapitalit, e jep nënçmimi i valutave kryesore kundrejt lekut në një shkallë të madhe, i cili jepet më poshtë.

Një nënçmim i supozuar i monedhës amerikane kundrejt asaj vendase me 50 për qind, ul normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit me 0.1 pikë përqindje, duke e zbritur në 17.1 për qind. Për pjesën më të madhe të bankave, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit pëson luhatje të papërfillshme. Në nivel grupesh sipas

madhësisë së aktivitetit, vihet re rënia e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit kryesisht për bankat e Grupit 3 me 0.2 pikë përqindje, në 16.4 për qind. Ndërkohë që grupet e tjera pësojnë luhatje të lehta duke paraqitur ndjeshmëri të ulët ndaj kësaj goditjeje. Për të njëjtën goditje, kapitali rregullator zbret me 0.5 miliardë lekë, në nivelin 58.1 miliardë lekë.

Për sa i takon nënçmimit të monedhës evropiane (euro) kundrejt monedhës vendase me 50 për qind, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bie lehtësisht me 0.1 pikë përqindje, në nivelin 17.1 për qind. Përsa i përket grupeve të bankave sipas madhësisë së aktivitetit, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie më shumë për bankat e Grupit 2 dhe të Grupit 1, përkatësisht me 0.3 pikë përqindje.

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT.

Ky test vlerëson ndjeshmërinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të kapitalit rregullator, si rezultat i ndryshimit të normave të interesit. Testi aplikohet për monedhën vendase, monedhën amerikane dhe atë evropiane. Si normë interesi referencë, për çdo monedhë është llogaritur norma mesatare e ponderuar e depozitave të reja dhe e kredive të reja të sektorit bankar. Vlerës aktuale të normës së interesit i shtohet vlera e goditjes që aplikohet.

Për një rritje të supozuar të normës së interesit për monedhën vendase me 3 pikë përqindje (nga 6.9 për qind në 9.9 për qind), norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar rezulton me një rënie prej 1.5 pikë përqindjeje, në nivelin 15.7 për qind. Për të njëjtën goditje, kapitali rregullator bie me 5.4 miliardë lekë, në nivelin 53.2 miliardë lekë. Për sa i përket grupeve të bankave sipas madhësisë së aktivitetit, rënia më e madhe e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit pas goditjes rezulton për bankat e Grupit 3 me rreth 2 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin 14.6 për qind. Ndërkohë për bankat e Grupit 1 dhe Grupit 2, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie në të njëjtën masë, me 0.5 pikë përqindje. Për goditje më të mëdha të aplikuara të normave të interesit (4 pikë për qind deri në 10 pikë për qind), norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar luhatet ndjeshëm por mbetet mbi nivelin minimal të lejuar. Megjithatë, në këtë rast meriton vëmendje analiza e bankave të veçanta.

Goditja e dytë mat efektin mbi kapitalin rregullator dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për një rritje 3 pikë për qind të normës së interesit në monedhën amerikane (nga 3.4 për qind në 6.4 për qind). Si rezultat i aplikimit të kësaj goditjeje, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar bie lehtësisht me 0.1 pikë përqindje. Sipas grupeve të bankave, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave të Grupit 2 nuk pëson asnjë luhatje ndërkohë që për bankat e Grupit 1 dhe të Grupit 3 ajo bie në të njëjtën masë prej 0.2 pikë përqindjeje. Edhe për goditje më të mëdha se 3 pikë për qind të aplikuara, sistemi bankar paraqitet i mbrojtur me normën e mjaftueshmërisë së kapitalit brenda normës së lejuar.

Goditja e tretë mat efektin mbi kapitalin rregullator dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për një rritje me 3 pikë për qind të normës së interesit në monedhën evropiane (nga 3.7 për qind në 6.7 për qind). Si rezultat i aplikimit të goditjes, bie norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar me 0.1 pikë përqindje dhe zbret kapitali rregullator me 0.3 miliardë lekë, në nivelin 58.3 miliardë lekë. Për grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, vihet re se norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e Grupit 1 dhe të Grupit 3 nuk ndikohet nga aplikimi i goditjes, ndërkohë që norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e Grupit 2 bie me 0.2 pikë përqindje. Për sa i përket bankave të veçanta nuk ka luhatje të qenësishme të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Theksojmë se për goditje më të mëdha se 3 pikë përqindje (4 pikë për qind deri në 10 pikë për qind) të aplikuara, sektori

bankar rezulton i mbrojtur me normën e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi nivelin minimal të lejuar. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për banka të veçanta.

Si konkluzion, aftësia e sektorit bankar për të përballuar me kapital humbjet që mund t'i vijnë si rezultat i lëvizjeve të pafavorshme të normës së interesit, është e plotë.

RREZIKU I KREDITIT.

Rezistenca e sektorit bankar ndaj rrezikut të kreditit vlerësohet duke supozuar luhatje të ndjeshme të nivelit të kredive me probleme dhe duke llogaritur efektin e tyre ndaj kapitalit rregullator dhe normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Për të realizuar goditjen supozohet një rritje e kredive me probleme në masën 10 për qind, 50 për qind, 100 për qind deri në 200 për qind.

Rezultatet e provës tregojnë se rritja e kredive me probleme me 10 për qind, ul normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar me 0.2 pikë përqindje, në nivelin 17 për qind. Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e Grupit 2 shfaqin rënien më të madhe të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.3 pikë përqindje, në nivelin 15.1 për qind.

Rritja e kredive me probleme me 50 për qind, rrit ndjeshmërinë e sektorit bankar dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie me 1.1 pikë përqindje në nivelin 16.1 për qind. Gjithashtu, kapitali rregullator do të binte me rreth 4.5 miliardë lekë në nivelin 54.1 miliardë lekë. Sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e Grupit 2 shfaqin ekspozimin më të madh ndaj kësaj goditjeje, me një rënie të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit me 1.4 pikë përqindje, në nivelin 13.9 për qind. Bankat e veçanta, mbeten mbi normën minimale të lejuar të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Rritja e kredive me probleme me 100 për qind, sjell uljen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar me 2.2 pikë përqindje, në nivelin 15 për qind. Në nivel grupesh sipas madhësisë vihet re se bankat e Grupit 2, të ndjekura nga bankat e Grupit 3, pësojnë rënien më të madhe të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, respektivisht me 2.9 pikë përqindje dhe 2.2 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 12.5 për qind dhe 14.5 për qind. Në këtë rast, meriton vëmendje analiza e bankave të veçanta.

Rritja e kredive me probleme me 180-200 për qind, shoqërohet me rënien e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar, por ajo mbetet mbi nivelin minimal të lejuar. Në këtë rast, banka të veçanta pësojnë një rënie të theksuar të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, edhe përtej nivelit minimal të lejuar nga kuadri rregullativ.

RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PREJ KURSIT TË KËMBIMIT.

Kjo provë vlerëson rrezikun e tërthortë të kreditit, që shkaktohet prej lëvizjes së pafavorshme të kursit të këmbimit dhe ndikimit të saj mbi portofolin e kredidhënies në valutë, kur klientët i kanë të ardhurat e tyre në monedhën vendase. Lëvizja e pafavorshme e kursit të këmbimit, rrit vlerën në lekë të kështit të kredisë në valutë që duhet të paguhet, duke vështirësuar aftësinë paguese të kredimarrësit. Edhe në këtë rast, vlerësohet ndikimi mbi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kapitalit rregullator.

Një nënçmim i supozuar i monedhës vendase me 50 për qind kundrejt monedhës amerikane, ndikon lehtësisht në uljen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për

sistemin bankar me 0.1 pikë përqindje duke arritur në nivelin 17.1 për qind. Për grupet e bankave, rënia e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit është përkatësisht 0.6 pikë përqindje për bankat e Grupit 1 dhe 0.1 pikë përqindje, për dy grupet e tjera. Në nivel bankash individuale nuk vihen re luhatje të rëndësishme të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Goditja e dytë konsiston në një nënçmim të monedhës vendase me 50 për qind, këtë herë kundrejt monedhës evropiane (euro). Aplikimi i kësaj goditjeje ndikon dukshëm sjelljen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit si për sektorin bankar, grupet e bankave apo bankave individuale pasi aktiviteti kreditues është më i përqendruar në monedhën evropiane (euro). Konkretisht, nënçmimi i monedhës vendase me 50 për qind, ndikon në uljen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit të sistemit bankar me 1.3 pikë përqindje, në nivelin 16 për qind. Njëkohësisht kapitali rregullator i sistemit bie me rreth 5.2 miliardë lekë në nivelin 53.4 miliardë lekë. Në nivel grupesh sipas madhësisë së aktivitetit, bankat e Grupit 2 shfaqin ndjeshmërinë më të madhe pasi norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie me 2 pikë përqindje në nivelin 13.3 për qind. Tek bankat e Grupit 3, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit bie me 1.1 pikë përqindje në nivelin 15.5 për qind. Në nivel bankash individuale vihet re se pas aplikimit të goditjes, norma e mjaftueshmërisë për disa prej tyre, është shumë pranë nivelit minimal të lejuar ose nën atë nivel.

Aplikimi i goditjeve më të mëdha se 50 për qind, për shembull në një interval nga 60 për qind deri në 100 për qind, ul ndjeshëm normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar por duke mbetur mbi nivelin minimal të kërkuar. Për banka të veçanta, norma e mjaftueshmërisë bie nën nivelin e lejuar duke vënë në vështirësi mbulimin me kapital të humbjeve që vijnë në këtë rast.

RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT NËPËRMJET LUHATJEVE TË NORMAVE TË INTERESIT.

Aftësia paguese e kredimarrësve është e lidhur ngushtë dhe me luhatjet e normave të interesit për monedhat përkatëse, në të cilat ata kanë përfituar kreditë. Luhatjet e normave të interesit nuk pakësojnë vetëm kapitalin e bankës në momentin e hendekut të gjerë midis aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, por rrisin edhe koston e kredisë për kredimarrësit, duke çuar në përkeqësimin e aftësisë së tyre paguese, e për pasojë në rritjen e portofolit të kredive me probleme për bankën. Ky test merr në konsideratë ndikimin e goditjeve të normave të interesit mbi portofolin e kredisë, respektivisht sipas monedhave kryesore lekë, euro dhe usd. Normat mesatare të kredisë në lekë, euro dhe usd në fund të muajit dhjetor, janë përkatësisht 11.7 për qind, 7.3 për qind dhe 6.85 për qind.

Rritja e supozuar e normës së interesit me 5 për qind (por edhe më lart se ky nivel - 10 për qind) për kredinë në monedhën vendase dhe kredinë në secilën monedhë, nuk ka sjellë ndikime të rëndësishme në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar, për grupet e bankave dhe për banka të veçanta. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit pas këtyre goditjeve, ka rënë deri në 0.2 pikë përqindje si për sektorin ashtu dhe për grupet e bankave të ndryshme. Edhe bankat individuale, kanë qenë pak të ekspozuara nga këto goditje të supozuara.

RREZIKU I TËRTHORTË I KREDISË NËPËRMJET KOMBINIMIT TË SKENARËVE – MODELI DINAMIK.

Kjo provë, përpiqet të kombinojë efektin që kanë skenarët e uljes së ritmit të rritjes ekonomike, rritjes së normës të interesit për euron dhe nënçmimit të kursit

të këmbimit të lekut ndaj euros, në vlerën e raportit të "kredive me probleme ndaj totalit të kredisë", pas gjashtë muajsh.

Me të dhënat e fundit të vitit 2008, vlerat e raportit që shpreh cilësinë e kredisë, sipas skenarëve që vijnë duke u përkeqësuar, shfaqen në tabelën më poshtë.

Tabelë 21. Skenarët e rrezikut.

	Skenari 1 (i pastresuar)	Skenari 2 (i stresuar)
Rritja ekonomike	1%	0%
Ndryshimi i normës euribor	+0.5 %	+1%
Zhvlerësimi i kursit të këmbimit	5%	20%
Rezultate:		
- Mesatare	7.0 %	10.1%
- Devijimi standard	0.00758764	0.0105302
- Vlerësimi intervalor me 90% besueshmëri	6.1%- 8. %	8.8%-11.5%
- Vlerësimi intrervalor me 95 % besueshmëri	5.9%-8.3%	8.5%-11.9%

Pretendohet që nëse do të ndodhte skenari 2, në kushtet e mungesës së një rritjeje ekonomike të kombinuar me një rritje të normës euribor me 1 pikë përqindje dhe një nënçmim të kursit të këmbimit të lekut ndaj euros me 20 për qind, vlera pikësore e raportit të "kredi me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë" do të ngjitej në nivelin 10.1 për qind. Në tre rreshtat e fundit të tabelës, jepet devijimi standard i këtij vlerësimi si dhe vlerësimet intervalore (zona e shtrirjes së vlerave të mundshme) në nivelet e besueshmërisë 90 për qind dhe 95 për qind.

Në grafikun 103 janë paraqitur shpërndarjet e dendurive të vlerave të raportit të huave me probleme për muajin qershor 2009, të simuluara me metodën Monte Carlo për dy skenarët e mësipërm.

E njëjta provë e kryer mbi të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2009 prodhon vlerat pikësore të raportit të "kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë" për tremujorin e tretë të vitit 2009, në nivelet 8.5 për qind dhe 12.2 për qind, përkatësisht sipas skenarëve.

Duke patur parasysh nivelet e kapitalizimit të sektorit në muajin mars 2009, edhe skenari i stresuar (skenari 2), nuk e ul në asnjë rast raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar nën nivelin minimal të kërkuar.

Grafik 103. Probabiliteti i ndodhjes së një huaje me probleme e matur nga raporti i huave me probleme në skenarët optimist, normal dhe pesimist.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 8. Institucionet financiare jobanka.

Institucionet financiare jobanka zënë një peshë të vogël në totalin e sistemit financiar dhe për rrjedhojë, rreziqet që mund të burojnë nga aktiviteti i tyre nuk kanë karakter sistemik. Këto institucione përfaqësohen nga institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, të cilat licencohen nga Banka e Shqipërisë dhe shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensioneve private suplementare, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Institucionet financiare jobanka, kryejnë veprimtari të lidhura me ndërmjetësimin financiar por nuk pranojnë depozita nga publiku. Ato përfaqësohen nga 7 institucione

financiare jobanka, 2 unione të mëdha të kursim-kreditit dhe shoqëritë e tyre pjesëmarrëse, si edhe një numër i konsiderueshëm zyrash të këmbimit valutor. Në fund të vitit 2008, aktivet e këtyre institucioneve jobanka (pa përfshirë zyrat e këmbimit valutor) përbënin 1.9 për qind të totalit të aktiveve të sistemit financiar (nga 1.87 për qind në fund të vitit 2007) duke zënë 1.5 për qind të PBB-së, me një rritje të papërfillshme nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Vetëm pesha e shoqërive të kursim-kreditit për fundin e vitit 2008 llogaritet në 0.87 për qind të totalit të sistemit financiar dhe 0.71 për qind të PBB-së së vendit. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë këta tregues rezultonin 0.79 për qind dhe 0.63 për qind.

Institucionet e tjera financiare jobankare që licencohen dhe monitorohen nga AMF dhe që përbëjnë segmente të rëndësishme të sistemit financiar janë shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve private suplementare dhe tregu i letrave me vlerë. Për kompanitë e sigurimit, në fund të vitit 2008 aktivet përbënin 1.86 për qind të totalit të aktiveve të sistemit financiar, nga 1.7 për qind në fund të vitit 2007. Në raport me PBB-në, pesha e tyre llogaritet 1.52 për qind.

Grafik 104. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit në përqindje, në fund të vitit 2008.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tregu i letrave me vlerë nuk është shumë i zhvilluar dhe pak subjekte, kryesisht banka, janë tregtarët dhe regjistruesit e vetëm. Tregu i vetëm i organizuar është Bursa e Tiranës, e cila akoma nuk funksionon plotësisht.

ANALIZË FINANCIARE MBI AKTIVITETIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA.

Veprimtaria e institucioneve financiare jobanka gjatë vitit 2008 paraqet zhvillime pozitive për sa i përket rritjes së aktiveve, fitimit, nivelit të kapitalizimit të aktivitetit si dhe për nga zhvillimet në kuadrin rregullator të mbikëqyrjes së tyre. Aktivet e institucioneve financiare jobanka në tremujorin e fundit të vitit 2008 rezultuan 16.6 miliardë lekë, 4.9 për qind më lart se një tremujor më parë dhe rreth 14.9 për qind më lart se e njëjta periudhë e një viti më parë (grafik 105).

Grafik 105. Rritja e nivelit të aktiveve sipas tremujorëve, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontributin më të madh në rritjen e aktiveve nga zërat e bilancit për tremujorin e fundit të vitit 2008 e dhanë zëri "veprimet me klientët" me rreth 74 për qind ndjekur nga zëri "arka, depozita dhe llogaritë" me 21 për qind dhe zëri "mjete të qëndrueshme ose jofinanciare" me një kontribut prej 17 për qind në rritjen e totalit të aktiveve.

Niveli i kapitalizimit, i matur si raport i "llogarisë së kapitalit" me "totalin e aktiveve", në fund të tremujorit të katërt të vitit 2008 ka rezultuar 51.3 për qind (nga 52.4 për qind një tremujor më parë dhe 48.8 për qind në të njëjtin tremujor të një viti më parë), duke respektuar normën rregullatore të mjaftueshmërisë së kapitalit, e cila për institucionet financiare jobanka duhet të jetë mbi 10 për qind. Gjatë vitit 2008, norma më e lartë e mjaftueshmërisë së kapitalit u shënua në tremujorin e parë përkatësisht 54.6 për qind (grafik 106). Një tregues tjetër që mat nivelin e kapitalizimit është raporti i "kapitalit" ndaj "totalit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto" i cili, për tremujorin e fundit të vitit 2008, rezulton 959 për qind,

15 pikë përqindje më i lartë se një tremujor më parë dhe 86 pikë përqindje më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë. Edhe ky tregues qëndron mbi nivelin e lejuar prej 100 për qind që është përcaktuar si normë rregullatore për këtë tregues.

Portofoli i kredive në tremujorin e katërt arriti në 9.5 miliardë lekë, me një rritje prej 1.8 miliardë lekësh ose 23.5 për qind më i lartë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë e matur si raport i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë, në tremujorin e katërt të vitit 2008 është përmirësuar krahasuar me një tremujor më parë duke arritur në 2.6 për qind nga 3.2 për qind. Ndërkohë që referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë ajo llogaritet në nivelin 1.6 për qind (grafik 107). Gjatë vitit 2008, raporti më i lartë i kredive me probleme është shënuar në tremujorin e tretë duke arritur rreth 3.2 për qind.

Grafik 106. Raporti i kapitalizimit të institucioneve financiare jobanka, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një tjetër tregues i cilësisë së aktiveve është ai i ndërtuar nga raporti i totalit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto ndaj totalit të aktiveve, i cili për tremujorin e katërt të vitit 2008 është përmirësuar lehtësisht në vlerën 5.4 për qind nga 5.6 për qind, që llogaritej në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Llogaria fitim-humbje për tremujorin e katërt të vitit 2008 paraqet një performancë të mirë pasi fitimi i vitit rezulton 1.2 miliardë lekë (nga 744.5 milionë lekë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë).

Llogaria fitim-humbje për tremujorin e katërt të vitit 2008 paraqet një performancë të mirë pasi fitimi i vitit rezulton 1.2 miliardë lekë (nga 744.5 milionë lekë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë).

Grafik 107. Raporti i cilësisë së portofolit të kredive.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave në tremujorin e katërt të vitit 2008 ato arritën në nivelin 4.6 miliardë lekë, 21.9 për qind më i lartë se një tremujor më parë dhe 15.1 për qind më shumë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kontributin më të madh në rritjen e të ardhurave e dhanë të ardhurat nga interesi, si burimi kryesor i të ardhurave të këtyre institucioneve, duke përbërë në këtë mënyrë 53.2 për qind të totalit të të ardhurave (nga 49.7 për qind të një tremujori më parë dhe 43.2 për qind referuar tremujorit të katërt të vitit 2007). Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008 vihet re një rritje e peshës së të ardhurave nga komisionet me 1.3 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e kaluar, duke përbërë 12.9 për qind të totalit të të ardhurave (nga 11.6 për qind një tremujor më parë dhe 15.6 për qind në tremujorin e fundit të vitit 2007). Një peshë më të vogël zënë të ardhurat nga veprimtari të jashtëzakonshme, të cilat për tremujorin e katërt të vitit 2008 llogariten në 1.8 për qind të totalit të të ardhurave (nga 1.6 për qind një tremujor më parë dhe e njëjta peshë me tremujorin e fundit të vitit 2007).

Banka e Shqipërisë në realizimin e rolit të saj mbikëqyrës për subjektet të cilat ajo licencon dhe mbikëqyr, përmirëson vazhdimisht kuadrin rregullator. Së fundmi, Banka e Shqipërisë ka përmirësuar rregulloren" "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" të hartuar në zbatim të ligjit nr. 9662,

datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Në këtë rregullore janë përfshirë disa ndryshime të cilat lejojnë:

- *të përfshihet në veprimtaritë e subjekteve edhe veprimtaria e këmbimit valutor, si veprimtari deri më sot jo e lejuar për subjektet financiare jobanka;*
- *të përcaktohen kërkesat për kapital për të ushtruar qiranë financiare dhe "factoring"-un në përputhje me nivelet e kërkuara për kapital në ligjet përkatëse, që rregullojnë këto veprimtari;*
- *të përcaktohen lehtësi në nivelet e kërkuara të kapitalit për institucionet financiare të mikrokredisë në procesin e licencimit të tyre;*
- *të përcaktohet kërkesa për pagesën e kapitalit fillestar minimal vetëm në monedhën vendase (lekë);*
- *të përcaktohen kërkesa për verifikimin e burimit të kapitalit, që do të kërkojë një deklaratë nga themeluesit e shoqëruar kjo edhe me dokumente të tjera vërtetuese.*

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT (SHKK-TË).

Shoqëritë e kursim-kreditit (shkk-të) janë subjekt i licencimit dhe mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Ato për nga natyra e aktivitetit pranojnë depozita nga anëtarët e shoqërive dhe raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë gjendjen financiare dhe normat mbikëqyrëse. Aktualisht, kryejnë veprimtarinë e tyre 128 shoqëri të kursim-kreditit si pjesë e 2 unioneve të mëdha.

Shoqëritë e kursim-kreditit regjistruan një rritje me 24.4 për qind në fund të vitit 2008, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Totali i aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit arriti në 7.6 miliardë lekë, duke zënë afërsisht 16.7 për qind të aktiveve të institucioneve financiare jobanka (përfshirë këtu dhe shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit) për fundin e vitit 2008. Megjithatë ato zënë një peshë të vogël kundrejt aktiveve të sistemit financiar përkatësisht 0.87 për qind.

Aktiviteti kreditues luan rolin kryesor dhe në tremujorin e fundit të vitit 2008, shoqëritë e kursim-kreditit raportuan 82 për qind të totalit të aktiveve të investuara në aktivitetin e kredidhënies (tabelë 22).

Treguesi i cilësisë së portofolit mbi baza bruto për shoqëritë e kursim-kreditit ka shënuar një përkeqësim të lehtë në tremujorin e katërt të vitit, në nivelin 1.3 për qind nga 1 për qind që llogaritej një tremujor më parë dhe 0.5 për qind, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kjo ka ardhur si rezultat i ritmit më të lartë rritës të huave me probleme (177.3 për qind) ndaj rritjes së tepricës së kredisë (16 për qind), në krahasim me fundin e vitit 2007.

Tabelë 22. Treguesit e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit sipas tremujorëve.

	T IV- 07	T I- 08	T II-08	T III- 08	T IV- 08
Totali i aktiveve (mln lek)	6,153,850	6,575,290	7,237,454	7,517,095	7,657,331
Teprica e kredisë	5,415,833	5,778,238	6,078,940	6,215,071	6,283,464
Teprica e kredisë/Totalit të aktiveve (në %)	88.01	87.88	83.99	82.68	82.06
Kredi me probleme	29,694	35,623.00	44,876	65,352	82,352
Kredi me probleme/Tepricës së kredisë (në %)	0.55	0.62	0.74	1.05	1.31

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultati neto i shoqërive të kursim-kreditit në fund të vitit 2008 rezulton pozitiv për 109.2 milionë lekë, duke shënuar një rritje 2.4 për qind krahasuar me një vit më parë.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT SUPLEMENTAR.

Tregu i sigurimeve, gjatë vitit 2008 ka zgjeruar aktivet e tij në masën 22 për qind krahasuar me një vit më parë mbështetur nga investimet në depozita, në pasuri të paluajtshme si dhe në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara e të patrupëzuara. Në vitin 2008 u nënshkruan rreth 692 mijë kontrata sigurimi ose rreth 27 për qind më shumë se një vit më parë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve arritën në 7.1 miliardë lekë ose rreth 19 për qind më shumë se një vit më parë. Viti 2008 ka shënuar një ndryshim në strukturën e sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 44 për qind dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 56 për qind të tregut, kur një vit më parë këto të fundit zinin rreth 65 për qind të tregut. Ndërkohë, po sipas AMF, dëmet e paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit në total janë rritur në masën 19 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Aktivet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e tretë të vitit 2008, rezultuan 16.3 miliardë lekë, 6.5 për qind më lart se një tremujor më parë dhe 21.8 për qind më lart se tremujori i fundit i vitit 2007 duke zënë rreth 1.85 për qind të sistemit financiar dhe 1.5 për qind të PBB-së. Kontributin më të madh në rritjen e aktiveve për tremujorin e tretë të vitit 2008 krahasuar me një tremujor më parë e dha zëri i aktivit "depozita, certifikata depozitash dhe llogari në banka" me 63.5 për qind, ndërkohë që me tremujorin e fundit të vitit 2007 ky zë ka kontribuar në 45.8 për qind. Zëri tjetër i aktivit për nga kontributi është "investime në pasuri të paluajtshme" me një kontribut prej 7 për qind në rritjen totale të aktiveve të shoqërive të sigurimit, ndërkohë që në fundin e vitit 2007 ai rezulton 14 për qind. Zëri "mjetet e qëndrueshme (të trupëzuara dhe të patrupëzuara)" ka kontribuar më pak, rreth 5 për qind në rritjen e aktiveve për tremujorin e tretë në krahasim me një tremujor më parë.

Raporti i kapitalit ndaj totalit të aktiveve për tremujorin e tretë të vitit 2008 ka rezultuar 50.3 për qind, rreth 3 pikë përqindje më i ulët se një tremujor më parë dhe rreth 1 pikë përqindje më i lartë se tremujori i fundit i vitit 2007. Krahas këtij treguesi, një tjetër indikator është ai i llogaritur si raport i kapitalit ndaj rezervave teknike, i cili tregon aftësinë për të përvetësuar humbjet si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme. Ky tregues për tremujorin e tretë të vitit 2008 rezulton 126.5 për qind, duke pësuar një rënie me 5 pikë përqindje krahasuar me një tremujor më parë, megjithatë me një përmirësim të dukshëm prej 9 pikë përqindje me tremujorin e fundit të vitit 2007.

Provigjonet teknike, për tremujorin e tretë të vitit 2008 arritën 1.4 miliardë lekë, 7.5 për qind më shumë se një tremujor më parë dhe 19.8 për qind më lart se fundi i vitit 2007. Pesha që provigjonet teknike zënë në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit është rreth 9 për qind.

Fitimi i shoqërive të sigurimit për tremujorin e tretë rezulton 805 milionë lekë nga 936.2 milionë, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë.

AMF ka vijuar të përsosë kuadrin rregullativ të këtij tregu dhe infrastrukturën teknologjike të monitorimit të tij. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2008 janë përpiluar dhe miratuar udhëzime dhe rregullore mbi subjektet që AMF ka nën juridiksion dhe disa prej tyre janë si më poshtë:

- *Udhëzim nr.15, datë 22.02.2008 "Për përmbajtjen e raportit të auditit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar".*
- *Rregullore nr.61, datë 22.05.2008 "Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve".*

- *Rregullore nr.120, datë 02.10.2008 "Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve".*
- *Projektligj mbi fondet e pensionit vullnetar, i hartuar me qëllim vendosjen e standardeve të nevojshme për krijimin dhe administrimin e fondeve të pensionit vullnetar.*
- *Projektligj për sipërmarrjet e investimeve kolektive, i hartuar, duke marrë parasysh kërkesën në rritje të tregut për investime afatgjata.*

Tregu i pensioneve private suplementare gjatë periudhës janar-dhjetor 2008 është rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me shtim të numrit të kontribuesve (për vitin 2008 numërohen gjithsej 3,861 kontribues krahasuar me 2,872 që ishin në vitin 2007). Kontributet në vlerë për vitin 2008 arritën në 53.1 milionë lekë nga 32 milionë lekë në vitin 2007, duke shënuar një rritje prej 65 për qind.

6 ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Sistemi i pagesave gjatë vitit 2008 ka pasqyruar funksionim eficient, me minimumin e problemeve teknike. Përqendrimi në lidhje me sistemet AIPS dhe AECH mbetet i konsiderueshëm, me një numër të caktuar bankash me peshë të lartë në totalin e aktiviteteve të sistemit. Vëllimi i pagesave është shtuar ndjeshëm dhe pritet të shtohet me ritme të larta edhe në vitin 2009. Vëllimi dhe vlera më e madhe e pagesave të procesuara në sistemin AECH, vihen re në tremujorin e katërt të vitit 2008, duke konfirmuar rritjen e vazhdueshme të pagesave në këtë sistem. Bankat kanë shtuar numrin e makinerive ATM dhe të terminaleve POS për përdorimin e kartave, por gjithsesi përdorimi i *cash*-it mbetet i lartë, duke qenë se shumica dërrmuese e këtyre transaksioneve janë tërheqje të tij nga ATM-të. Pagesat elektronike dhe aksesimi i llogarisë nëpërmjet "home banking" janë akoma në hapat e parë dhe për rrjedhojë, rreziqet e lidhura me këto instrumente mbeten të kufizuara.

Gjatë vitit 2008, sistemet e pagesave kanë reflektuar siguri dhe eficiencë, karakteristika këto të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit të pagesave. Klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël - AECH", në përputhje me rregullat e shlyerjes së pagesave ndërbankare. Sistemi i shlyerjes së pagesave në kohë reale (AIPS) ka qenë i aksesueshëm nga pjesëmarrësit në 99.88 për qind të orarit të tij të operimit. Thënë ndryshe, në 246 ditë punë, sistemi ka qenë i padisponueshëm vetëm për 2 orë e 22 minuta, si pasojë e problemeve teknike dhe/ose problemeve të komunikimit me rrjetin e SWIFT-it.

6.1 SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE - AIPS

Gjatë vitit 2008, në sistemin AIPS u procesuan dhe u shlyen 56,717 transaksione, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 91 milionë lekësh. Kundrejt vitit 2007, vëllimi i pagesave të shlyera në 2008-ën, rezulton të jetë rritur me 25 për qind, ndërkohë që vlera e transaksioneve të shlyera është rritur me 37 për qind.

Tabelë 23. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS në vite.

Sistemi AIPS	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	38,793	45,480	56,717
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,376	3,745	5,146
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	87	82	91

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Numri më i madh i transaksioneve të shlyera është përqendruar në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që qarkullimi më i madh i likuiditetit rezulton në tremujorin e tretë të vitit 2008.

Tabelë 24. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS sipas tremujorëve të vitit 2008.

	Tremujori				Viti
Sistemi AIPS	I	II	III	IV	2008
Numri i transaksioneve	12,845	15,147	14,005	4,720	56,717
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	1,047	1,237	1,576	1,286	5,146
Vlera mesatare/transaksion (mln lekë)	82	82	113	90	91

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar dhe shlyer rreth 231 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej 21 miliardë lekësh. Vlera totale e likuiditeteve të qarkulluara në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, rezulton të jetë rreth 5 herë më e madhe se vlera e produktit të brendshëm bruto (PBB) për vitin[53]. Aktualisht, të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri janë pjesëmarrëse direkte për shlyerje në sistemin AIPS.

Në mënyrë më të detajuar, llojet e transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, dhe pesha e tyre relative ndaj totalit, paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabelë 25. Llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS.

	Vëllim		Vlerë (miliardë lekë)	
Lloji i transaksioneve në AIPS	Numri i transaksioneve	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione/instrumente financiare BSH	4,364	8%	3,053.2	59%
Transferta *cash* për/nga emisioni	9,052	16%	249.3	5%
Pagesa ndërbankare	8,512	15%	833.8	16%
Pagesa për klientët	29,068	51%	484.9	9%
Shlyerje për sistemet e klerimit neto[54]	5,721	10%	524.7	10%
Totali	56,717	100%	5,146	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga numri total i transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2008, vëmë re se rreth 51 për qind përfaqësohet nga pagesat për klientët që bankat shlyejnë ndërmjet tyre, përfshirë këtu dhe pagesat që bankat transferojnë çdo ditë në llogarinë e buxhetit të shtetit, për llogari të klientëve të tyre. Për sa i përket vlerës së transaksioneve, vërehet që rreth 59 për qind e vlerës së përgjithshme përfaqësohet nga transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, për përmbushjen e objektivave të saj si bankë qendrore.

Nga pikëpamja e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të stabilitetit të sistemeve të pagesave, vlerësohet edhe shkalla e përqendrimit të pagesave në nyje (pjesëmarrës) të veçanta të rrjetit. Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS, reflektojnë peshën që zë aktiviteti i një numri të caktuar bankash (3 ose 5 banka), kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem.

Tabelë 26. Tregues të përqendrimit për sistemin AIPS.

	Vëllim transaksionesh	Vlerë (mld lekë)
Sistemi AIPS	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	51%	70%
5 banka	62%	85%
Totali (vlerë absolute)	56,717	5,146

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një instrument i rëndësishëm në sistemin AIPS është edhe kredia brenda ditës (ILF)[55], një kredi e kolateralizuar, me interes zero, që Banka e Shqipërisë i ofron bankave pjesëmarrëse për menaxhimin e likuiditetit brenda ditës.

Tabelë 27. Përdorimi i kredisë brenda ditës.

Kredi brenda ditës (ILF)	2007	2008
Numri i transaksioneve	675	579
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	218	221
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	322	382

Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.2 SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH

Një total prej 113,682 transaksione pagesash u kleruan në sistemin AECH gjatë vitit 2008, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 150 mijë lekësh. Kundrejt vitit 2007, vëllimi i pagesave të kleruara gjatë vitit 2008, rezulton të jetë rritur me 58 për qind, ndërkohë që vlera e transaksioneve të kleruara është rritur me 47 për qind.

Tabelë 28. Tregues për transaksionet në sistemin AECH në vite.

Sistemi AECH	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	48,889	71,857	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	7.77	12.01	17.61
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.16	0.17	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në sistemin AECH, procesohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1 milion lekë, si dhe llogariten pozicionet neto shumëpalëshe për shlyerje neto në sistemin AIPS. Nga 16 banka që operojnë në Shqipëri, aktualisht 14 banka janë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin AECH, duke procesuar çdo ditë në sistem pagesat e klientëve të tyre. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 462 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 71.6 milionë lekësh. Vëllimi dhe vlera më e madhe e pagesave të procesuara në sistemin AECH, vihen re në tremujorin e katërt të vitit 2008.

Tabelë 29. Tregues për transaksionet në sistemin AECH, sipas tremujorëve të vitit 2008.

	Tremujori				Viti
Sistemi AECH	I	II	III	IV	2008
Numri i transaksioneve	24,317	29,179	27,872	32,314	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.88	4.45	4.29	5.00	17.61
Vlera mesatare /transaksion (milionë lekë)	0.16	0.15	0.15	0.15	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vërehet se, për periudhën njëvjeçare, në seksionin e parë[56] të procesimit janë kleruar vëllimi dhe vlera më e madhe e pagesave për klientët.

Tabelë 30. Pagesat e kleruara në sistemin AECH, sipas seksioneve.

	Seksioni		Viti
Sistemi AECH	I	II	2008
Numri i transaksioneve	63,266	50,416	113,682
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	10.69	6.92	17.61
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.17	0.14	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH, reflektojnë peshën që zë aktiviteti i një numri të caktuar bankash pjesëmarrëse në sistem, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Treguesi i përqendrimit tregon se 5 banka zotërojnë rreth 63 për qind të totalit të pagesave me vlerë të vogël në sistemin bankar.

Tabelë 31. Tregues të përqendrimit për sistemin AECH.

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (mld lekë)
Sistemi AECH	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	45%	49%
5 banka	63%	64%
Totali (vlerë absolute)	113,682	17,612

Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.3 INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE

Në funksion të publikimit të treguesve statistikorë për instrumentet e pagesave në Shqipëri, gjatë vitit 2008, u rishikua metodologjia "Për raportimin e instrumenteve të pagesave", bazuar në të dhënat që raportojnë bankat mbi instrumentet e pagesave.

Metodologjia e re synon: a) grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave periodike dhe ndërtimin e një baze të dhënash mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në Shqipëri, me qëllim analizën e tendencave, të ndihmojë publikun në njohjen e zhvillimit të sistemit të pagesave në Shqipëri; b) monitorimin e zhvillimeve në fushën e sistemeve të pagesave në mënyrë që të vlerësohet shkalla e rreziqeve që këto përmbajnë dhe të sigurohet transparenca në marrëveshjet që kanë të bëjnë me instrumentet dhe shërbimet e pagesave; c) përputhjen me statistikat e raportuara nga Banka Qendrore Evropiane dhe Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare, duke synuar në të ardhmen publikimin e të dhënave për Shqipërinë në *Blue Book* dhe *Red Book* (botime të Bankës Qendrore Evropiane mbi pagesat).

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2008, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa në lekë apo në valutë të huaj, është 1,573,830, nga të cilat rreth 91 për qind janë llogari individuale. Më pak se 1 për qind e numrit të përgjithshëm të llogarive, janë të aksesueshme nga interneti (*home banking*) për të kryer pagesa apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë.

Tabelë 32. Përbërja e llogarive bankare.

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive	Të aksesueshme nga interneti
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,573,830	11,108
1- llogari të rezidentëve (a+b)	1,564,084	10,751

a - individuale	1,429,294	6,958
b - kompani	134,790	3,793
2- llogari të jorezidentëve (a+b)	9,746	357
a - individuale	9,311	314
b - kompani	435	43

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Në fund të vitit 2008, në Republikën e Shqipërisë operojnë 16 banka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash në 438 degë/agjenci bankare në të gjithë vendin. Gjatë këtij viti, janë shtuar gjithashtu makinat ATM dhe terminalet POS për përdorimin e kartave, me një rritje përkatësisht prej 45 dhe 61 për qind, krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2007.

Tabelë 33. Numri i terminaleve ATM dhe POS.

Përshkrimi	Totali
Makina ATM (Automated Teller Machines)	642
prej të cilave:	
1 - ATM me funksion tërheqje *cash*	642
2 - ATM me funksion urdhër transferta	59
3 - ATM me funksion depozitim *cash*	73
Terminale POS (Point of Sale)	2,953
prej të cilave :	
1- terminale POS me funksion tërheqje *cash*	907
2- terminale pagesash EFTPOS	2,915
Terminale për përdorimin e parasë elektronike	-

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Vitet e fundit, një formë mjaft e njohur për kryerjen e pagesave është edhe përdorimi i instrumenteve të pagesave elektronike, instrumente të cilat po përdoren gjithnjë e më shumë edhe në Shqipëri. Në 31 dhjetor 2008, vërehet një rritje prej 17 për qind e numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me fundin e vitit 2007. Peshë të konsiderueshme në këtë rritje kanë patur kartat e kreditit të emetuara gjatë këtij viti, me një rritje prej 53 për qind, kundrejt fundit të vitit 2007.

Tabelë 34. Përdorimi i kartave bankare.

Numri i kartave sipas funksioneve	31 Dhjetor 2008
Karta me funksion *cash*-i	512,232
Karta me funksion pagese	498,003
prej të cilave:	
1- karta debiti	482,072
2- karta krediti	15,931
Karta me funksion para elektronike	-
Numri total i kartave në qarkullim	512,232
prej të cilave:	
- karta me më shumë se një funksion	498,003

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Gjatë vitit 2008, në total u procesuan 8,205,143 transaksione me karta, me një qarkullim total vjetor prej 93.7 miliardë lekësh. Nga totali i

transaksioneve, rreth 96 për qind përbëjnë tërheqje *cash* nga ATM-të, tregues ky i një ekonomie me përdorim të lartë të *cash*-it. Thënë ndryshe, në përpjesëtim me numrin e popullsisë[57] në Shqipëri, në fund të vitit 2008, mesatarisht një në gjashtë persona është mbajtës i një karte. Çdo kartëmbajtës kryen jo më shumë se 16 transaksione në vit, nga të cilat, 15 transaksione janë tërheqje *cash* nga banka. Pra, përdorimi i instrumenteve të pagesave elektronike nga publiku është ende në hapat e parë, krahasuar me statistikat e raportuara nga vendet e rajonit.

Tabelë 35. Transaksionet me karta sipas llojit të transaksionit.

Transaksione me karta sipas llojit të transaksionit	Vëllim	Vlerë (mln lekë)
1- ATM tërheqje *cash*	7,910,609	89,067.43
2- ATM depozitime	133	2.10
3- Urdhër transferta nëpërmjet ATM-ve	271	9.37
4- Tërheqje *cash* në terminale POS	2,999	451.51
5- Pagesa me karta në terminale POS	291,131	4,196.19
prej të cilave:		
- pagesa me karta debiti	187,720	2,013.81
- pagesa me karta krediti	103,411	2,182.38
Totali transaksioneve me karta	8,205,143	93,726.60

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

Në fund të vitit 2008, ishin gjashtë banka që ofronin shërbime "home banking", në formën e produkteve që mundësojnë aksesimin e llogarisë bankare nga shtëpia, nëpërmjet një linje interneti apo një software-i, që banka i vë në dispozicion klientit të saj.

Përdorimi i këtij shërbimi lidhet ngushtë me ekzistencën e infrastrukturës si dhe aftësinë e klientëve për të përdorur internetin dhe teknologjitë bashkëkohore. Krahasuar me vitin 2007, gjatë vitit 2008 vërehet një rritje e numrit dhe e vlerës së transaksioneve "home banking", përkatësisht prej 108 për qind dhe 116 për qind.

Tabelë 36. Përdorimi i home-banking.

Home banking	2006	2007	2008
Numri i transaksioneve	19,096	42,447	88,261
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	16.83	48.49	104.88

Burimi: Banka e Shqipërisë (Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave").

6.4 ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Gjatë vitit 2008, është punuar për harmonizimin e kuadrit rregullativ ekzistues të sistemeve të pagesave me *Acquis Communautaire,* si dhe me standardet më të mira ndërkombëtare për sistemet e pagesave. Në këtë kuadër, janë rishikuar disa rregullore si dhe janë miratuar rregullore të reja, duke synuar përshtatjen e tyre me direktivat e BE-së të cilat shkurtimisht përshkruhen më poshtë:

- *RREGULLORE "PËR INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE"*

Rishikimi i rregullores synon përmirësimin e kuadrit rregullativ për emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike, në zbatim të funksionit të Bankës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbikëqyrjen e funksionimit normal të sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja ka si objekt përcaktimin e standardeve të transparencës ndaj klientit lidhur me kushtet, rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave nëpërmjet instrumenteve të pagesave elektronike në Republikën e Shqipërisë, përcaktimin e llojeve të instrumenteve të pagesave elektronike, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe raportimit të informacionit gjatë përdorimit të tyre.

- *RREGULLORE "PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E NUMRIT NDËRKOMBËTAR TË LLOGARISË BANKARE (IBAN)".*

Rregullorja "Për strukturën dhe përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)", synon standardizimin e numrave të llogarive që përdoren për kryerjen e pagesave, me qëllim nxitjen dhe përmirësimin e sistemit të pagesave në Republikën e Shqipërisë. Rregullorja ka si objekt përcaktimin e strukturës së numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare për përdorim në Republikën e Shqipërisë (IBAN-i shqiptar) si dhe përcaktimin e procedurave për krijimin, kontrollin e vlefshmërisë dhe përdorimin e tij nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë. Projekti për zbatimin e IBAN-it në Shqipëri është planifikuar të zbatohet në dy faza:

(1) krijimi dhe informimi i klientëve në lidhje me numrin e llogarisë së tyre në formatin IBAN - bankat mund të përcaktojnë vetë datën e saktë të transferimit të plotë në formatin IBAN si dhe kohëzgjatjen e procesit të transferimit, me kusht që transferimi duhet të përfundohet brenda datës 1 qershor 2009;
(2) përdorimi dhe kontrolli i detyrueshëm i IBAN-it për të gjitha pagesat e dërguara/marra nga bankat - duke filluar nga data 1 janar 2010, bankat janë të detyruara të kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN-it të llogarisë së dërguesit/përfituesit të përfshira në instruksionin e pagesës, në hyrje apo dalje, pavarësisht formës elektronike apo letër të marrjes së informacionit mbi IBAN-in. Duke filluar nga kjo datë, edhe sistemet shqiptare të pagesave do të bëjnë kontrollin e vlefshmërisë së llogarive të përfshira në instruksionet e pagesave, dhe në rast pasaktësie refuzojnë urdhërpagesat në fjalë.

- *DOKUMENTI "POLITIKA E MBIKËQYRJES SË SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE TË SHLYERJES"*

Dokumenti "Politika e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes", synon të sqarojë objektivat e mbikëqyrjes për sistemet e pagesave dhe të shlyerjes, rolin e Bankës së Shqipërisë, fushën ku zbatohet mbikëqyrja, mënyrën se si zhvillohet procesi i mbikëqyrjes, parimet dhe standardet ku bazohet ky proces, si dhe bashkëpunimin me autoritete të tjera mbikëqyrëse. Dokumenti synon të përshkruajë përgjegjësitë themelore të bankës qendrore

në mbikëqyrjen e sistemit të pagesave dhe në zbatim të këtyre përgjegjësive, të përcaktojë objektivat dhe aktivitetet e mbikëqyrjes, bazuar në parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe thekson nevojën e bashkëpunimit me bankat qendrore dhe institucione të tjera mbikëqyrëse.

Për të plotësuar më tej kuadrin ligjor të një sistemi modern pagesash, vlerësohet i rëndësishëm hartimi i ligjit shqiptar "Për sistemin e pagesave", projekti i të cilit është planifikuar të përfundojë gjatë vitit 2009. Angazhimi i institucioneve shtetërore si dhe bashkëpunimi me bankat tregtare, do të ndihmojnë Bankën e Shqipërisë për arritjen e këtij qëllimi, si një kusht i domosdoshëm për funksionimin e sistemit kombëtar të pagesave dhe përputhjen me direktivat e BE-së.

SHËNIME

[1] Dokumenti "Parashikimi Ekonomik Botëror, kriza dhe rimëkëmbja", prill 2009.
[2] Një përshkrim i detajuar i veprimeve të Bankës së Shqipërisë jepet në seksionin 4.1.2 "Operacionet e tregut të hapur gjatë vitit 2008" dhe në hapësirën informuese 5 "Instrumentet e tregut të hapur (të politikës monetare)".
[3] Këtu përfshihen bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, shoqëritë e sigurimit dhe fondet suplementare private të pensionit.
[4] 1,072.60 miliardë lekë, sipas vlerësimit të FMN.
[5] Përfshirë interesat e përllogaritur.
[6] Sipas raportit të Kombeve të Bashkuara mbi ekonominë globale, norma vjetore e rënies së çmimit të shtëpive ka arritur në 17% gjatë vitit 2008, ndërkohë që norma e mosshlyerjes së kredive hipotekare është rritur ndjeshëm, aq sa rreth 40% e kredive hipotekore sub-prime të akorduara në 2006-ën, rezultonin si kredi të këqija në gjysmën e dytë të 2008-ës.
[7] Shiko hapësirë informuese 2.
[8] Matur si ndryshim në përqindje e PBB-së në tremujorë krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit paraardhës.
[9] Norma vjetore e rritjes së fitimeve për aksion për firmat jofinanciare të listuara në indeksin EURO STOXX të Dow Jones ka rënë nga 10% në qershor të vitit 2008, në -3% në nëntor 2008.
[10] Shiko hapësirë informuese 2.
[11] Shiko hapësirë informuese 2.
[12] CDS (credit default swaps) – është një kontratë derivative kredie mes dy palëve, ku blerësi i bën pagesa periodike shitësit dhe në rast se instrumenti financiar që është objekt i kontratës falimenton, shitësi detyrohet t'i paguajë blerësit një shumë të caktuar si dëmshpërblim. Këto kontrata janë një lloj sigurimi për instrumentet e kredisë.
[13] ABS (Asset Backed Security) - një letër me vlerë, vlera dhe të ardhurat periodike të së cilës rrjedhin dhe kolateralizohen prej një grupi të ngjashëm aktivesh financiare për shembull, prej një grupi të ngjashëm kredish.
[14] CDO (Collateralized Debt Obligation) – janë një lloj i strukturuar ABS-je, vlera dhe të ardhurat periodike të së cilës rrjedhin prej një portofoli aktivesh që ofrojnë të ardhura të pandryshueshme, fikse. Këtij instrumenti i caktohen kategori të ndryshme rreziku ose transhe. Pagesat e kryegjësë dhe të interesit, realizohen mbi bazën e transheve, ku kategoria e rrezikut më të lartë ofron një normë interesi më të lartë (dhe çmim më të ulët) për të kompensuar për rrezikun më të lartë të dështimit të investimit.
[15] Shiko hapësirë informuese 3.
[16] Vlerësohet që prej korrikut 2007 e deri në dhjetor 2008, rëniet në bursat botërore të kenë shkaktuar një humbje të vlerës së kompanive të listuara në bursa prej rreth 16 mijë miliardë eurosh, afërsisht 1.5 herë më shumë se prodhimi i brendshëm bruto i Bashkimit Evropian.
[17] Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare, raporti tremujor.
[18] Në SHBA, në vitet 2005 dhe 2006 norma e kursimit u kthye në negative (merrnin borxh), ndërkohë që ajo ishte 7 për qind e të ardhurave të disponueshme në vitin 1990. Huadhënia jocilësore për kredi hipotekare, u rrit nga 180 miliardë dollarë në vitin 2001, në 625 miliardë dollarë në vitin 2005.
[19] Humbjet e sektorit bankar së bashku me ato të kompanive të sigurimit, për periudhën korrik 2007 – dhjetor 2008, vlerësohen rreth 1 mijë miliardë euro.
[20] Shiko hapësirë informuese 3.
[21] Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 2001-2006 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë.
[22] Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.
[23] PBB nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.
[24] Të dhënat e të punësuarve dhe normës së papunësisë 2008 i përkasin tremujorit të tretë, INSTAT.
[25] Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria.
[26] TTE agregon tregues të veçantë të sektorëve kryesorë të aktivitetit ekonomik (industri, ndërtim e shërbime) si dhe të konsumatorëve. Seritë e treguesve, bazuar në informacionin e marrë nga vrojtimet e besimit të organizuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat përdoren në ndërtimin e TTE,

janë sezonalisht të rregulluara.

[27] Buxhetor dhe jobuxhetor (INSTAT, Konjuktura tregues kryesorë ekonomikë korrik-shtator 2008).

[28] Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 2008.

[29] Në nëntor, Banka e Shqipërisë ndryshoi formën e ankandit për operacionet e tregut të hapur në ankande me shumë të pakufizuar (me normë interesi të fiksuar sa norma bazë e interesit) nga ato me shumë të kufizuar që ishin zbatuar deri në atë moment. Gjithashtu, në muajin dhjetor, interesi i kredisë njëditore, instrument i ofruar nga Banka e Shqipërisë, u ul me 100 pikë bazë.

[30] Këtu përfshihen bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, shoqëritë e sigurimit dhe fondet suplementare private të pensionit.

[31] 1,072.60 miliardë lekë, sipas vlerësimit të FMN.

[32] Përfshirë interesat e përllogaritur.

[33] Përfshijnë transaksionet që kryejnë bankat me Bankën Qendrore (depozita, rezervë e detyruar, operacionet e tregut të hapur – marrëveshjet e riblerjes dhe ato të anasjellta të riblerjes), transaksionet me bonot e thesarit si edhe operacionet midis bankave tregtare (depozita, llogari rrjedhëse, hua etj.).

[34] Përveç veprimeve me Bankën Qendrore dhe me bonot e thesarit, përfshijnë edhe marrëdhëniet (huamarrjet) nga banka të huaja (faktikisht, me grupin bankar të cilit i përkasin).

[35] Përfshin llogarinë e kapitalit (kapitali i aksionerëve, fitimi/humbja e mbartur, fitimi/humbja e vitit), të rezervave (të përgjithshme, specifike), të rivlerësimit etj..

[36] Përfshihen llogari marrëdhëniesh, llogaritë pezull dhe të pozicionit.

[37] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së aktiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin aktivet me maturim të mbetur "0-10 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 5 ditë, për atë "10 ditë deri në 1 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 20 ditë; për atë "1-3 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-9 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 7.5 muaj; për intervalin "9-12 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 10.5 muaj; për intervalin "1-5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vite ose 120 muaj (duke qenë se pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vite.).

[38] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së pasiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin pasivet "0-10 ditë" kohëzgjatja mesatare është marrë 5 ditë; për atë "10 ditë-1 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 20 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për atë "6-9 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 7.5 muaj; për intervalin "9-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 10.5 muaj; për intervalin "1-5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vite ose 72 muaj.

[39] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së depozitave, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin depozitat "deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 0.5 muaj; për atë "1-3 muaj" kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vite ose 72 muaj.

[40] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së kredisë, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marre "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin kreditë "deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 0.5 muaj; për atë "1-3 muaj" kohëzgjatja mesatare është marre 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite" kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vite ose 120 muaj (duke qenë se pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vite).

[41] E matur që prej muajit mars 2006.

[42] Llogaritja e kontributit është në bazë vjetore.

[43] Përfaqësojnë investime në depozita, në letra me vlerë etj., të cilat u ulën për shkak të nevojës

për të përballuar kërkesat më të larta për likuiditet, në tremujorin e fundit të vitit.

[44] Normalisht, vlera e aktiveve me rrezik, duhet të jetë më e lartë se vlera e kredisë (pasi e përfshin këtë të fundit) dhe për këtë arsye, pesha e aktiveve me rrezik në totalin e aktiveve duhet të jetë më e lartë. Ndryshimi i kuadrit rregullativ mbikëqyrës për degët e bankave të huaja, ka shmangur nga detyrimi për raportim vlerën e aktiveve me rrezik, por ka ruajtur raportimin e vlerës së portofolit të kredisë, i cili vijon të raportohet dhe të përfshihet në llogaritjen e treguesve.

[45] Sipas vlerësimit të FMN-së, vlera e PBB-së për vitin 2008 llogaritet 1.072 miliardë lekë.

[46] Llogaritet nëpërmjet raportit "kredi me probleme në valutë (ku të ardhurat e kredimarrësve janë në valutë)/tepricës së kredisë në valutë në total (ku të ardhurat e kredimarrësve janë në valutë)".

[47] Llogaritet nëpërmjet raportit "kredi me probleme në valutë (ku të ardhurat e kredimarrësve janë në lekë)/tepricës së kredisë në valutë në total (të ardhurat e kredimarrësve janë në lekë)".

[48] Pavarësisht nga kjo, për arsye sigurie Departamenti i Mbikëqyrjes iu ka kërkuar bankave paraprakisht të rrisin kapitalin dhe të monitorojnë me kujdes zhvillimet në veprimtarinë krediduese. Aksionerët e bankave që kanë qenë subjekt i kërkesës, i janë përgjigjur menjëherë kërkesës për rritje kapitali, duke e realizuar atë pa probleme.

[49] Duke përfshirë edhe provigjonet për investimet jashtë vendit (kreditë e dhëna nga degët e huaja të bankave të vendit), fondi rezervë arrin në 12.6 miliardë lekë.

[50] Në formën e pasurive të patundshme, të letrave me vlerë, të kolateraleve të tjera si: depozita, automjete, makineri dhe pajisje etj..

[51] Kur u referohemi treguesve RoE dhe RoA, bëhet fjalë gjithnjë për tregues me bazë vjetore.

[52] Niveli minimal për këtë tregues i kërkuar nga kuadri rregullativ i mbikëqyrjes, është 12 për qind.

[53] Burimi: Vlera e PBB-së marrë nga "Country Report IMF – October 2008".

[54] Në rubrikën "shlyerje për sistemet e klerimit neto" përfshihen transaksionet për shlyerje neto, të rezultateve nga sistemet e klerimit, si: klerimi i pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH, klerimi i çeqeve bankare dhe personale në lekë, shlyerjet neto për letrat me vlerë të qeverisë dhe shlyerjet neto të rezultateve të pagesave në lekë, me karta krediti, për të cilat Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

[55] Procedurat për akordimin e kredive brenda ditës janë mjaft të thjeshta dhe lëvrimi i fondeve bëhet brenda orës 10.00 të ditës së punës, në vijim të kërkesës së vetë bankës.

[56] Pagesat e kleruara në sistemin AECH, procesohen në dy seksione (seksioni I - 09.00 deri në 11.00; dhe seksioni II - 12.00 deri në 14.30) gjatë ditës së punës dhe, në përfundim të secilit seksion, shlyhen për rezultat neto në sistemin AIPS.

[57] INSTAT – Numri i popullsisë, Janar 2008.